









*Kur'ani Famëllartë sipas Imam Khomeinit*

# **Kur'ani Famëllartë sipas Imam Khomeinit**

Tiranë, 2018

**Titulli: Kur'ani Famëlartë sipas Imam Khomeinit**

**E përktheu: Vullnet Merja**

**Recensent: Sabrie Feza**

**E redaktoi: Jerida Kulla**

**E korrektoi: Vjollca Karaj**

**Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie Feza**

**Botoi: Shoqata "FLLADI"**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## PARATHËNIE

"كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ  
الْحَمِيدِ"

**"(Kur'ani) është libri që ta kemi zbritur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit (nëpërmjet tij) prej errësirës në dritë dhe për t'i udhëzuar ata me lejen e të Plotëfuqishmit dhe Falënderuesit."**<sup>1</sup>

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!) ka thënë: "Nëse një ditë prej ditëve do të përfshiheni prej sprovave dhe luftërave të mëdha (të zeza si errësira e natës), kapuni fort pas Kur'anit, sepse ai do të jetë ndërmjetësues për ju në Ditën e Gjykimit dhe është burimi më i madh i të vërtetës. Ata, jeta e të cilëve do të frymëzohet prej tij (Kur'anit) dhe do ta kenë atë si busull të jetës së tyre, nuk ka dyshim se do të jenë prej banorëve të Parajsës, ndërsa ata që e nënvlerësojnë dhe e lenë pas krahëve, do ta kenë fundin në zjarr. Ai është një libër që e udhëzon njerëzimin kah udha e drejtë. Ai është një udhërrëfyes, ku gjenden të

---

<sup>1</sup> Sure "Ibrahim", ajeti 1.

përshkruara deri në detajet më të imëta të gjitha çështjet e rëndësishme të jetës. Është një përcaktues i qartë, që nuk ka asgjë të ngjashme me humorin apo shakanë. Te ai Libër ka çështje të shtjelluara shumë qartë, por ka edhe shumë kuptime të tjera të fshehta, që nuk mund t'i kuptojë çdo njeri. Kuptimet e tij sipërfaqësore janë gjykime e vendime, ndërsa kuptimet e tij të fshehta janë dija vetë. Kuptimet e tij sipërfaqësore janë të mbushura me elegancë, ndërsa kuptimet e tij të fshehta janë shprehje e thellësisë në kuptim. Mrekullitë e tij nuk mund të numërohen, ndërsa sekretet e tij nuk kanë fund. Ai është si llambat që ndriçojnë, sikurse është tempulli i urtësisë. Ai është udhërrëfyes i dijes për njohësit dhe nuhatësit e saj. Ata që i ndriçojnë sytë me udhëzimin e tij, e shohin rrugën të qartë dhe nuk përballen me të papritura dhe me vështirësi.”

Imam Aliu (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) ka thënë: “Duhet ta dini mirë se ky Kur'an i zbritur prej të Madhërishmit Allah, është këshillues, dritën e të cilit asgjë nuk mund ta mbulojë. Ai është udhëzim, me të cilin nuk humbet kurrë. Ai është një folës, që nuk gënjen kurrë. Të gjithë ata që shoqërohen me këshillat e tij, ose i shtojnë fitimet e tyre, ose i shtojnë humbjet. I shtojnë fitimet, kur shtojnë udhëzimin prej tij dhe thellojnë humbjet, kur e thellojnë verbërinë dhe prej tij nuk mësojnë.”

Është e nevojshme dhe një domosdoshmëri e madhe që myslimanët e ditëve të sotme të jenë shumë të vëmendshëm ndaj këtij përkufizimi, që Profeti i Zotit

*(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* ka dhënë për Kur'anin Famëlartë.

Është tashmë e qartë për të gjithë, se aktualiteti i myslimanëve nuk ka qenë kurrë më parë më i zyrtar, më i ndotur dhe më i errët se ai që po përjetohet në ditët e sotme. Një aktualitet i ngjashëm me atë që përshkruhet në hadithin e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). E vërteta është se Kur'ani Famëlartë ka qenë i pranishëm te myslimanët, që në ditët e para të historisë, kur Kalifati u shndërrua nga qeverisje islame, sipas traditës së Profetit, në mbretëri diktatoriale të ngurtë. Erdhi një moment në historinë islame, kur Kur'ani, edhe pse, në pamje të parë, ishte i pranishëm në mesin e tyre, realiteti ishte se të gjitha funksionet dhe dispozitat e tij udhëzuese ishin të ngrira dhe nuk gjenin zbatim. Megjithatë, edhe pse Islami ka kaluar ditë të vështira në periudhat e tij të para, vëmë re se vështirësitë me të cilat është përballur gjatë shekullit të injorancës, shekullit të njëzetë, prej regjimeve tiranike e diktatoriale, të cilat kanë vënë në shërbim të qëllimeve të tyre të liga instrumentet më të komplikuar politike dhe mediatike, kanë qenë disa herë më të rrezikshme dhe më të mëdha. Këto vështirësi janë, padyshim, prej atyre vështirësive që prodhojnë shumë shqetësim dhe tension.

Mënyra më e mirë, më e shpejtë, më e përshtatshme dhe më ndikuese për ta përjashtuar Islamin prej jetëve të tyre, është përjashtimi i Kur'anit prej mendjeve, zemrave

dhe praktikave të tyre të përditshme jetësore. Kjo ka qenë metoda dhe mënyra kryesore e përdorur dhe e synuar me shumë përkujdesje prej agjenturave të huaja perëndimore dhe bashkëpunëtorëve të tyre myslimanë vendas. Për të realizuar këto qëllime të liga, ata kanë përdorur metoda dhe strategji nga më të ndryshmet dhe më të komplikuarat. Në të vërtetë, (sipas shprehjes së tij) Kur'ani është Libri i Shenjtë, është dritë, udhërrëfyes, udhëzim, si dhe ndarës e përcaktues i qartë i të mirës nga e keqja. Ai është jetë për zemrat e vdekura, është njësi matëse dhe peshore, nëpërmjet të cilës mund të peshojmë veprat tona. Ai është shërim dhe kujtesë për njerëzit. Të gjitha këto cilësi të Kur'anit Famëlartë është e pamundur të shfaqen me rezultate konkrete në jetën e njeriut, përveçse kur kuptohet mirë dhe më pas bëhet pjesë e pandarë e praktikës së përditshme.

Në periudhën e parë të Islamit, Kur'ani ka qenë faktori më i rëndësishëm në vendimmarrjet e myslimanëve. Fjala e parë dhe e fundit, pra, fjala vendimtare, ka qenë gjithmonë fjala e tij. Madje edhe vetë fjala e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) duhet të kalojë më parë në peshoren kur'anore. Njëkohësisht, vëmë re se myslimanët, që e kishin mësuar të gjithë Kur'anin, kishin një pozitë të veçantë gjatë kohës kur Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka qenë në mesin e myslimanëve. Lidhur me

vlerat dhe rëndësinë e tyre, Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka thënë: *“Njerëzit më të ndershëm të ymetit tim (populli që e ndjek udhëzimin tim) janë ata që falin natën namaz dhe ata që e mësojnë përmendësh Kur’anin.”*

Ishin kohë kur Kur’ani kishte vlera të mëdha teorike dhe praktike në jetën e myslimanëve. Kështu, sa herë që myslimanët përballeshin me llojet e ndryshme të vështirësive në jetën e tyre të përditshme, i ktheheshin Kur’anit për këshillim. Kur’ani Famëlartë ka qenë njësia matëse e vërtetësisë dhe metoda më e saktë krahasuese, për të gjykuar thëniet profetike dhe kuptimet e tyre. Ai ka qenë laborator i më i saktë, në të cilin myslimanët kryenin analizat e të mirës dhe të keqes, duke pritur kësisoj rezultatet e tij përfundimtare, që përcaktojnë strukturën dhe natyrën e të keqes dhe të së mirës në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Kur shoqëritë myslimane nisën të vetëdijesohen për rëndësinë e Kur’anit dhe kuptuan se ai është mënyra më e mirë dhe rruga më e shpejtë për të bërë dallimin e të mirës nga e kota, e pozitives nga negativja, u konsiderua problematike dhe pengesë e madhe për qeveritë e së keqes. Kështu, ata menjëherë nisën të marrin masa urgjente për të zbehur ndikimin e Kur’anit Famëlartë nga jeta e myslimanëve. Për të përmbushur qëllimet e tyre të liga, ata nisën ta largojnë Kur’anin prej përditshmërisë së njerëzve. Më pas investuan fuqimisht tezën e ndarjes së fesë dhe

çështjeve shoqërore të njerëzve. U përpoqën të bëjnë një lloj ndarjeje ndërmjet çështjeve të kësaj bote dhe të Botës Tjetër. U përpoqën, gjithashtu, të investojnë një lloj aleance ndërmjet fetarëve realistë (të kuptueshëm dhe bashkëpunues) dhe ndërmjet laikëve modernë. Kështu, pra, ata e larguan Islamin prej jetës shoqërore, duke mos e lejuar në asnjë formë e mënyrë, që ai të jetë drejtuesi, udhërrëfyesi dhe orientuesi i çështjeve të tyre të ditës. Qëllimi i tyre ishte gjetja e një formule fetare, e cila ka për qëllim ta ngrijë, ta dobësojë dhe ta zbehë sa të mundet ndikimin e Islamit në jetën e përditshme të njerëzve, duke e kufizuar atë brenda katër mureve të xhamisë, faltores apo teqesë. Një tjetër justifikim, tërësisht i palogjikshëm, ishte se feja është çështje e lidhur me zemrat e njerëzve dhe ajo nuk ka përse të jetë pjesë e jetës së tyre të përditshme. Nëpërmjet të gjitha këtyre përpjekjeve dhe metodave të rafinuara, ata arritën ta ndajnë përfundimisht besimin fetar islam nga jeta shoqërore e njerëzve, duke shkaktuar kështu një humbje të madhe për myslimanët, qoftë në planin afatshkurtër, qoftë në atë afatgjatë.

Natyrshëm, edhe pse përpara ofensivës perëndimore, kryqtare e sioniste ndaj Islamit, myslimanët nuk ishin zbatues të përpiktë të Islamit, nuk ka dyshim se për pjesën më të madhe të shoqërive myslimane, diku më shumë e diku më pak, ai ka qenë i pranishëm dhe i rrënjësor thellë mendjeve dhe zemrave të tyre, me të gjithë

ngarkesën e madhështisë dhe të shenjtërisë që e përfaqëson.

Edhe pse gjendja e myslimanëve, në shekullin 19 ishte e tillë, ajo mbetej e papranueshme për aleancën sioniste të krishterë. Ata e kanë shumë të vështirë ta pranojnë praninë e Kur'anit në jetën shoqërore dhe politike të myslimanëve, sepse brenda tij ka një urdhër të qartë dhe të prerë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِّنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْحَيْلِ"

**"Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj..."<sup>2</sup>**

Më pas ofron një tjetër siguri të drejtpërdrejtë dhe të fuqishme të Allahut, ku thotë:

"وَلَنُيَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلَ"

**"...Allahu nuk do t'iu japë kurrë rast mohuesve që t'i shkatërrojnë besimtarët."<sup>3</sup>**

Ata e kanë të vështirë ta pranojnë Kur'anin, sepse ai i udhëzon dhe i mëson besimtarët, që të jenë të vëllazëruar midis njëri-tjetrit. I mëson ata të jenë të mëshirshëm, falës dhe tolerues me njëri-tjetrin dhe të ashpër, të rreptë dhe të prerë me armiqtë e tyre femohues. Udhëzime të tilla dhe kuptime të tilla kur'anore, tingëllojnë ashpër për veshët

<sup>2</sup> Sure "Enfal", ajeti 60.

<sup>3</sup> Sure "Nisa", ajeti 141.

dhe mendjet e pushtuesve judeo-kristianë, të cilët kishin dhe kanë si synim kryesor të drejtojnë çështjet e myslimanëve dhe të grabisin pasuritë dhe të mirat e shumta, që atyre u ka dhuruar Zoti.

Me gjithë ndikimin e dobët të Kur'anit te jetët e myslimanëve, sunduesit e tyre judeo-kristianë janë plotësisht të vetëdijshëm se prania e mësimave të tij në mesin e tyre bëhet pengesë serioze për realizimin e planeve të tyre të mbrapshta dhe për përmbushjen e qëllimeve të tyre pushtuese. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore, përse ata vendosën dhe u përpoqën ta fshijnë dhe ta zhdukin plotësisht Kur'anin prej jetës së myslimanëve. Natyrshëm, planet e tyre nuk do të mund të korrnin suksesin e dëshiruar dhe të synuar, dhe nuk kanë për ta korrur kurrë, sepse Allahu i Madhëruar u ka premtuar myslimanëve, u ka dalë vetë garant për mbrojtjen e Librit dhe të Udhëzimit të tij sa të jetë jeta. Me gjithë siguritë e Allahut të Madhëruar për mbrojtjen e Librit të Tij të Shenjtë, kjo nuk do të thotë aspak që myslimanët të jenë të pakujdesshëm dhe tolerues, lidhur me këtë aspekt dhe me këtë dimension të përpjekjeve të femohuesve.

Le të hedhim sot një vështrim mbi jetën e myslimanëve. Sa i pranishëm është sot Kur'ani Famëlartë në jetët e tyre? A e gjejmë vallë të pranishëm te qeveritë e myslimanëve? A mos vallë, e gjejmë atë të pranishëm në jetën dhe në politikat e tyre ekonomike? A e gjejmë atë të

pranishëm në organizimin e tyre shoqëror dhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin? A mos vallë, e gjejmë atë të pranishëm në shkolla dhe në universitete? A e gjejmë atë të pranishëm në orientimin strategjik të politikave të jashtme dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare? A e gjejmë Islamin të pranishëm në ndarjen e pasurisë publike dhe kombëtare për të gjithë anëtarët e kombit dhe të shoqërisë? A e gjejmë Islamin të pranishëm të sjelljet e drejtuesve të shteteve islame dhe të sjelljet e anëtarëve të popullsisë, që ndikohen shumë ose pak prej sjelljeve të liderëve të tyre? A e gjejmë atë të pranishëm të sjelljet individuale të qeveritarëve myslimanë? A e gjejmë atë të pranishëm të marrëdhëniet ndërmjet burrit dhe gruas? A e gjejmë Islamin të pranishëm të llogaritë tona bankare? A e gjejmë atë të normat tona të sjelljes dhe të bashkëjetesës me njerëzit? A e gjejmë Islamin të pranishëm të sjelljet dhe normat e përgjithshme të shoqërisë? Prej të gjitha fushave të mësipërme jetësore mund të bëjmë përjashtim vetëm xhamitë, minaret e tyre dhe ndonjë emision i ndrojtur televiziv apo radiofonik, në kanale periferike me shikueshmëri të ulët, që bëhet sa për sy e faqe të njerëzve dhe për t'u hedhur hi syve. Emisione nga ato që bëhen sa për të treguar se ka liri të shprehjes dhe të mendimit. Në të vërtetë, a është e mjaftueshme një prani kaq e kufizuar e Islamit në shoqëri? Njëqind vite më parë, Es Sejid (zotëria) Xhemal ka pas qarë dhe ka pas qarë shumë për këtë gjendje të myslimanëve. Ai qante me dënësë, sa herë

kujtonte faktin se Kur'ani Famëlartë ishte bërë thjeshtë objekt për t'u dhuruar në raste festash e ceremonish, objekt zbukurimi, si dhe një libër që shërben për t'ua kënduar të vdekurve në varreza. Nëse themi se e tillë ka qenë atëherë gjendja e myslimanëve, po në këto njëqind vitet e fundit, çfarë ka ndryshuar? A nuk duhet të na shqetësojë zbehja e ndikimit të Kur'anit te jetët e myslimanëve edhe në ditët e sotme?

E gjithë çështja është se Kur'ani është Libri i jetës së myslimanit. Libër për jetën e çdo qenieje njerëzore. Ai është Libri i përjetësisë së njeriut. Libri i njeriut, i plotësuar në të gjitha dimensionet e veta, i njeriut që e ushqen veten vazhdimisht me largpamësi. Kur'ani është libri i njeriut, i cili nuk njeh kufij për përsosmërinë e tij. Nuk ka dyshim se Ai që e zbriti atë Kur'an, Ai që e udhëzoi njeriun dhe e mësoi nëpërmjet Kur'anit, është në gjendje dhe i ka të gjitha mundësitë, që të përkujdeset për të dhe për besimtarët në të gjitha kohërat dhe shekujt, sado të vështira qofshin ato. Ai është mënyra më e përshtatshme për të organizuar jetën e myslimanit. Të vërtetat më të mëdha të jetës gjenden në Kur'an dhe askund tjetër. Nuk ka dyshim se Kur'ani është i vetmi udhëzim, me anë të së cilit njeriu mund të shmangë prej jetës së tij të gjitha llojet e zullumit, të shtypjes dhe të padrejtësisë, të korrupsionit, të përçarjes, të injorancës, të devijimit dhe të poshtërsisë. Ai është i vetmi udhëzues i sigurt, që e ndihmon njeriun të

shpëtojë njëherë e përgjithmonë prej të gjitha tradhtive, që i janë bërë atij përgjatë historisë. Të atyre tradhtive të mëdha, që kanë qenë pengesë për udhëzimin dhe orientimin e tij kah e mbara dhe kah e Drejta e Allahut. Të gjitha këto vlera të larta njerëzore, të sipërpërmendura, mund të jetësohen dhe mund të vihen në praktikë nën dritën e udhëzimit kur'anor dhe nën ombrellën e orientimit të tij strategjik për të gjitha detajet e jetës njerëzore.

Në të vërtetë, kthimi i njeriut te Kur'ani dhe te udhëzimet e tij është në vetvete kthim për te jeta që e meriton çdo qenie njerëzore me dinjitet. Kjo është një përgjegjësi që bie mbi supet e të gjithë atyre që e besojnë Kur'anin dhe veçanërisht mbi ata që e njohin dhe e kanë studiuar imtësisht atë, siç janë thirrësit e fesë dhe hoxhallarët e nderuar.

Në rast se kthimi te udhëzimet e Kur'anit Famëllartë, do të ishte një thirrje e sinqertë dhe do të punohej fort dhe seriozisht për realizimin e saj, sigurisht që myslimanëve do t'u krijohej mundësia, që ta dallonin të mirën nga e keqja, të vërtetën nga e kota. Ajo që kërkohet prej myslimanëve, gjithashtu, është që të mos pranojnë, në asnjë mënyrë, të mbajnë mbi supet e tyre barrën e rëndë e të gjithë atyre fuqive të huaja, të cilat bëjnë të pamundurën për të ndaluar kthimin e tyre te udhëzimet e Kur'anit Famëllartë.

Të nderuar vëllezërit e mi myslimanë, të nderuara motrat e mia myslimane!

Pasi u gjendëm për një kohë të gjatë të sprovuar me largimin tonë prej udhëzimeve të Kur'anit dhe, pasi e kuptuam se armiqtë e Islamit janë përpjekur vazhdimisht, gjatë gjithë historisë, për të na larguar prej tij, ne arritëm të rikthehemi dhe të shijojmë sërish ëmbëlsinë që i shkakton qenies kthimi te ai.

Nuk ka dyshim, gjithashtu, se triumfi madhështor i Revolucionit Islamik dhe zëvendësimi i regjimit të Shahut me atë të Republikës Islamike të Iranit, si një format dhe platformë e re politike për drejtimin e shtetit, kanë qenë përfaqësuese të dy prej gjurmëve më të mëdha të rikthimit tonë te Kur'ani Famëljartë.

Populli iranian do ta dëshmojë me sytë e tij rikthimin e Kur'anit te të gjitha horizontet e jetës së tij shoqërore, si dhe në marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin. Ata do ta gjejnë atë të pranishëm në formën e ardhshme të qeverisë dhe te të gjitha strukturat e saj. Do ta gjejnë atë të pranishëm te formati dhe te sjelljet e drejtuesve të tyre të rinj të shtetit. Do ta gjejnë atë të pranishëm te politika e jashtme e Republikës Islamike të Iranit. Do ta gjejnë atë të pranishëm, te të gjitha hallkat e sistemit të tyre arsimor dhe të edukimit. Në të gjithë sektorët e drejtimit të shtetit dhe të jetës së tyre, ata do të gjejnë të reflektuar dritën e

udhëzimit të Kur'anit dhe të mësimëve të tij. E vërteta është se gjithçka që na ka ndodhur ne sot, nuk është gjë tjetër përveçse një fllad që na vjen prej parajsës së Kur'anit. Tashmë, lipset prej nesh të lëvizim shpejt dhe të përpiqemi seriozisht për ta shndërruar atë fllad parajse dhe mirësinë që ai përfaqëson në parajsën e vërtetë tokësore.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Parathënia e librit është marrë prej fjalimit të *Imam Khomeinit* (Zoti qoftë i kënaqur me të!), Libri “El-Fikrul esiil”.

## LIBRI I ALLAHUT PËRGJATË HISTORISË

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka thënë: “Ju kam lënë pas dy trashëgimi të rëndësishme (dy busulla orientuese) dhe ato janë: Libri i Allahut dhe tradita dhe shembulli i familjes sime. Këto dy trashëgimi, nuk kanë për t’u ndarë kurrë prej njëra-tjetrës, derisa të vijë dita kur do të jenë te burimi i Keutherit (Haudi).”

Falënderimet më të sinqerta i takojnë Allahut të Madhëruar. I lutemi Atij të dërgojë salavate mbi Profetin (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), aq herë sa shpaloset për Ekzistencën Bukuria dhe Madhështia e Tij, aq herë sa numri i sekreteve të Librit të Zotit nuk shterojnë kurrë,<sup>5</sup> aq herë sa shfaqet njehsimi (el hadretul ehdi-jeh)<sup>6</sup> nëpërmjet Emrave të Tu të bukur,<sup>7</sup>

<sup>5</sup> “*Et-Texhel-li*”: Filozofët dhe asketët myslimanë, nëpërmjet këtij termi kanë nënkuptuar shfaqjen, “zbulimin” e plotë të një pjese të mistereve dhe sekreteve të ndryshme të ekzistencës për mendjet e njerëzve të devotshëm dhe për zemrat e tyre të pastra.

<sup>6</sup> “*El hadretul Ahdi-jeh*”: Ky është një përkufizim asketësh dhe filozofësh, nëpërmjet të cilit është quajtur njëra prej gradëve të Hyjnores, sipas tyre, nën titullin Zot dhe njëshmëria e Tij.

madje aq herë sa numri i Emrave dhe i Cilësive të Tua të tjera të fshehta, të cilat nuk i di askush tjetër përveç Teje. Hidhërimi i Zotit le të shoqërojë jetët e të gjithë atyre që i kanë bërë padrejtësi familjes së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Fillimisht, e shikoj të arsyeshme që të jap një përkufizim apo sqarim rreth termit “*Eth-Thikalejn*” – “*dy busulla, dy tradita, dy pika orientimi*” të përmendur në hadithin e mësipërm,<sup>7</sup> jo në kuptimin e pozitave të fshehta dhe të gradave morale të njohjes, sigurisht. Kjo ndodh, sepse askush dhe asgjë në këtë botë nuk e ka fuqinë dhe as mundësinë që të shpjegojë dhe të komentojë pozitat e larta dhe gradët e të së përsosurës, që përfshin te hapësirat e saj të gjitha sferat e ekzistencës prej mbretërisë së tokës<sup>9</sup> për te

<sup>7</sup> “*El Esma*”: “*Emrat*”, bota e emrave dhe e cilësive të Zotit është një botë prej të cilës kushtëzohet (uaxhibul uxhud) domosdoshmëria e ekzistencës.

<sup>8</sup> Fjala “*Eth-Thikalejn*”, në gjuhën arabe, është shumësi i fjalës “*Eth-Thikal*”. Në komentimin e ajeteve dhe të haditheve të ndryshme profetike, kjo fjalë është shfaqur me kuptime të ndryshme, si p.sh: trashëgimi e rëndë, trashëgimi me peshë për nga rëndësia, diçka e madhe, diçka e rëndë, diçka shumë e shtrenjtë, amanet i një rëndësie të jashtëzakonshme, si dhe shumë kuptime të tjera. Lidhur me rastin konkret, mund të themi se ajo ka nënkuptuar dy trashëgimitë kryesore që ka lënë pas Profeti (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), Librin e Allahut dhe traditën e familjes së Profetit të nderuar.

<sup>9</sup> Mbretëria (e tokës); Është gjithçka materiale që preket dhe shihet me sy të lirë. Për këtë arsye cilësohet si “*alemul mulk*” e gjithë ajo botë materiale e dukshme dhe e prekshme, te e cila kanë ndikim shqisat njerëzore.

Mbretëria më e lartë e Qiellit,<sup>10</sup> për të mbërritur deri te hapësirat e vetë hyjnore.<sup>11</sup> E vërteta është se janë disa hapësira, te të cilat është shumë e vështirë të depërtojë mendja e thjeshtë njerëzore, për të mos thënë plotësisht e pamundur. Shpjegimet dhe komentimi që dua të bëj, lidhur me kuptimin e këtij termi, nuk është gjithashtu i lidhur me pasojat që i shkaktohen njerëzve në rast braktisjeje të dy Amaneteve të mëdha të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe realiteteve që përfaqësojnë pozitat e larta të secilit prej tyre, qoftë amaneti (pesha) më i madh, qoftë amaneti (pesha) i madh,<sup>12</sup> që është më i madh se gjithçka tjetër

<sup>10</sup> Filozofët dhe njerëzit e mëdhenj të kelamit, janë të mendimit se ndërmjet botës materiale (të prekshmes nëpërmjet shqisës) dhe ndërmjet hapësirave të hyjnore gjendet një botë e ndërmjetme, e cilësuar prej tyre si “Alemul Melekut” apo “Mbretëria e Qiellit”. Ata mendojnë se kjo hapësirë e ndërmjetme është plotësisht dhe absolutisht e zhveshur (e zbrazur) prej lëndës dhe materies, prej vendit dhe prej kohës. Mendimtarët e mëdhenj dhe njohësit janë të mendimit se “El Melekut” – “Mbretëria e pas-Qiellit” është e ndarë, gjithashtu, në dy kategori: Shtresa më e lartë dhe shtresa më e ulët. Ata e kanë përdorur terminologjinë për të përfaqësuar gjithashtu dy kuptime. Shtresa më e lartë e “Mbretërisë së Qiellit”, te e cila ata gjykojnë se është krijuar mendja e njeriut dhe shtresa më e ulët e “Mbretërisë së Qiellit”, e cila përfaqëson atë të quhet “mbretëria e imagjinatës” apo hapësira ku mund të mbërrijë imagjinata njerëzore.

<sup>11</sup> “El-Lahut” (hyjnorja): Përfaqëson pozitën më të lartë të njëshmërisë, apo pozitën gjithëpërfshirëse, në cilësinë e hapësirës, që përfshin të gjitha emrat dhe cilësitë.

<sup>12</sup> Është përmendur më sipër.

përpos tij, duke përjashtuar atë më të madhin, i cili është edhe i madhi absolut.

Komentimi dhe përkufizimi i termit të sipërpërmendur, nuk ka për qëllim, gjithashtu, të shpalosë për lexuesin historikun e shpërdorimit dhe të luftimit, që i është bërë kësaj trashëgimie të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) nga duart e armiqve të Zotit dhe të njerëzimit, pasi kjo luftë është e përmasave të atilla, sa është e pamundur të numërohet dhe të përkufizohet plotësisht prej dikujt, i cili është i kufizuar në mundësi, qoftë në dimensionin kohë, qoftë në dimensionin hapësirë. Gjithçka synoj është paraqitja e një tabloje të shkurtër dhe përmbledhëse e asaj çfarë ka ndodhur me këto dy trashëgimi të rëndësishme të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Përsa i përket vetë përkufizimit profetik, ku thuhet: “Këto dy trashëgimi, nuk kanë për t’u ndarë kurrë prej njëra-tjetrës, derisa të vijë dita kur do të jenë te Haudi.”, gjejmë një tregues të qartë, i cili ka për qëllim të na tregojë se, për sa kohë njëra pjesë e kësaj trashëgimie do të preket dhe do të dëmtohet pas pranisë së Shenjtë të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), edhe pjesa tjetër është në mënyrë të menjëhershme e prekur dhe e dëmtuar. Braktisja e njërës prej tyre, është menjëherë braktisje e tjetrës, derisa këto dy trashëgimi të kthehen sërish te Haudi i Profetit të nderuar

(*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) në Ditën e Gjykimit. Ajo që përpiqemi të kuptojmë është, nëse ky vend (Haudi), është pozita në të cilën bashkohet shumësi me njëjësin (të njëshmen),<sup>13</sup> është vendi ku shkrihen pikat me detin, apo është diçka krejtësisht tjetër, të cilën mendja jonë e ka plotësisht të pamundur ta imagjinojë.

Duhet të theksojmë, gjithashtu, se ajo çfarë ka ndodhur me këto dy amanete të mëdha të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), shkaktuar prej duarve të zullumqarëve dhe të diktatorëve, është një padrejtësi e madhe, e ushtruar ndaj gjithë popullit islam, madje ndaj gjithë njerëzimit. Është një padrejtësi aq e madhe, saqë pena e ka të pamundur ta përshkruajë plotësisht. Duhet ta kemi parasysh, gjithashtu,

---

<sup>13</sup> “E shumta” në mendimin e filozofëve është tërësia e shkallëve, e pozitive dhe e gradëve të elementeve përbërëse të ekzistencës, që formësojnë shumëllojshmërinë e dukurive të dukshme dhe të padukshme, të dukurive materiale (lëndësore) dhe dukurive, që nuk janë të përbëra prej lëndës. Ndërsa njëshmëria (njëshi - e njëshmja) është vetë Zoti. Kjo njëshmëri përfaqëson, në vetvete, burimin, pikënisjen dhe zanafillën e pjesës tjetër të ekzistencës dhe të elementeve përbërëse të saj. Kësisoj, mund të themi se vendi ku do të takohet “shumësia” me “njëshmërinë” është një vend që i përket hapësirave të Botës së Përtejme. Pra, është e pamundur të jetë një vend që i përket kësaj bote. Kjo pozitë (ky vend) është mbi “shumësinë” dhe nën “njëshmërinë”. Është vendi që ndërmjetëson lindjen e “shumësisë” prej “njëshmërisë”, që ka ndodhur gjatë procesit të fillimit të Krijimit, ndërsa bashkimi i “njëshmërisë” me “shumësinë” do të ndodhë në fund të historisë së ekzistencës.

se ky hadith “hadithuth-Thikalejn”, apo “hadithi i dy amaneteve të mëdha”,<sup>14</sup> në terminologjinë e shkencës së hadithit quhet “Muteuatir”.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> “Hadithuth-Thikalejn” apo “hadithi i dy amaneteve”, është një hadith shumë i njohur, të cilin e kanë transmetuar shumë njerëz, drejtpërdrejt nga Profeti (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Sasia e madhe e rrugëve të transmetimit, nëpërmjet të cilave na ka mbërritur ky hadith është vërtet mbresëlënëse dhe bie në sy. Prej këtij hadithi dhe prej të ngjashmëve të tij mund të përfitohen shumë gjëra, ndër më të rëndësishmet e të cilave janë: a. Ashtu siç Allahu i Madhëruar ka siguruar ekzistencën e Librit të tij deri në Ditën e Gjykimit, ashtu edhe pjesa tjetër, e përfaqësuar nga Trashëgimia e familjes së Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) është pjesë e të njëjtës siguri, mbrojtje dhe vazhdimësi. Kjo do të thotë se është e pamundur që bota të jetë ndonjëherë e boshatisur prej pranisë së një drejtuesi të ndershëm mysliman. b. Nëpërmjet këtyre dy trashëgimive të lëna për myslimanët dhe mbarë njerëzimin, më i nderuari i Profetëve (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka plotësuar të gjitha nevojat e tyre shkencore dhe fetare. Ai i ka udhëzuar dhe i ka këshilluar ata se familja e tij e nderuar (tradita dhe trashëgimia e saj) janë burim udhëzimi, dije, shkence, feje dhe udhërrëfimi për mbarë njerëzimin dhe veçanërisht për myslimanët deri në Ditën e Gjykimit. c. Askujt prej myslimanëve nuk u lejohet të devijojnë prej trashëgimisë, udhëzimit dhe mësimave të tyre. d. Të gjitha nevojat e myslimanëve për dituri dhe njohurinë e fesë së tyre, janë të pranishme te kjo trashëgimi e madhe dhe e nderuar e familjes së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar*). e. Nëse njerëzit nuk do të ndjekin udhëzimin që është pjesë e kësaj trashëgimie të familjes së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) sigurisht që do ta humbin orientimin e saktë dhe rrugën e drejtë.

<sup>15</sup> “Teuatir” ose “muteuatir” është ai hadith që transmetohet nga njëri grup i njerëzve te tjetri (jo nga njëri person te tjetri), në mënyrë të atillë

Ky hadith gjendet i transmetuar te të gjashta librat e vërteta të hadithit të Ehli Syneetit<sup>16</sup> (myslimanët synitë), si dhe te librat e tjerë. Këto lloj hadithesh janë të transmetuara prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) nga burime të ndryshme transmetimi dhe me formulime të ngjashme, derisa mbërrijnë në shkallën “Et-Teuatur”.

Ky hadith është një argument detyrues shumë i madh për mbarë njerëzimin, veçanërisht për medh’hebet

---

që e shndërron dakordësinë e tyre rreth një gënjeshtre, plotësisht të pamundur.

<sup>16</sup> “*Es-Sahih*” është shumësi i fjalës “*sahih*” dhe nënkupton gjashtë libra kryesorë të haditheve, të përcaktuar prej dijetarëve myslimanë (si libra që i plotësojnë kushtet e vendosura prej dijetarëve të hadithit për vërtetësinë e hadithit ndërmjet një sasive shumë të madhe të librave, që janë shkruar në këtë lëmi). Këto janë libra që ata u kthehen për të marrë prej tyre dijet e fesë, të lidhura me gjykimin fetar për çështje të ndryshme, për komentimin e Kur’anit Famëljartë, për çështje të besimit, si dhe për çështje të tjera, të lidhura me historinë islame. Këto gjashtë libra të rëndësishëm, janë si më poshtë:

1. “*Sahihul Buhari*”, me autor Muhamed bin Ismail El Buhari (196-256hk) (812-869m);
2. “*Sahihu Muslim*”, me autor Muslim bin Haxh-xhaxh El-Nishaburii, i njohur gjithashtu edhe me emrin El Kushejrij, (206-292hk) apo (821-876m).
3. “*Sunen Ibn Maxheh*”, me autor Muhamed bin Jezid bin Maxheh, ndarë nga jeta (273hk ose 886m).
4. “*Sunen Ebi Daud*”, me autor Ebi Daud El-Bexhistani Sulejman bin Daud, ndarë nga jeta (275hk ose 888m).
5. “*Xhamiut-Tirmidhij*”, me autor Muhamed bin Isa bin Sureh Et-Tirmidhij, ndarë nga jeta (279hk ose 892m).
6. “*Sunenun Nisaii*”, me autor Ahmed bin Shuajb En-Nisai, ndarë nga jeta (303hk ose 915m).

islame (shkollat juridike islame) në larminë e tyre dhe me të gjitha ndryshueshmëritë që kanë. Pasi të jenë përballur me këtë argument detyrues, ata janë të gjithë përgjegjës për zbatimin e tij. Edhe në rast se masat e njerëzve mund të jenë të justifikuara, për mungesë të informacionit dhe shpesh për paditurinë e tyre të plotë, dijetarët dhe krerët e shkollave juridike islame, nuk mundet dhe nuk janë aspak të justifikuar në këtë aspekt.

Më konkretisht, le të shohim tani se çfarë ka ndodhur me këtë amanet të Allahut të Madhëruar. Le të përpiqemi të kuptojmë, çfarë ka ngjarë me këtë trashëgimi të shtrenjtë (të familjes Profetike) të lënë pas prej më të dashurit të krijesave të Allahut, Profetit Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Ishte kjo trashëgimia që hapi plagë të mëdha dhe dyert e fatkeqësive, që kullojnë ende gjak, veçanërisht pas vrasjes së Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*).<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup> Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) është i pari Prijës i Besimtarëve, pas Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Ai është lindur në brendësi të Qabesë, në vitin 600 m. Nëna e tij është quajtur Fatime bint Esed. Babai i tij ka qenë Ebu Talibi, njëkohësisht xhaxhai i Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Nga mosha gjashtë vjeçare ka jetuar te shtëpia e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Imam Aliu ishte i pari burrë, i cili shkoi t'i japë besën dhe t'i deklarojë mbështetjen e plotë të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Me një urdhër dhe

me një rekomandim të posaçëm nga Allahu i Madhëruar, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) i mblodhi të gjithë anëtarët e familjes së tij të nderuar, fillimisht për t'i ftuar ata të besojnë te feja me të cilën ishte dërguar Profet dhe më pas për të kërkuar mbështetjen e tyre të gjithanshme në rrugën e re, por të shenjtë, të mbushur plot me mundime e sakrifica. Ai u premtoi atyre se ata që do t'i vinin në ndihmë dhe do t'i ofronin përkrahjen dhe mbështetjen e nevojshme, do të fitonin gradën dhe pozitën e të qenit vëlla i tij dhe njëkohësisht njeri shumë i afërt i Profetit. Ai e përsëriti tri herë thirrjen dhe ftesën e tij, drejtuar anëtarëve të familjes së tij të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe në të tria herët, ai që iu përgjigj thirrjes së tij për ndjekje, mbështetje dhe ndihmë ishte Imami i nderuar, Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Në natën kur myslimanët kishim marrë urdhër dhe orientimet e nevojshme të Zotit dhe të Profetit për të emigruar nga Meka dhe për t'u larguar prej aty, me gjithë dijen e tij të plotë dhe të dhënat që posedonte për planet që kishin femohuesit e Mekës për të eliminuar fizikisht dhe për të ekzekutuar Profetin (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) mori përsipër një rrezik shumë të madh, duke shkuar dhe duke fjetur në vend të Profetit, te shtrati i tij. Kjo ishte një mënyrë nëpërmjet të cilës ai i dëshmonte Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) mbështetjen e tij të plotë, ndihmën dhe padyshim besnikërinë e tij të madhe. Gjithashtu, në ditën kur u bë vëllazërimi ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) u vëllazërua me Imam Aliun (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*).

Gjatë kohës kur Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) u kthye nga Haxhi i Lamtumirës, në një vend të quajtur Gadir Khum, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) i njoftoi myslimanët dhe u bëri atyre me dije se Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) do të ishte pasardhësi dhe trashëgimtari i pushtetit të tij, pas ndarjes nga jeta të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) i

është gjendur gjithmonë pranë të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) gjatë ditëve të tij të vetmisë, të trishtimit e të vështirësisë. Ai ka qenë gjithmonë i pranishëm në krah të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) për t'i ofruar atij të gjithë ndihmën, mbështetjen, kurajën dhe mbrojtjen e gjithanshme për të gjitha llojet e vështirësive dhe të rreziqeve, me të cilat ai përballej aq shpesh, si njeriu më i rrezikshëm dhe më kërcënues për rendin politik të kohës. Megjithëkëtë, pas ndarjes nga jeta e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), për arsye të cilat nuk janë më të panjohura për pjesën më të madhe të njerëzve, ai u mënjana prej kreut të qeverisë islame dhe prej drejtimit të çështjeve të ymetit të myslimanëve për një periudhë kohore njëzet e pesë vjeçare. Gjatë gjithë kësaj periudhe, njëzet e pesë vjeçare, në të cilën u mënjana prej drejtimit të shtetit, ai ka vepruar vazhdimisht dhe pareshtur për të ndaluar të keqen dhe për të ndihmuar të mirën, cilado qoftë natyra e saj.

Pas vrasjes së Kalifit të tretë, myslimanët u mblodhën dhe i dhanë besën. Mandati i tij qeverisës zgjati për një periudhë kohore katërvjeçare dhe nëntë muaj. Gjatë periudhës së tij qeverisëse, të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur pas ndarjes nga jeta e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), ai i ktheu në gjendjen e mëparshme. Të ngacmuar nga këto veprime të Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) të gjithë ata që ndiheshin të kërcënuar dhe të rrezikuar seriozisht, nisën të organizojnë një frymë të gjithanshme opozitare, duke provokuar kështu luftëra dhe konflikte të brendshme ndërmjet myslimanëve. Ata nisën të derdhnin gjak myslimanësh dhe të ndërmarrin një fushatë të organizuar kriminale, me justifikim hakmarrjen për gjakun e Kalifit të tretë të myslimanëve. Kjo fushatë përfundoi, fatkeqësisht, me vrasjen dhe eliminimin fizik (gjatë kohës kur ai falej përballë mihrabit të tij) të njërit prej simboleve më të mëdhenj të historisë së njerëzimit, me vrasjen e njeriut më të mirë të myslimanëve, pas Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Në fakt, është shumë e vështirë të përshkruash personalitetin e Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Ai është një personazh qendror, madje më qëndrori, pas

Ishte kjo koha kur adhuresit e egos dhe të unit, kur zullumqarët, tiranët dhe diktatorët e shekullit më të ndritur të historisë, përfituan nga rasti dhe duke marrë shkas prej kësaj vrasjeje, vendosën me forcën e dredhisë dhe të dhunës qeveritë armiqësore të Kur'anit, duke larguar kështu prej pushtetit dhe qeverisjes komentuesit dhe interpretuesit më të mëdhenj të Kur'anit.

Me metoda nga më dredharaket dhe me pretekste nga më të ulëtat, të gatuara dhe të kurdisura kohë më parë, u larguan prej pushtetit njerëzit më të ndershëm dhe më të devotshëm myslimanë. E gjithë kjo batërdi dhe e gjithë kjo fushatë e paturpshme, ndodhi në një kohë kur oshtima e thënies së Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*): “Ju kam lënë pas, dy trashëgimi të rëndësishme (dy busulla orientuese) dhe ato janë: “Libri i Allahut dhe tradita, shembulli i familjes sime”, vazhdonte të ishte e pranishme fuqimisht te daullet e

---

Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), i cili nuk ka kursyer asgjë të shtrenjtë, përfshi edhe jetën e tij, në shërbim të lartësimit të fjalës së Allahut dhe të fesë së tij. Në shtëpinë e tij prej qerpiçi janë rritur fëmijë të bekuar, Hasani, Hyseni dhe vajza Zejnebi (*Paqja e Zotit qoftë mbi ata të tre!*). Janë këta tre fëmijë të bekuar, që e ngritën lart Flamurin e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Janë këta tre personazhe qendrore, të cilët lanë gjurmë të thella në historinë islame dhe atë të njerëzimit. Janë këta tre personazhe që e mbuluan njerëzimin me dritën e ngjarjeve plot nder që prodhuan, sikurse ishin pa më të voglin hezitim shembujt më të lartë për të gjithë ata që janë vënë në kërkim të së vërtetës.

veshëve të tyre. Në të vërtetë, nëpërmjet këtyre hapave, ata nuk kanë bërë gjë tjetër përveçse e kanë përjashtuar dhe e kanë eliminuar Kur'anin Famëlartë nga jeta e njerëzve. Atë Kur'an që ka qenë, është dhe do të mbetet udhërrëfyesi i besimtarëve dhe busulla e myslimanëve, derisa të shkojnë te Haudi i bekuar, në Ditën e Gjykimit. E vërteta e asaj që ata padrejtësisht bënë, është nxjerrja e pavlefshme e Qeverisë së Drejtësisë Hyjnore, që është edhe qëllimi përfundimtar i Librit të Shenjtë. Ajo që bënë është se hodhën themelet e largimit nga feja e Allahut, nga Tradita Profetike dhe nga Udhë e Shenjtë, që e vizatojnë për myslimanët këto dy trashëgimi të mëdha. Më pas ngjarjet u zhvilluan në mënyrë të atillë që edhe penës do t'i vinte turp t'i përshkruajë dhe t'i hedhë në letër.

Sa më shumë që ngrihej kjo ndërtesë e devijuar politike, aq më shumë përhapej deviacioni te myslimanët.

Ndikimi i ajeteve të Kur'anit në jetët e njerëzve u ndërpre deri në atë masë, sa nuk kishte asnjë lloj ndikimi në udhëzimin e tyre. Ndaluan ndikimin e Librit të zbritur për njerëzimin prej lartësive dhe hapësirave të "njëshmërisë",<sup>18</sup> nëpërmjet zbulesës së plotë, dërguar Muhamed Mustafasë<sup>19</sup> (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi*

---

<sup>18</sup> Është sqaruar më sipër. Për të gjithë ata që dëshirojnë t'i kthehen sërish, le t'i kthehen faqes 5 të origjinalit.

<sup>19</sup> "*El-Keshf*"; është eliminimi i pengesës, apo i perdes, apo i mbulesës. Kështu, ai është qëndrimi dhe njohja me të vërtetën që qëndron pas mbulesës, pengesës apo perdes. Për këtë arsye quhet Zbulesë Hyjnore.

të dhe mbi familjen e tij të nderuar!), si udhëzim për mbarë njerëzimin dhe si bosht strategjik orientues për të gjithë myslimanët, kudo që janë. Ishte ai udhëzim, nëpërmjet të cilit njerëzimi duhej të ngrihej e duhej të shpëtonte, për ta transferuar atë për te nivelet e lartësive që meriton, pasi ai është produkti i “dijes së emrave”,<sup>20</sup> si dhe për ta mbrojtur atë prej ligësisë së djajve, tiranëve dhe zullumqarëve.

Kur’ani ishte Libri që e zbriti Allahu i Madhëruar, për të shpërndarë drejtësinë dhe barazinë e tij në mbarë botën. Ai ishte Libri që zbriti për t’i deleguar pushtetin eulijave të ndershëm dhe të pagabueshëm (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*), me qëllimin përfundimtar, drejtimin e njerëzimit prej atyre që synojnë më të mirën për mbarë njerëzimin. Niveli i devijimit, i korrupsionit dhe i injorancës, veçanërisht i dijetarëve të pallatit që ishin akoma më të këqij se udhëheqësit e tyre, ishte i niveleve të atilla sa Kur’ani përdorej si mjet dhe argument për të përhapur padrejtësinë, si dhe për të çimentuar pushtetin e zullumqarëve të inatosur, në kundërshtim të plotë me Vullnetin e Allahut të Madhëruar. Sa dhimbje e madhe, që Zbulesa Hyjnore, e përfaqësuar me Kur’anin Famëlartë,

---

<sup>20</sup> “*Dija e emrave*”: Është një dituri që merret me studimin e mundësive dhe fuqive njohëse të njerëzve. Nëpërmjet këtij termi, i përdorur në këtë rast, nënkuptohet se njeriu është produkt i dijes së emrave dhe është dituria që Allahu i Madhëruar ia paraqiti njerëzve, që të plotësonin kriteret për të qenë pasuesit e Tij në Tokë. Nëse Allahu i Madhëruar nuk do t’ia mësonte Ademit “dijen e emrave”, ai nuk do të mund të ishte pasardhës i Tij në Tokë.

Librin dhe udhërrëfyesi për udhëzim, rregullatori i çështjeve të myslimanëve, përfundoi në një mjet zbukurimi me karakter ceremonial, për t'iu kënduar të vdekurve në varreza, vetëm për shkak të urrejtjes që kishin për të vërtetën, për shkak të kurtheve që kishin ngritur dhe për shkak të injorancës e paditurisë. Kjo ishte gjendja e atëhershme, kjo është gjendja edhe në ditët e sotme, e njëjtë.

Kështu pra, Libri i Allahut, që duhet të shërbejë për të bashkuar myslimanët dhe të gjithë anëtarët e njerëzimit me njëri-tjetrin, Libri që është Kushtetuta e çdo myslimani dhe udhërrëfyesi i tij, u vu prej zullumqarëve në shërbim të përçarjes së myslimanëve dhe të përhapjes së konflikteve ndërmjet tyre. Kishte edhe nga ato raste kur roli i tij (i Kur'anit) eliminohej tërësisht prej jetës së myslimanëve me metoda nga më djallëzoret dhe më të sofistikuarat, që mund t'i prodhojë mendja njerëzore. Në ato ditë të vështira, pamë se si konsideroheshin të rrezikshëm të gjithë ata që bënë apel për qeverinë islame, të gjithë ata që i ngatërronin punët e pushtetit dhe të politikës me ato të fesë, ndërkohë që Kur'ani Famëlartë dhe hadithet profetike ishin të mbushura me tekste që vinin theksin mbi rolin qendror të Islamit në jetën politike dhe shoqërore të njerëzve.

Një thirrje e tillë ishte paturpësisht dhe paradoksalisht e ndaluar, edhe pse historia e Profetit të Zotit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij të nderuar!) është e mbushur me zhvillime dhe me ndikime të kësaj natyre. Nëse një dijetar i çështjeve të fesë, konsideroj si njeri i ditur edhe në lëmin e politikës, kjo e shndërronte atë në mënyrë të menjëhershme në një njeri të pafe. Kjo situatë vazhdon të jetë e tillë e ngjashme deri në imtësi edhe në ditët e sotme. Njerëzit e fesë duhet të merren me fe, ndërsa njerëzit e politikës duhet të merren me politikë. Kjo është fatkeqësisht edhe gjendja në ditët e sotme. Qeveritë e djallit dhe të zullumit, e zhdukën Kur'anin nga jeta praktike e myslimanëve, por, nga ana tjetër, harxhuan sasi të mëdha parash për ta shtypur atë me shkronja të bukura dhe në bashkëpunim me të gjitha qeveritë e tjera të devijuara të botës, ua shpërndanë ato myslimanëve, si një përpjekje flagrante për t'u hedhur atyre hi syve, si dhe për të devijuar qëllimin e tij të vërtetë.

Qëllimi përfundimtar i gjithë kësaj maskerade dhe i gjithë këtij teatri ishte falsifikimi i Islamit, duke e nxjerrë atë përfundimisht prej thelbit dhe qëllimit të tij të vërtetë. Ky ishte, në vija të përgjithshme, plani i tyre djallëzor, për ta nxjerrë Kur'anin prej jetës së myslimanëve dhe për ta bllokuar ndikimin e tij te përditshmëria e tyre.

Të gjithë jemi dëshmitarë se si Muhamed Rida Behleuij<sup>21</sup> e botoi Kur'anin dhe nëpërmjet një kase shumë

---

<sup>21</sup> Muhamed Rida Behleuij, është kryeqeveritari i fundit i zinxhirit qeverisës të behlevitëve. Ai ka lindur në muajin nëntor të vitit 1919m, ishte i biri i Rida Khanit. Nëpërmjet një kurthi të kurdisur me kujdes ai arriti të marrë pushtetin, ndërsa të birin e tij, Muhamed Ridain, e

të paditur hoxhallarësh, u përpoq ta shesë lëvizjen e tij si një hap madhështor, në funksion të përfitimeve të brendshme politike.

Ne jemi krenarë dhe populli ynë gjithashtu, se jemi pasuesit e një shkolle të juridiksionit islam, e cila ka në themel të saj ringjalljen e vlerave më të larta kur'anore, ringjalljen e thirrjes islame dhe synon unitetin e myslimanëve kudo që gjenden. Thirrja jonë i tejkalon edhe kufijtë e myslimanëve, duke kërkuar një unitet ndërmjet të gjithë bijve dhe bijave të njerëzimit, si e vetmja mënyrë për të shpëtuar mendjet dhe shpirtrat e tyre prej formave të ndryshme të shtypjes, prangosjes e tiranisë. Thirrja jonë ka për synim të çlirojë mbarë njerëzimin prej nënshtrimit, adhurimit të faraonëve modernë dhe skllavërisë.

---

emëroi si pasardhësin e fronit të tij. Pas përfundimit të shkollës fillore, Muhamed Rida u transferua për në Zvicër, për t'i vazhduar atje studimet e tij. Pas kthimit të tij, ai ndoqi studimet në Fakultetin Ushtarak dhe në vitin 1941, aleatët perëndimorë e larguan Rida Khanin prej pushtetit dhe sollën Muhamed Ridain në vend të tij, si mbret. Periudha kohore në të cilën qeverisi ai, ndahet në dy pjesë kryesore: Periudha e parë (1941-1955m) ishte periudha përgjatë të cilës Muhamed Rida nuk mundi ta ushtronte plotësisht pushtetin e tij, sepse nuk mundi ta zëvendësonte plotësisht pushtetin e të atit dhe periudha e dytë: (1955-1978m), që zgjati njëzet e tre vite, gjatë të cilës ai e drejtoi shtetin me kompetenca të plota, si një sulltan dhe diktator i plotpushtetshëm.

## MADHËSHTIA E KUR'ANIT<sup>22</sup>

Duhet ta dish miku im i shtrenjtë, se madhështia e një libri është e lidhur me njërin prej dy faktorëve të rëndësishëm. Një libër është i madh, ose kur shkruesi i tij është i madh e i rëndësishëm, ose kur qëllimet dhe synimet e përmbajtjes së tij janë madhështore, ose kur përfundimet dhe frytet e tij janë madhështore, ose kur ndërmjetësuesi apo Profeti të cilit i është zbritur ai libër është madhështor, ose kur ai që e ruan atë libër është madhështor, ose kur shpjeguesi dhe komentuesi i tij është madhështor, ose kur lokaliteti gjeografik dhe rrethanat në të cilat ai libër është dërguar janë madhështore.

Disa prej arsyeve të sipërpërmendura, nuk kanë asnjë lidhje me madhështinë, as në thelb as në formë,<sup>23</sup> disa të tjera janë thjesht zbuluese të madhështisë, disa të tjera janë tërësisht rastësore e kështu me radhë. Në fakt, të gjitha këto cilësi, të sipërpërmendura, janë të pranishme te Famëljarti Kur'an, madje të reflektuara në formën e tyre më

---

<sup>22</sup> "Menhexhijet Eth-Theureh El Islamijeh" - "Metodika e Revolucionit Islam", f. 79.

<sup>23</sup> "El Xheuher" (thelbi); Është ekzistenca në mënyrë të pavarur ose (vetekzistenca), e cila nuk ka nevojë për vend dhe nuk është gjithashtu pjesë e diçkaje tjetër.

të plotë, më të lartë dhe më të përsosur. Prej veçorive kryesore të këtij Libri Famëllartë është se një pjesë e librave të tjerë ose nuk kanë të përbashkët me të disa prej cilësive, ose nuk kanë asgjë të përbashkët me të, as në thelb, as në pozitë, as në formë e as në origjinë.

Përsa i përket Madhështisë së burimit dhe të origjinës së tij, ai është, pa më të voglin dyshim, i Madhi Absolut,<sup>24</sup> tek i Cili gjenden të përfshira të gjitha llojet e Madhështisë së imagjinuar në mbretërinë e tokës dhe në atë të qiellit, në mbretërinë e të dukshmes dhe të padukshmes.<sup>25</sup> Është Ai tek i Cili gjenden të gjitha llojet e mundësisë dhe të fuqisë, që herë veprojnë në mënyrë të padukshme<sup>26</sup> dhe herë të tjera në mënyrë të dukshme<sup>27</sup> që vetëshfaqen dhe vetëshpalosen<sup>28</sup> në mënyrë madhështore, për të treguar mundësitë e pafundme të Atij Krijuesi të Madh, të Atij Krijuesi që nuk e shpalos Madhësinë e Tij për askënd, por, edhe në atë raste kur kjo ndodh, shpalosja

---

<sup>24</sup> "El Mutlek" (Absolut); do të thotë ekzistenca absolute dhe, në këtë rast, nënkuptohet Allahu i Madhëruar, që nuk është i kufizuar nga asnjë lloj kufiri. E kundërta e kësaj është ekzistenca e kushtëzuar, (el vuxhudul mukajed) siç është ekzistenca e sendeve, e bimëve, e mineraleve, e mendjeve, e shpirtrave e kështu me radhë.

<sup>25</sup> Është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 5.

<sup>26</sup> "El Gajb"; Është e kundërta e botës së dukshme, që preket dhe shihet me sy të lirë. Ajo është pozita e shumësisë të njohësit të mëdhenj.

<sup>27</sup> "Esh-Shehadeh"; Është bota që preket dhe shihet me sy të lirë.

<sup>28</sup> "Et-TeXheli El-Xhemali": Është sqaruar dhe është shpjeguar më sipër. Kthehu te faqja 5.(Et-TeXheli).

ndodh pas qindra e mijëra perdeve<sup>29</sup> dhe mbulesave ndarëse. Këto fakte i gjejmë të pranishme edhe te hadithi i Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), në të cilin ai shprehet: “Në të vërtetë, ndërmjet Allahut dhe pjesës tjetër të ekzistencës gjenden shtatëdhjetëmijë perde dhe shtresa, prej drite dhe errësire. Nëse zbulohen dhe shfaqen, do të digjeshin fytyrat e shikuesve.”<sup>30</sup>

Këndvështrimi i njohësve të mëdhenj (arifinëve-adhuruesve të mëdhenj të Zotit), thotë se ky Libër Fisnik është në vetvete përfaqësues i të gjitha çështjeve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me Qenien Hyjnore (me vetë Zotin), me cilësitë dhe aktivitetin e Tij, duke përfshirë kësisoj të gjitha shpalosjet dhe mënyrat nëpërmjet të cilave Ai zgjedh të paraqesë Madhështinë dhe Bukurinë e Tij.<sup>31</sup>

<sup>29</sup> “*El Hixhab*”: Nëpërmjet këtij termi, kësaj fjale, njohësit e mëdhenj të Allahut dhe të afruarit pranë Tij me shumë adhurime, kanë nënkuptuar ndarësen dhe mbulesën që qëndron ndërmjet dikujt dhe dashurisë së tij.

<sup>30</sup> “*Biharul Enuar*”, vëll. 58, K. 5, Hadithi 13, f. 45.

<sup>31</sup> “*Et-Texheli El-Xhemali*”; është në vetvete shfaqja nëpërmjet demonstrimit të faljes mëshiruese dhe faljes mëshirëbërëse, të cilat e bëjnë të detyrueshme Mëshirën, Faljen dhe Butësinë. Kjo do të thotë, gjithashtu, se çdo shpalosje e Madhështisë e bën të detyrueshme shpalosjen e Bukurisë dhe e kundërta është njëlloj. Ndodh kështu, sepse shfaqja është një shfaqje e të vërtetës nëpërmjet një vërtetësie, që është e tillë në vetvete. Kuptimi i kësaj mund të jetë, gjithashtu, vetëmbulimi i Zotit nëpërmjet një ndarëse apo një perdeje krenarie dhe madhështie, që e ndajnë Atë me pjesën tjetër të krijesave. Kjo lloj shfaqjeje është ajo që konsiderohet “Shfaqja nëpërmjet cilësisë së

Asnjë prej Librave të tjerë Qiellorë nuk e ka këtë pozitë, këtë veçori dhe këtë gradë të lartë që ka Kur'ani Famëlartë.

Përsa i përket madhësisë së Kur'anit, kur ajo shfaqet nëpërmjet qëllimeve, synimeve, kërkesave dhe nëpërmjet përmbajtjes së tij, mund të themi se për këtë nevojitet një trajtim i veçantë në një kapitull më vete, ose shumë kapituj të tjerë dhe hulumtime shkencore më vete. Lidhur me këtë temë nevojitet padyshim një libër më vete, që të hulumtojë e të sqarojë deri në imtësitë më të vogla çështjet e rëndësishme të Kur'anit Famëlartë. Trajtimi që ne po bëjmë është i lidhur me çështjet e përgjithshme dhe do të përqendrohem, dashtë Zoti, te Madhështia, e cila shfaqet nëpërmjet rezultateve përfundimtare dhe fryteve.

Ndërsa, përsa i përket “Profetit” të Zbulesës Hyjnore, përcjellësit dhe mesazherit, nëse do ia lejojmë vetes ta quajmë të tillë, ai është më besniku engjëll, Xhebraili. Ai është engjëlli (shpirti) që realizon lidhjen ndërmjet Qiellit dhe Tokës. Ai është më i madhi shpirt, që mban lidhje të drejtpërdrejtë me më të dashurin e krijesave të Allahut, me Profetin e nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Është një komunikim i mistershëm, që ndodh mes engjëllit Xhebrail dhe Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), i cili gjendet i shkëputur dhe i zhveshur prej cilësive dhe rrobës së tij njerëzore gjatë

---

madhësisë”, e cila e bën njëkohësisht të detyrueshme shfaqjen nëpërmjet cilësisë së bukurisë.

atyre momenteve. Janë momentet kur e gjithë qenia e Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) zemra dhe vëmendja e tij transferohet për të shfaqja madhështore,<sup>32</sup> e përfaqësuar me atë “Shpirt të Madh” (engjëlli Xhebrail). Ai është përfaqësuesi i njërës prej katër shtyllave apo kolonave, nëpërmjet të cilave provohet vërtetësia e Zbulesës Hyjnore. Ai engjëll është përfaqësuesi i një drite të madhe, të ngarkuar plot e përplot me dije e urtësi. Ai është engjëlli i ngarkuar me detyrën fisnike dhe krenare të transportimit të mirësive dhe të begative qiellore, që vijnë të derdhura vrullshëm për të ushqyer qenien dhe për t’i dhënë shpirtit për të pirë.

Referuar ajeteve dhe haditheve të ndryshme, engjëlli Xhebrail rezulton si më i madhi dhe më i rëndësishmi ndër engjëjt. Ndërsa ai, Muhamedi (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), të cilit i është zbritur kjo ngarkesë (zbulesa hyjnore), pra (i ngarkuari mbi të) është zemra e pastër dhe e kulluar e Ahmedit (falënderuesit), (El Ehadij - i njëshmi) i vetmi<sup>33</sup> (El

<sup>32</sup> “*El Xheberut*”; ose bota e xheberutit, cilësohet bota e mendjeve të çliruara prej çdo lloj ngarkese tjetër. Sadrul Mute’elihine ka thënë se bota e xheberutit është bota e mendjeve të plota, të përsosura. Disa filozofë të tjerë e kanë përdorur këtë term për të cilësuar botën e Berzahut.

<sup>33</sup> “*El Ehad*”: Është gjithçka, nuk ka asnjë të ngjashëm (prej llojit të tij).

Xhumeij).<sup>34</sup> Ai është muhamedani (el muhamedij), të cilit i është shfaqur i Madhërishmi Zot nëpërmjet të gjitha cilësive të Tij (edh-dhatijeh), që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me Qenien Hyjnore (me vetë Zotin)<sup>35</sup>, me cilësitë,<sup>36</sup> me emrat dhe me aktivitetin e Tij. Ai është përfaqësuesi i vulës së profetësive, i mandatuari absolut për të qeverisur. Ai është krijesa më e mirë dhe më e nderhme që ka nxjerrë njerëzimi gjatë gjithë historisë së tij. Ai është më i madhi mëkëmbës dhe ajka e njerëzimit. Ai është thelbi i ekzistencës dhe lëngu i kulluar prej të vërtetës së shtrydhur, ai është tulla e fundit (e profetësive), poseduesi i (berzahut) dhe mëkëmbësi më i madh i Zotit në tokë.

Ndërsa Mbrojtësi dhe Rojtari i Kur'anit, është vetë Allahu i Madhërishëm, i cili thotë në ajetin e nderuar:

"إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ"

**"Ne e zbritëm atë (Kur'anin) dhe Ne do ta mbrojmë atë."**<sup>37</sup>

Përsa u përket shpjeguesve, sqaruesve dhe komentuesve të tij, ata janë të gjithë të pagabueshmit e

<sup>34</sup> "El Xhemij": Është shikimi i të vërtetës, i pandikuar prej njerëzve, në mënyrë të atillë që ata nuk mund të bëhen pengesë për shikimin e asaj të vërtete.

<sup>35</sup> "Et-Texhelidh-Dhatij": Është zbulimi i të vërtetave të padukshme, që qëndrojnë pas perdes (mbulesës, pengesës)

<sup>36</sup> "Et-Texhelis-Sifatij": Është zbulimi i të vërtetës së cilësive dhe perdeve të dritës.

<sup>37</sup> Sure "El Hixhr", ajeti 9.

ndershëm dhe të pastër, duke filluar me Profetin (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) për të mbërritur te argumenti i kohës (huxhetul asr), për të cilin i lutemi Allahut të Madhëruar t'ia shpëtojë ardhjen.<sup>38</sup>

Ata janë çelësat e ekzistencës, depot e pashtershme

<sup>38</sup> Ai është Imami i dymbëdhjetë i myslimanëve, që rrjedh prej familjes së Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Ai është Muhamed Ibnul Hasen (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Ka lindur më datë pesëmbëdhjetë të muajit Sha'aban, të vitit 255hk. Emri i nënës së tij është Nirxhis. Ai u konsiderua imam që në moshën pesë vjeçare. Por me urdhër të Allahut të Madhëruar ai u zhduk nga sytë e njerëzve, për arsye të situatës së trazuar të atyre ditëve. Mungesa e tij është e ndarë në dy kategori apo në dy pjesë: Periudha e mungesës së shkurtër, e cila zgjati 69 (gjashtëdhjetë e nëntë vjet), gjatë kësaj periudhe ai i ka ruajtur lidhjet me njerëzit dhe ka komunikuar me ta nëpërmjet katër ndërmjetësve apo njerëzve të përzgjedhur prej tij. Pas ndarjes nga jeta të të përzgjedhurit të katërt, nisi ajo që quhet (el Gajbetul Kubra) mungesa e madhe, e cila vazhdon deri në ditët e sotme. Kjo gjendje do të zgjasë derisa Allahu i Madhëruar të gjykojë për kohën e rishfaqjes së tij. Ai do të rikthehet për ta mbushur Tokën me drejtësi e barazi, pas një kohe të gjatë të mbushur me padrejtësi, poshtërsi, regres dhe errësirë. Burimet e mendimit të mirëfilltë islam citojnë se rishfaqja dhe përballjet e Mehdiut do të jenë edhe përballjet e fundit të historisë së botës dhe të njerëzimit dhe përplasja e fundit ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, pra, ndërmjet përkrahësve të secilës palë. Kjo do të thotë se të gjitha triumfet e përkrahësve të së mirës janë në një farë mënyre, një lloj përgatitje e terrenit apo krijimi i klimës dhe i kushteve për rishfaqjen e tij. E gjithë kjo përballje kurorëzohet me shfaqjen e Imamit (*Paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të!*). Me rishfaqjen e tij, pra, vijmë drejt përballjes përfundimtare të së mirës me të keqen dhe dielli i të vërtetës do të ndriçojë me rrezet e tij mbarë njerëzimin. Kjo do të jetë edhe dita e pjekurisë (nëse do të mund ta quanim të atillë) morale, politike dhe shoqërore për mbarë njerëzimin.

të krenarisë dhe të madhështisë. Ata janë minerale të çmuara, te të cilët shfaqet urtësi hyjnore, janë burimi më i kthjellët i dijeve dhe i njohjes. Ata janë përfaqësuesit e denjë të pozitës së (el xhumma'a),<sup>39</sup> të përmbledhurës dhe të detajuarës.

Përsa i përket kohës së shfaqjes dhe takimit të parë të Zbulesës Hyjnore me Profetin e nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) është më e madhja Natë, Nata e Kadrit<sup>40</sup> e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj adhurim,<sup>41</sup> më e ndriçuar e netëve. Në të vërtetë, një tjetër dimension i saj është se ajo është nata në të cilën mbërrin (el uelij el mutlek) Prijësi Absolut dhe Vula e Profetëve (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

<sup>39</sup> Është shpjeguar më sipër, në f. 13. Kthehu atje.

<sup>40</sup> Sipas transmetimeve të ndryshme, Nata e Kadrit është njëra prej tre netëve të muajit të Ramazanit, që mendohet të jenë datat: 19, 21, 23. Ashtu siç jemi të gjithë në dijeni, sipas Kur'anit Famëlartë, Nata e Kadrit është një Natë, vlera adhuruere e së cilës është e barasvlershme me njëmijë muaj, sikurse është nata në të cilën Allahu i Madhëruar, shkruan dhe përcakton veprat e krijesave për një vit të plotë. Ajo është nata në të cilën engjëjt i zbritën Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) me lejen dhe me autorizimin e Zotit, sigurisht për një qëllim madhor. Ajo është nata e mëshirës dhe e përkujdesjes së veçantë të Zotit për krijesat e Tij. Për këtë arsye, dijetarët dhe Imamët e nderuar të umetit kanë këshilluar që ajo natë të kalohet me lutje, falje e përgjërime drejtuar Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë ritual ata kanë përcaktuar lutje, namaze dhe rituale të veçanta.

<sup>41</sup> Sure "El Kadr", ajeti 3.

## **KUR'ANI SI FJALË GJITHËPËRFSHIRËSE<sup>42</sup>**

Duke qenë se Zoti, me të gjithë Shenjtërinë e Tij, u shfaqet Profetëve dhe njerëzve të Tij të zgjedhur e të dashur, sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar prej Tij, në Kur'an, Ai thotë kështu: “Çdo ditë Ai shfaqet në mënyrë të ndryshme.”

Ai, nëpërmjet cilësive të Tij, shfaqet te zemrat e këtyre njerëzve të veçantë dhe të përzgjedhur për Të. Vlen të përmendet, gjithashtu, se Ai (i Madhërishmi) përzgjedh mënyrat e shfaqjes së Tij në varësi të njerëzve dhe në varësi të zemrave të secilit. Librat e zbritur Profetëve të Tij nëpërmjet (vahjit - Zbulesës - revelatës) vijnë me ndërmjetësimin e engjëllit Xhebrail. Duhet të kemi parasysh se gjithëpërfshirja e kuptimeve dhe e fjalëve ndryshon nga njëri Libër Qiellor te tjetri, nga njëri Profet te tjetri, nga njëra periudhë kohore te tjetra. Duke qenë se Kur'ani Famëlartë është vula e mesazheve të Allahut të zbritura në Tokë dhe duke qenë se pozita e tij i përket gradës së gjithëpërfshirjes së diktuar prej shfaqjes në të të Emrit më të Madh të Allahut dhe të cilësive të Tij, ai u bë

---

<sup>42</sup> “Menhexhijetuth-Theuretil-Islamijeh” - “Metodika e Revolucionit Islamik”, f. 89.

Legjislacioni Hyjnor, Feja dhe Libri me gjithëpërfshirjen më të madhe në të gjithë historinë e komunikimit Qiell-Tokë.

Nisur nga sa u përmend më sipër, mund të thuhet pa hezituat se nuk gjendet një fe, një legjislacion hyjnor, një Libër i Zbritur dhe një profetësi më e plotë dhe më gjithëpërfshirëse se ajo që iu zbrit Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Është e pamundur që prej botës së të panjohurës (alemil gajb)<sup>43</sup> Zoti të ketë zbritur mbi tokë një dije më të madhe, më të plotë se Kur'ani Famëlartë, por as të ngjashëm me të. Kjo do të thotë se Kur'ani Famëlartë është shfaqja e fundit e diturisë së mbushur me përsosmëri dhe gjithëpërfshirje. Është gjithashtu, plotësisht e pamundur që diçka më e plotë, më e lartë dhe më e përsosur se ai të zbresë në mbretërinë e tokës (mbretërinë e të prekshmes - alemul mulk).<sup>44</sup> Vetë Profeti i nderuar, që është dhe vula e Profetëve (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) është krijesa më e përsosur në ekzistencë dhe një shfaqje e padiskutueshme e kuptimeve të emrit më të madh të Zotit. Profetësia e tij është njëkohësisht Zbulesa e Allahut më e plotësuar e mundshme gjatë gjithë historisë së komunikimit të Qiellit me Tokën. Këtij Libri të jashtëzakonshëm i është dhënë autoriteti i gjithëpërfshirjes dhe ai i shkoqitjes së detajeve.

<sup>43</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 12.

<sup>44</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 5.

Atij (Kur'anit) bashkë me fjalët e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), u është dhënë prej Krijuesit të Gjithësisë, gjithëpërfshirja kuptimore. Kur thuhet se Kur'anit apo edhe thënieve të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) u është dhënë gjithëpërfshirja kuptimore, nuk nënkuptohet (cekët) se Kur'ani dhe hadithi kanë cekur çështjet e përgjithshme dhe rregullat gjithëpërfshirëse, paçka se hadithi i tij mund të konsiderohet si i tillë gjithëpërfshirës.

Ajo që kuptohet prej gjithëpërfshirjes, në këtë rast, tregon gjithëpërfshirjen e pohimit se Zbulesa Hyjnore e zbritur Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) është e lidhur me të gjitha shtresat njerëzore, me moshat e ndryshme, duke u shfaqur si plotësuese dhe ngopje për nevojat e çdo stadi njerëzor. Realiteti i kësaj të vërtete është se ajo i përfshin të gjitha gradët, prej gradëve më të ulëta të mbretërisë së tokës e deri te gradët më të larta shpirtërore, të lidhura me (melekutin<sup>45</sup>) dhe (xheberutin<sup>46</sup>).

Vlen të përmendim, gjithashtu, se në këtë botë të poshtme (të melekutit) njerëzit kanë diferenca të shumta me njëri-tjetrin. Mënyra dhe ndryshimet e mëdha që gjenden te anëtarët e kësaj lloji bote nuk janë të pranishme te krijesat e tjera. Kështu, pra, njeriu i humbur përjeton

<sup>45</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 5.

<sup>46</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 13.

shkallën sipërore të humbjes dhe të shkatërrimit, ndërsa njeriu i lumtur përjeton shkallën sipërore të lumturisë. Pjesë e kësaj bote janë (krijesa) njerëz që zbresin në gradë më poshtë se kafshët, por ka edhe krijesa që ngjiten në gradë më shumë se engjëjt më të rëndësishëm që gjenden te hapësirat e afrimitetit hyjnor.

Duke qenë se ndryshimi dhe nivelet perceptuese, mendore e logjike, si dhe shkalla e aftësisë për të përftuar njohuri, është shumë e ndryshme te anëtarët e kësaj pjese të ekzistencës (pra, tek njerëzit), mund të themi se Kur'ani Famëlartë ka zbritur me një formë dhe stil të atillë që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të lidhura pikërisht me këto shkallë e nivele perceptuese, menduese e logjike.

## **KUSHTET PËR KUPTIMIN KUR'ANIT<sup>47</sup>**

Nëse procesi i pastrimit të shpirtit nuk ndodh, atëherë do të ishte e pamundur mësimi dhe kuptimi i Librit (Kur'anit) dhe i urtësisë që përfshihet në të. Përpara se të kuptohet Kur'ani Famëljartë, lipset dhe kërkohet medoemos të ndodhë procesi i pastrimit të zemrës dhe i shpirtit prej të gjitha llojeve të papastërtive. Papastërtia më e madhe, që banon në zemrën dhe në shpirtin e njeriut, është egoja, uni arrogant, mendje-madhësia dhe epshi i pakontrolluar. Kështu, për sa kohë njeriu bëhet (nëpërmjet këtyre epsheve dhe instinkteve negative) perde dhe pengesë e vetvetes, e ka të pamundur të kuptojë thellësisht kuptimet kur'anore, të cilat janë, në vetvete, dritë e madhe (ashtu siç përshkruhet në Kur'an). Të gjithë ata që e vendosin veten pas llojeve dhe formave të ndryshme të perdeve dhe të pengesave, sigurisht që e kanë të pamundur ta kuptojnë dritën dhe atë që ajo përfaqëson. Ata mendojnë me veten e tyre se mund ta kuptojnë apo mund ta perceptojnë atë, por e vërteta është se askush nuk mund ta shohë dritën për sa kohë qëndron i vetëburgosur

---

<sup>47</sup> "Menhexhiejtuth-Theuretil-Islamijeh" - "Metodika e Revolucionit Islamik", f. 90.

dhe i vetarrestuar te qelitë e perdeve dhe të pengesave të ndryshme, të cilat i ndërton egoja (nefsi) dhe epshtet e ndryshme të errëta. Për sa kohë njeriu është i sprovuar, është i pushtuar dhe është i marrë nën kontroll prej epsheve të tij, për sa kohë gjendet i kapur dhe i shtrënguar fort prej prangave të vetëpëlqimit dhe mendjemadhësisë, për sa kohë është nën kontrollin e vazhdueshëm të instinkteve apo të dëshirave të tij më të zeza, të cilat i ka vetëvendosur thellë qenies së tij, për sa kohë gjendet nën ndikimin e fortë të këtyre shtresave të errësirës, të cilat qëndrojnë njëra mbi tjetrën,<sup>48</sup> njeriu nuk është i gatshëm të jetë objekt i kësaj drite, pra, i ndriçuar prej saj.

Të gjithë ata që synojnë të kuptojnë thellësitë e Kur'anit dhe të mesazheve të tij dhe nuk janë të përqendruar vetëm te kuptimet shumë të kufizuara sipërfaqësore, të gjithë ata që synojnë të ngjiten lartësive të hyjnore dhe dritës që ajo përfaqëson, sa herë që e lexojnë<sup>49</sup> Ku'anin dhe e meditojnë atë, duhet patjetër të shmangin dhe të zhdukjin të gjitha format e pengesave dhe të perdeve të vendosura mbi zemrën dhe në shpirtin e njeriut. "Me veten tënde (me egon) ti je pengesë për veten". Për këtë arsye, është e nevojshme që, për të parë dritën e Kur'anit

<sup>48</sup> Sure "En-Nur", ajeti 4, "ظلمات بعضها فوق بعض" **"Shtresa errësire që qëndrojnë njëra mbi tjetrën"**.

<sup>49</sup> Nënkupton njërin prej haditheve të Profetit (Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!), në të cilin ka thënë: "Lexo dhe lartësohu!".

dhe për ta përjetuar thellë atë, ashtu siç i ka hije qenies njerëzore, të cilën Krijuesi i saj e veshi me intelekt, njeriu duhet të zgjohet dhe ta pastrojë qenien prej të gjitha papastërtive, perdeve dhe pengesave që bëhen pengesë për të mbërritur te drita e madhe, e përfaqësuar në Kur'an. Kjo është e vetmja mënyrë, nëpërmjet të cilës realizohet me sukses mësimi i Kur'anit, pastrimi i zemrës për të kuptuar Kur'anin, pastrimi i shpirtit për të kuptuar urtësitë e pafundme të përfshira në të.

## GOSTIA E MADHE KUR'ANORE<sup>50</sup>

Kur'ani, në vetvete, nuk është gjë tjetër përveçse Mesazhi Hyjnor që Zoti ka dërguar për njerëzimin. Nuk ka dyshim se ai është arsyeja më e madhe e profetësisë së Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Arsyeja kryesore e kësaj Zbulese Hyjnore, që njohja e mbarë njerëzimit me mrekullinë dhe dritën që ai përfaqëson. Arsyeja e kësaj Zbulese Hyjnore është leximi i Kur'anit, derisa të jetë jeta mbi tokë. Paçka se të gjitha elementet përbërëse të ekzistencës janë argumente dhe krijesa të Allahut të Madhëruar, mund të themi pa hezituat se Kur'ani Famëlartë përfaqëson ajkën e të gjitha atyre krijesave të tjera të pafundme. Ai është përfaqësues i zhvillimit më të rëndësishëm që ndodh gjatë kohës së një profetësie.

Nisur nga sa u përmend më sipër, mund të themi se Kur'ani Famëlartë është një Gosti e Madhe Hyjnore, e përgatitur me kujdesin e veçantë të vetë Krijuesit të Gjithësisë, Allahut të Madhëruar, e rezervuar për mbarë njerëzimin dhe e servirur nëpërmjet Profetit Muhamed

---

<sup>50</sup> “Menhexhiejtuth-Theuretil-Islamijeh” - “Metodika e Revolucionit Islamik”, f. 91.

(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!). Kjo gosti ofrohet dhe është e hapur për secilin anëtar të njerëzimit, në mënyrë që secili të përfitojë prej saj sipas dëshirës dhe gatishmërisë.

Ky Libër Famëllartë dhe kjo Gosti e Madhe Hyjnore, është përgatitur me kujdesin e Krijuesit të Gjithësisë. Kufijtë e saj shtrihen nga Lindja në Perëndim dhe nga Jugu në Veri. Kufijtë e saj kohorë nisin me kohën e fillimit të Zbulesës Hyjnore dhe zgjaten deri në Ditën e Gjykimit.

Veçoria e këtij Libri është se prej tij përfitojnë të gjithë. I dituri dhe i padituri. Filozofi dhe (arifi - njohësi), shkencëtari dhe amatori në dije. Kjo do të thotë se, megjithëse ai ka zbritur prej (alemil gajb) botës së padukshme<sup>51</sup> në botën e të dukshmes dhe të prekshmes dhe është vënë në shërbimin tonë, të krijesave që gjenden në botën e të dukshmes, megjithëse është zbritur prej atyre pozitave të larta për te niveli i ulët i pozitës sonë, në mënyrë që ne të përfitojmë prej tij dhe se në brendësi të tij ka dituri, prej të cilave mund të përfitojnë të gjitha kategoritë dhe shtresat e njerëzve, ashtu siç e përmendëm pak më sipër, prapëseprapë, thellë fjalëve të tij fshihen kuptime të mëdha, që i përkasin vetëm pjesës së dijetarëve të mëdhenj, të njohësve, të filozofëve, të asketëve, të eulijave dhe pa diskutim të Profetëve. Janë disa çështje në Kur'an, të cilat nuk mund të kuptohen përveçse prej

---

<sup>51</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 12.

eulijave dhe njerëzve të dashur të Allahut, ndaj edhe kuptimet e atyre çështjeve dhe ajeteve janë të pranishme te komentimet që këta njerëz të veçantë i kanë bërë ajeteve të caktuara. Prej atyre kuptimeve, njerëzit e thjeshtë kuptojnë aq sa të munden dhe njëkohësisht aq sa janë të gatshëm të kuptojnë. Aty (në Kur'an) ka çështje prej të cilave mund të përfitojnë filozofët e mëdhenj myslimanë. Aty ka çështje, prej të cilave mund të përfitojnë shumë juristët e mëdhenj myslimanë (fukahatë).

Kështu, pra, kjo është një gosti e hapur për të gjithë. Prej asaj gostie mund të përfitojnë të gjithë dhe përveç kategorive të sipërpërmendura, prej atij mund të fitojnë edhe kategori të tjera njerëzish, pasi aty përmenden gjithashtu çështje shumë të rëndësishme politike, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe ushtarake. Gjithçka është e përfshirë dhe e pranishme në atë gosti. Aty gjendet gjithçka dhe për të gjithë.

Arsyeja e zbritjes së këtij Libri të Shenjtë te Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ishte: Ky Kur'an të jetë i pranishëm për të gjitha shtresat e njerëzimit. Secili, sipas mundësive, gatishmërisë, por edhe kapaciteteve mendore e intelektuale, të mësojë e të përfitojë prej tij. E vërteta është, fatkeqësisht, se as kapacitetet e larta intelektuale dhe as ato më të ulëta të njerëzit e thjeshtë nuk kanë mundur të përfitojnë prej tij aq sa duhet. Ajo çka lipset prej të gjithë anëtarëve të njerëzimit është të orientojnë e të fokusojnë

mendjet dhe intelektin e tyre kah ky Libër Mrekulli, në mënyrë që të përfitojmë prej tij sa më shumë të jetë e mundur. E gjitha kjo për të mirën e vetë njerëzimit.

Edhe pse Kur'ani Famëlartë ka zbritur për të gjitha shtresat e njerëzimit, ashtu siç u përmend më sipër, duhet ta dimë se është një kategori e caktuar ajetesh, të cilat mund të komentohen dhe mund të shpjegohen ekskluzivisht prej më të dashurës krijesë të Zotit, Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe ata që e kanë studiuar imtësisht çdo skutë të tij kuptimore. Për këtë arsye, njerëzit i marrin prej tyre të gjitha ato kuptime. Njëkohësisht, aty ka edhe një kategori tjetër ajetesh, të cilat mund të kuptohen edhe prej njerëzve të thjeshtë, mjafton që ata të kenë njohuritë e mjaftueshme rreth gjuhës me të cilën zbriti Kur'ani dhe gatishmërinë e duhur shpirtërore dhe mendore, për të përfituar prej mësimave të tij, aq të vlefshme dhe aq të dobishme, qoftë për këtë botë, qoftë për Botën Tjetër.

Kështu, pra, qëllimi ishte zbritja e këtij Kur'ani nga Bota e Padukshme (alemul gajb),<sup>52</sup> ku ai gjendej përpara zbritjes, në Dijen e Fshehtë e Allahut, atje te e fshehta e fshehur, nëpërmjet kësaj krijese të jashtëzakonshme, Profetit Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), i cili sakrifikoi aq shumë

<sup>52</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 12.

për përhapjen e tij. Këtë njeri të jashtëzakonshëm, Allahu i Madhëruar e kishte krijuar që në gjenezë, e kishte lidhur fort me njehsimin dhe me fenë e vërtetë, që lind bashkë me njeriun. Ai ishte i krijuar dhe ishte fort i lidhur edhe me të tjera çështje të lidhura me botën e të padukshmes (alemul gajb).<sup>53</sup> Kjo lidhje e fortë e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) mundësoi njëkohësisht zbritjen e Kur'anit nga pozitat e larta të (gajbit) të së padukshmes, për te pozitat e botës së dukshme njerëzore (alemush – shehadeh),<sup>54</sup> duke u shfaqur në formën e fjalëve dhe të shprehjeve, prej të cilave mund të përfitojmë bashkarish, unë dhe ti, pavarësisht gatishmërisë për ta bërë këtë dhe pavarësisht kapacitetit mendor. Qëllimi i profetësisë ishte: Ta vërë në dispozicion të të gjithë shtresave të njerëzve, që prej kohës kur është zbritur e deri në Ditën e Gjykimit. Ky është vetëm njëri prej qëllimeve të profetësisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an:

"بعثه عليكم" رسولاً يتلو القرآن عليكم والايات الإلهية و"يزكيهم ويعلمهم الكتاب

والحكمة"

**"Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre Shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'i mësuar Librin dhe Urtësinë."**<sup>55</sup>

<sup>53</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 12.

<sup>54</sup> Është shpjeguar dhe është sqaruar më sipër. Kthehu te faqja 12.

<sup>55</sup> Sure "El Xhumuah", ajeti 2.

Ky mund të jetë qëllimi i recitimit të tij. Kështu, pra, leximi dhe recitimi i tij ka për qëllim t'u mësojë të gjithë njerëzve Librin (Kur'anin), t'u mësojë atyre Urtësinë që fshihet në të. Qëllimi i Profetësisë është zbritja e Kur'anit. Leximi i Kur'anit për njerëzit është një mënyrë për t'ua mësuar atyre atë, që t'i nxjerrë ata prej errësirës në dritë, si një hap që i paraprin pastrimit të shpirtit dhe më pas përgatitjes së zemrës dhe të mendjes për të mësuar Librin dhe urtësinë. Kështu, pra, qëllimi kryesor është pastrimi i shpirtit dhe i zemrës, proces shumë i rëndësishëm, pa realizimin e të cilit është plotësisht e pamundur që njerëzit të kuptojnë një Libër të zbritur nga Bota e të Diturës të Botës dhe të prekshmes. Nga (alemul gajb) tek (alemush shehadeh).

## KOMENTIMI I KUR'ANIT<sup>56</sup>

Të marrësh përsipër të komentosh Librin e Zotit, nuk është një punë e lehtë, sigurisht, aq më tepër të jetë një punë të cilën mund ta bëjnë njerëz të formatit dhe të kalibrit tonë. Të shumtë janë dijetarët e nivelit të parë, të cilët janë përpjekur dhe kanë derdhur djersë për të sjellë për ne kuptimet madhështore të Kur'anit Famëlartë, nëpërmjet librave të shumtë që kanë shkruar përgjatë historisë. Përpjekjet e tyre janë për t'u falënderuar. E vërteta është, se secili dijetar, që është përpjekur për të komentuar kuptimet e Kur'anit Famëlartë, është nisur nga formimi i tij akademik dhe veçoritë e profesionit. Pra, e kanë bërë vetëm nga një këndvështrim i caktuar, madje edhe nga një këndvështrim i vetëm nuk e kanë bërë tërësisht të plotë.

Një shembull konkret, lidhur me këtë, është fakti se shumë prej dijetarëve (el arifin - njohësve) të mëdhenj të shekujve të mëparshëm, kanë shkruar komentime të Kur'anit Famëlartë, secili sipas mënyrës që e ka parë të

---

<sup>56</sup> "Menhexhiejtuth-Theuretil-Islamijeh" - "Metodika e Revolucionit Islamik", f. 93.

përshtatshme, si, p.sh, Muhjidi, <sup>57</sup> me disa libra, e ka komentuar Kur'anin nga pikëpamja dhe dimensionit (asket) apo Abdurrezak El Kashani, <sup>58</sup> me "Te'uilat-in" e tij, apo El Mull'la Sulltan Ali, <sup>59</sup> me tefsirin e tij. Disa të tjerë kanë shkruar duke qenë të ndikuar nga arti që kanë njohur. Megjithatë, Kur'ani është shumë më i thellë dhe shumë më i gjerë se gjithçka janë përpjekur të shkruajnë dhe të komentojnë ata. Ajo që ata kanë bërë, është komentimi i disa këndvështrimeve apo i disa aspekteve të kufizuara të kuptimeve të ajeteve të Kur'anit.

---

<sup>57</sup> Ai është, Muhamed Ali bin Muhamed bin Arabij (560-634), njëri prej asketëve më të mëdhenj të shekullit të shtatë. Është njohur me emrin Ibn Arabi. Te një pjesë tjetër e njerëzve është njohur me emrin Muhjiddin ose Esh-Shejhul Ekber. Ai ka shkruar në fushën e komentimit të Kur'anit dhe ka dy botime. Ato janë "Tefsirul Kur'an" dhe "El Futuhut el Mekijeh".

<sup>58</sup> Ai është El Mul'la (Mulla) Abdurrezak bin Xhemal (Xhelalud-Diin Ishak El Kashani) Es-Semerkandij, i quajtur, gjithashtu, Kemalud-Din. Ka qenë prej asketëve dhe arifinëve më të njohur të kohës, të shekullit të tetë dhe është prej atyre që kanë shkruar shpjegimin dhe komentimin "Fususul Hikem". Ai ka shkruar, gjithashtu, një tefsir (komentim Kur'ani), të cilin e ka quajtur "Te'uulul Ajat ose Te'uilatul Kur'an".

<sup>59</sup> Ai është Es-Sulltan Muhamed bin Hajdar El Xhenabedhij El Khorasanij, i njohur gjithashtu me emrin Es-Sulltan Alijshah, i cili është prej asketëve dhe arifinëve, të njohur të shekullit të katërt të hixhretit, autor i tefsirit "Bejanus-Seadeh Fii Mekamat El Ibadeh", një libër i mbushur me kërkime, të lidhura me filozofinë dhe simbolikën. Ky libër është botuar në vitin 1965 nga shtypshkronja e universitetit të Teheranit, në katër vëllime.

Të njëjtën gjë kanë bërë edhe Tantaui,<sup>60</sup> me të tjerë. Edhe Sejid Kutubi,<sup>61</sup> gjithashtu, ka shkruar tefsirin e tij. Pra, secili ka komentuar sipas fushës të tij. Ajo që mund të themi është se secili prej tyre ka bërë një punë të mirë, por ka mundur ta komentojë vetëm nga njëri aspekt, duke mundur kësisoj të largojë vetëm një perde dhe të zbulojë vetëm një pjesë shumë të vogël të së panjohurës së fshehur në të.

Shumë komentues të tjerë, përveç grupit të komentuesve të përmendur më sipër, kanë shkruar për këtë fushë, si për shembull: tefsiri “Mexhmaul Bejan”,<sup>62</sup> të

---

<sup>60</sup> Ai është Et-Tantaui bin Xheuhër El Misrij, (1287-1358hk) prej dijetarëve të Egjiptit, njëri prej profesorëve të “Darul Ulum” në Kajro, autor i librit “El Xheuahir Fii Tefsiril Kur’anil Kerim”. Ai është përqendruar kryesisht te aspekti moral i Kur’anit, dhe takimi i tij me shkencën dhe zbulimet e saj, pasi ka përdorur 750 ajete kur’anore, të cilat përputhen me shkencat e natyrës.

<sup>61</sup> Ai është Es-Sejid ibn Kutub bin Ibrahim, mendimtar islam i njohur egjiptian, në shekullin 14 hixhri. Ai ka qenë një shkrimtar dhe mësues i gjuhës arabe, anëtar në organizatën “El Ikhuan El Muslimin” - “Vëllazëria Myslimane” dhe njëkohësisht kryeredaktori i organit zyrtar (gazetës) së tyre. Është arrestuar në kohën kur Egjipti qeverisej nga Xhemal Abdun-Naseri. Më pas është burgosur dhe është vrarë po prej regjimit të tij. Ai ka shkruar disa libra. Prej tyre “Et-Tesuirul fenijj Fil Kur’an”, “Meshahidul Kijameh Fil Kur’an”, si dhe komentimin e Kur’anit, “Fi Dhilalil Kur’an”, ku është përqendruar te aspektet shoqërore.

<sup>62</sup> “Mexhmaul Bejan Fii Tefsiril Kur’an” është titulli i librit, i shkruar prej autorit Ebu Ali El Fadl bin Hasen bin Fadl Et-Tubrusij (472-552) ose (548hk). Ai ka qenë prej juristëve (fakihëve) dhe komentuesve (mufesirinëve) më të mëdhenj të vitit 6 hixhri. Komentimi i tij ka

cilin e vlerësoj si një libër shumë të mirë, që ka mbledhur mendimet e ndryshme të dijetarëve të mëdhenj dhe më pak të tillë. Këto dhe të tjera komentime të Kur'anit janë përpjekje modeste për të ofruar disa aspekte dhe dimensione të veçanta. Por duhet ta përsërisim dhe ta themi edhe njëherë se krijesa si ne, me aftësi perceptuese shumë të kufizuara, e kanë të pamundur të ofrojnë komentimin dhe shpjegimin e plotë të dimensioneve dhe të kuptimeve të pafundme, të dukshme dhe të padukshme të Kur'anit Famëlartë. Thellë atyre ajeteve gjenden dije të fshehura, shumë herë më të mëdha se aftësia jonë për t'i kuptuar. Gjithçka bëjmë ne, është të komentojmë apo të shpjegojmë vetëm njërin dimension të tij, ndërsa dimensionet e tjera kanë nevojë për ndihmën dhe komentimet e të pagabueshmëve (ehlul ismeh), të cilët janë të mësuar prej sekreteve të Profetit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Kohëve të fundit janë shfaqur individë të ndryshëm, të cilët nuk i përkasin fare fushës së tefsirit (komentimit) dhe për të përçuar idetë e tyre kanë nisur të komentojnë dhe të shpjegojnë Kur'anin, secili sipas kënaqësive dhe këndvështrimeve të tij.

Një grup të majtësh komunistë kanë provuar, gjithashtu, të komentojnë Kur'anin sipas orekseve të tyre, duke e vënë komentimin kryekëput në shërbim dhe në

---

trajtuar më së shumti dimensionin letrar, llojet e ndryshme të leximeve të Kur'anit, si dhe mendimet e komentuesve të tjerë.



funksion të ideologjisë së tyre majtiste. Në fakt, këta janë persona që nuk kanë asnjë lidhje, as me Kur'anin dhe as me komentimin e tij. I gjithë synimi i tyre është mashtrimi i të rinjve tanë, për t'i vënë ata më pas në funksion të planeve dhe të ideologjive të tyre, në mënyrë që atyre t'u duket sikur janë duke i shërbyer Islamit.

Nuk është e këshillueshme dhe as e pëlqyeshme për të gjithë ata që nuk kanë mbërritur ende një nivel serioz të formimit akademik e shkencor, që të hyjnë tek fusha e gjerë e komentimit të Kur'anit. Nuk është serioze dhe as e pranueshme që djelmosha të rinj, të cilët nuk e kanë formimin e nevojshëm akademik dhe as pjekurinë shkencore dhe që nuk janë plotësisht të formuar në fushat e ndryshme të Islamit, të marrin përsipër të bëjnë komentime të Kur'anit. Edhe nëse për qëllime të caktuara të atyre segmenteve, kjo gjë ndodh, të rinjtë tanë dhe të rinjtë e të gjithë myslimanëve duhet të mos u japin rëndësi dhe të mos tregojnë interes për komentime të kësaj natyre. Është prej gjërave të ndaluara në Islam të komentosh Kur'anin "sipas mendimit" apo "qejit tënd" dhe çdo njeri që i mbushet mendja se është i mençur, të komentojë dhe t'u imponojë mendimet e tij të tjerëve, lidhur me Kur'anin dhe kuptimet e tij.

Këta janë njerëz që përpiqen t'i imponohen me mendimet e tyre edhe vetë Kur'anit, duke i dhënë atij shpjegime dhe interpretime që i shkojnë për shtat

gjendjeve të tyre mendore, përkatësive kulturore apo shkollave të tyre ideologjike.

Një rast tjetër i ngjashëm i këtyre deviacioneve, është edhe dalja në skenë e ndonjë klouni apo frymëzuesi, që përpiqet t'i japë Kur'anit Famëljartë vetëm dimension shpirtëror, thjesht sepse ai ka të tilla përjetime dhe vjen t'i imponohet edhe Librit të Zotit me mendimet e tij. Nisur nga sa u përmend më sipër, lipset prej të gjithëve, që të jenë të kujdesshëm dhe të shohin mirë se prej nga e marrin kuptimin e Librit më të rëndësishëm në ekzistencë.

## VËSHTIRËSIA NË KUPTIMIN E KUR'ANIT “TË NËNDHESHËM” APO “TË PADUKSHËM”<sup>63</sup>

Të gjitha ajetet për të cilat është thënë te transmetimet tona, se kanë ardhur vetëm për të thelluarit e fundit të kohës, si për shembull: surja “Et-Teuhid” (e njësimit) dhe gjashtë ajetet e sures “Hadid”, nuk besoj se ka dalë dikush deri në ditët e sotme, që të japë një kuptim të plotë për kuptimin e atyre ajeteve, sikurse jam i bindur se as në të ardhmen nuk ka për të dalë dikush që ta ofrojë këtë shpjegim a komentim.

Lidhur me këtë aspekt është shkruar shumë, sigurisht dhe janë bërë kërkime të shumta dhe me shumë vlerë. Megjithatë, horizontet e Kur'anit i tejkalojnë të gjitha këto mundësi dhe këto përfytyrime. Ndonjë mund të mendojë se fjala “*el duel*” - “*i pari*” në ajetin kura'nor: “**Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi** (me argumente) **dhe i Padukshmi** (me sy).”,<sup>64</sup> nënkupton “krijesën e parë të Allahut”, ndërsa fjala “*el ahir*” - “*i mbrami*”, nënkupton,

---

<sup>63</sup> “Menhexhiejtuth-Theuretil-Islamijeh” - “Metodika e Revolucionit Islamik”, f. 95.

<sup>64</sup> Sure “Hadid”, ajeti 3.

gjithashtu, të fundin e krijesave, ndërsa fjala “*edh-dhahir*” - “*i dukshmi*” (me argument) nënkupton “*nëpërmjet Gjurmëve të Tij*”, apo fjala “*el batin*” - “*i padukshmi*” (me sy) nënkupton thjesht një cilësi të Tij.

E vërteta është se çështja e lidhur me kuptimet e këtyre fjalëve, është shumë e më e komplikuar nga sa duket dhe aspak e lehtë. Çështja është shumë më e thellë se kaq. Për shembull, fjala “*i dukshmi*” te (Ai është i Dukshmi (me argument) ka për qëllim të mohojë “*dukjen*” e lidhur me dikë tjetër përpos Zotit, që në origjinë, do të thotë se Allahu i Madhëruar e ushtron “*dukjen*” sipas një forme dhe mënyre që është e veçantë dhe posaçërisht për të. Pra, një dukje që nuk mund ta ushtrojë asnjë prej krijesave të tjera të dukshme. Kjo është e vërteta. Në fakt, të kuptosh domethënien e kësaj fjalie, që ka për qëllim të tregojë “*dukjen*” dhe shfaqjen e Tij, se bota dhe ekzistenca nuk është gjë tjetër përveçse një shfaqje, “*dukje*”, që Ai e ushtron nëpërmjet ekzistencës dhe çka gjendet në të, është diçka shumë e vështirë për t’u besuar.

Përsa i përket fjalisë së pranishme te të njëjtat ajete kur’anore, në të cilën thuhet “Ai është me ju”, fjala “*meakum*” - “*me ju*” nënkupton se Ai është “*me ne*”, pra, Ai është këtu dhe ne jemi këtu. Këtë lloj pranie, filozofët e quajnë “*prania e vigjilencës*”. A e bën ky sqarim më të qartë çështjen? A është kjo prani e ngjashme me atë të “*shkakut*” me “*pasojën*”, e ngjashme me praninë e “*shfaqjes-dukjes*”, bashkë me autorin e asaj “*dukje*”?

Në fakt, çështja nuk duhet të shtrohet kështu. E vërteta është se njerëzit e ditëve të fundit, me mprehtësinë dhe me thellësinë e tyre të mendimit, kanë arritur të kuptojnë diçka më shumë se të tjerët. Një tjetër e vërtetë është se Kur'ani i njeh mirë të shënjestruarit prej tij. Kështu, pra, fjalia: “Kur'ani i njeh mirë të shënjestruarit (grup target) prej tij”, është e lidhur ngushtë me ajetet e mësipërme. Është i njohur fakti se disa ajete, të lidhura me dispozita të përgjithshme sipërfaqësore dhe me këshilla të përgjithshme, që mund t'i kuptojë pjesa më e madhe e njerëzve dhe se nëpërmjet fjalisë “atë nuk mund ta njohë askush përveç të shënjestruarve, “grup targetit” prej tij”,<sup>65</sup> nënkuptohet Profeti i Nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe se ndërmjetësi i Zbulesës Hyjnore, që është engjëlli Xhebrail, gjithashtu nuk e di kuptimin e mesazhit me të cilin është ngarkuar për ta transmetuar e për ta përcjellë.

Engjëlli Xhebrail, ka qenë vetëm një ndërmjetës i ngarkuar prej Allahut të Madhëruar, me detyrën e përcjelljes së mesazhit dhe të transportimit të tij prej (alemul gajb - botës së padukshme) për te Profeti Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Ai nuk është pjesë e atyre për të

---

<sup>65</sup> Është përmendur më sipër, te njëra prej shënimeve të mësipërme. Kthehu atje.

cilët është dërguar Kur'ani.<sup>66</sup> I vetmi i shënjestruar prej Mesazhit Hyjnor është i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe e gjithë pjesa tjetër e njerëzve e kuptojnë Kur'anin (mesazhin) vetëm nëpërmjet dritës që lëshohet prej Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Komentimi dhe interpretimi i Mesazhit Hyjnor nuk është gjë tjetër përveçse një Dritë e Madhe, të cilën Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) u jepte njerëzve të përzgjedhur prej tij.

Ndërsa kategoria e njerëzve normalë si ne dhe e gjithë pjesa tjetër e njerëzimit, e kemi tërësisht të pamundur të kuptojmë plotësisht çfarë nënkupton fjalia kur'anore, në të cilën Allahu i Madhëruar thotë: **“Ai është (i pranishëm) me ju”**. Cila është natyra e kësaj pranie?! Cili është kuptimi i vërtetë i fjalisë **“Drita e qiejve dhe e Tokës”**, e përmendur në ajetin kur'anor: **“Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës”**?! Çfarë do të thotë **“Drita e qiejve”**?! Cila është natyra dhe forma nëpërmjet të cilës shfaqet **“Drita e qiejve”**?!

Disa prej komentuesve kanë thënë se ky ajet do të thotë se Ai (Allahu i Lartësuar) është Ndriçuesi i qiejve dhe i Tokës. Realisht, ky interpretim nuk ka asnjë lidhje me ajetin dhe kuptimin e tij të vërtetë. Kështu, transformimi

<sup>66</sup> Është përmendur më sipër, te njëra prej fusnotave të mësipërme. Kthehu atje.

mendor dhe moral që Kur'ani ka shkaktuar te njerëzit qëndron mbi të gjitha çështjet. Secili e lexon, e kupton dhe e interpreton atë nga një këndvështrim i caktuar. Disa prej tyre e komentojnë nga këndvështrimi shoqëror. Disa nga këndvështrimi sipërfaqësor, disa nga këndvështrimi politik, të tjerë nga këndvështrimi filozofik, të tjerë nga ai asket, të tjerë nga këndvështrimi i marrëdhënies së të dashurit me dashurinë e tij, etj.

Një fakt tjetër shumë i rëndësishëm është se sekretin e marrëdhënies së Krijuesit me Muhamedin (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) nuk mund ta kuptojmë dot ne, njerëzit e thjeshtë.

Në një transmetim të Imam El Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*)<sup>67</sup> lexojmë se është në gjendje të përhapë dhe të komentojë të gjitha dispozitat, ligjet dhe gjykimet që rrjedhin prej fjalës “samed” - “nuk i ngjan askujt” në Kur'an. Atëherë duhet të besojmë se këtu kemi të bëjmë me një sekret të madh, të cilin nuk mund ta deshifrojmë dot me sy të lirë, sigurisht. Secili prej nesh mund të kuptojë pjesën sipërfaqësore që përfaqëson një fjalë e caktuar, përfshi edhe fjalën “samed”, por ajo që mund të thotë Imami, lidhur me të, është diçka krejt tjetër.

---

<sup>67</sup> El Imam Muhamed bin Ali Bakir El Uloom (*Paqja qoftë mbi të!*) . Ai është Imami i pestë i imamëve të myslimanëve (57-114hk). Nëna e tij është Fatimeja, vajza e Imam Hasanit të përzgjedhur (*Paqja qoftë mbi të!*). Jetoi 57 vjet. Imamati i tij zgjati rreth 19 vjet.

Shpreh keqardhjen time më të madhe për të gjithë ata që nuk kanë dëshirë të mësojnë, për të gjithë ata që nuk kanë zgjedhur rrugën e dijes në jetët e tyre. Shpreh keqardhjen time të madhe për të gjithë ata që nuk kanë bërë asnjë hap, qoftë dhe minimal, për t'u njohur nga afër me Kur'anin Famëlartë dhe mrekullinë që ai përfaqëson. Keqardhje për të gjithë ata që nuk e marrin mundimin të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me burimin e Zbulesës Hyjnore, pasi ajo është edhe burimi kryesor i të dhënave që ndihmon interpretimin dhe komentimin e Kur'anit.

Ky komunikim dhe kjo lidhje ka qenë ekskluzivisht ndërmjet Krijuesit dhe të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe, nëpërmjet këtij të fundit, me pjesën tjetër të njerëzve të përzgjedhur të kohës.

## **DIMENSIONI I VEÇANTË I PËRFITIMEVE PREJ KUR'ANIT<sup>68</sup>**

Pak kohë pas ardhjes së Islamit, kategori të ndryshme njerëzish dhe dijetarësh të kohës nisën të tregojnë interes rreth dimensionit moral dhe optimizmit të lartë që “ngacmon” kjo fe te ata që besojnë në të. Për këtë arsye, ata e përqendruan vëmendjen e tyre te të gjitha ajetet, hadithet dhe transmetimet e ndryshme, të cilat theksojnë këtë dimension të fesë islame dhe ndikimet që ai ka te pasuesit e saj. Ka shumë ajete kur'anore, te të cilat i mëshohet shumë dimensionit moral te qenia njerëzore, dimension që përfaqëson në vetvete, apo është pjesë e (botës së padukshme).<sup>69</sup>

Në fillimet e Islamit mbizotëronte përgjithësisht një lloj neglizhence apo mungese interesimi, lidhur me dimensionet shoqërore, ekonomike, politike, morale e ushtarake, të cilat trajtohen vazhdimisht prej ajeteve të pranishme në Zbulesën Hyjnore. Por me kalimin e kohës, gjërat filluan të ndryshojnë dalëngadalë dhe grupe të

---

<sup>68</sup> “Menhexhiejtuth-Theuretil-Islamijeh” - “Metodika e Revolucionit Islamik”, f. 97.

<sup>69</sup> Është përmendur edhe më sipër. Kthehu atje për shpjegimet e nevojshme.

caktuara njerëzish nisën të trajtojnë apo të studiojnë këto aspekte të përmendura në Kur'anin Famëllartë, të shtyrë nga nevoja të caktuara të aktualitetit, të lidhur kryesisht me këto lloje zhvillimesh.

Filozofë të ndryshëm, asketë e mendimtarë, janë përqendruar te dimensionin moral i Islamit dhe janë përpjekur të shpjegojnë për njerëzimin dhe ta orientojnë atë kryesisht drejt këtij dimension. Disa prej atyre filozofëve dhe asketëve, dikush prej paditurisë, dikush për qëllime të tjera, u përpoqën t'i jepnin dimensionit moral edhe dimensioneve të tjera politike, ekonomike dhe ushtarake të përmendura në Kur'anin Famëllartë, duke argumentuar se gjithçka në Kur'an është e lidhur me dimensionin moral dhe shpirtëror, duke u ndalur vetëm aty.

Një pjesë e caktuar e kategorisë së mësipërme të njerëzve, i tejkalojnë jo pa qëllim dimensionet e tjera shoqërore, shtetndërtuese, ekonomike, politike dhe ushtarake të mesazheve që përcjellin ajetet e ndryshme kur'anore. Kjo është në vetvete verbëri intelektuale. Kjo është një verbëri e plotë, në kuptimin e qëllimit përfundimtar të Islamit. Kjo ndodh, sepse ata janë përqendruar te një dimension i mesazhit kur'anor, duke mos parë se ato mesazhe trajtojnë edhe çështje të tjera, të lidhura me natyrën dhe me të gjitha çështjet dhe detajet që lidhen me aktivitetin jetësor të njeriut. Një nga

problematikat kryesore, me të cilat është përballur Islami gjatë historisë, është fakti se shumë prej këtyre pseudomendimtarëve, filozofëve, llafollogëve dhe asketëve janë përpjekur ta zhveshin Islamin prej dimensionit të tij të vërtetë, duke u përpjekur herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, herë në mënyrë të fshehtë, ta trajtojnë Kur'anin vetëm në aspektin moral dhe t'i mëshojnë vazhdimisht vetëm aspektit shpirtëror. Ata i dhanë rëndësi të fshehurës dhe lanë pa trajtuar të dukshmen dhe të prekshmen. Në ditët e sotme, Islami përballët me një problematikë të një natyre tjetër. Duke qenë se pjesa më e madhe e rinisë së ditëve të sotme është arsimuar dhe është njohur me shkencat e natyrës, ata përqendrohen vazhdimisht te dimensionin shkencor i Kur'anit Famëllartë, duke hequr dorë prej dimensionit të tij moral dhe shpirtëror. Kjo është shumë defekte, padyshim. Guximi i tyre ka mbërritur përmasa të atilla sa janë përpjekur shpesh që të shpjegojnë dhe të komentojnë shkencërisht dimensionet e fshehta të morales dhe të shpirtërores në Kur'an. Edhe këta, mund të jenë një kategori njerëzish të interesuar për të ndihmuar Islamin dhe për ta ngritur lart emrin e tij, por sërish konsiderohen prej të paditurve dhe njerëzve të pavëmendshëm, të cilët e kanë trajtuar mesazhin Hyjnor nga një dimension i vetëm dhe jo në tërësinë e tij.

Të dyja kategoritë e sipërpërmendura, e kanë të mangët punën, interesimin dhe impenjimin e tyre, pasi

Kur'ani nuk është as “vetëm materie” dhe as “vetëm shpirt”, por ato janë kuptime dhe dimensione madhështore, të cilat bashkërendohen mrekullisht me njëra-tjetrën, duke reflektuar kështu te çdo segment jetësor i besimtarit mysliman.

## **SQARIM RRETH QËLLIMEVE, SYNIMEVE DHE KËRKESAVE TË LIBRIT HYJNOR, NË PËRGJITHËSI DHE NË VEÇANTI<sup>70</sup>**

Referuar deklaratës së vetë Kur'anit Famëllartë, kuptojmë se ai është cilësuar si Libër udhëzimi. Ai (Kur'ani) është udhëzues i sjelljeve njerëzore, edukator i shpirtit, shërues i sëmundjeve të zemrës, si dhe fanar ndriçues në udhën për tek Zoti i botëve.

Lidhur me dimensionin përgjithësues të Zbulesës Hyjnore, mund të themi se është prej Mëshirës së Allahut të Madhëruar, që e zbriti këtë Kur'an Madhështor prej lartësive të Afrimitetit, duke e transferuar atë nëpërmjet botëve të ndërmjetme, derisa mbërriti te bota jonë e errët, te burgu natyror në të cilin ndodhemi. Është prej mëshirës së Tij të madhe, që nëpërmjet kuptimeve të ngarkuara mbi forma gjeometrike germash të bekuara, kishte për qëllim t'i nxjerrë njerëzit prej burgut të paditurisë dhe të errësirës. Kishte për qëllim të shkulë prej mendjeve të tyre prangat e pesimizmit dhe të shpresës së pashpresë. Ai kishte për qëllim transferimin e qenies njerëzore prej gjendjes së

---

<sup>70</sup> "Rregullat morale të namazit", f. 323.

mangësisë, të dobësisë dhe të shtazërisë, për të horizontet e përsosmërisë dhe të fuqisë njerëzore. Kishte për qëllim transferimin e njeriut nga gjendja e miqësisë me djallin për të miqësia e njerëzve të afruar hyjnorë. Ai kishte për qëllim transferimin e qenies, për të pozitën e larta të takimit me Zotin, që është dhe ka qenë synimi kryesor dhe madhështor i njerëzve të dashur të Allahut.

Nisur nga sa u përmend më sipër, mund të themi se Kur'ani është Libri i thirrjes dhe i ftesës së njerëzimit për të lumturia e përjetshme, duke e sqaruar hap pas hapi hartën e rrugës për mbërritjen te ky qëllim. Të gjitha këto qëllime dhe synime, në vetvete, vijnë në funksion të rrugëtimit të qenies për të Krijuesi i saj. Prej qëllimeve të rëndësishme të përgjithshme, gjithashtu, janë: ftesa për njohjen e Allahut, ftesa për t'u njohur nga afër me çështje të rëndësishme, të lidhura me Zotin, me Emrat e Tij të Bukur dhe Cilësitë e Tij. Në këtë kuadër, më e rëndësishme se gjithçka është njehsimi i Qenies<sup>71</sup>, njehsimi i cilësive<sup>72</sup> dhe njehsimi i ndikimit,<sup>73</sup> të cilat janë të përmendura herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, herë në mënyrë të tërthortë.

Duhet të kihet parasysh se sqarimi i Cilësive të Qenies Hyjnore, është ofruar në këtë Libër të madh Hyjnor

---

<sup>71</sup> "Njehsimi i Qenies" - "Et-Teuhidudh-Dhatij", do të thotë që Qenia hyjnore është një.

<sup>72</sup> Është përmendur dhe është shpjeguar më sipër. Kthehu te faqja 5.

<sup>73</sup> "Et-Tuhidul fi'ilij" është të dëshmosh se askush tjetër përpos Allahut të Madhëruar nuk mund të ndikojë në ekzistencë.

nëpërmjet një metode, që e bën atë të kuptueshëm për pjesën më të madhe të njerëzve, pavarësisht prej gatishmërisë që tregon për të kuptuar dhe për ta perceptuar secila kategori. Kjo është arsyeja përse dijetarët e të dukshmes, e të prekshmes (ulemaudh-Dhahir), dijetarët e hadithit dhe dijetarët e fik'hut (*Kënaqësia e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*) i komentojnë ajetet e (teuhidit - njëhsimit) dhe veçanërisht ndikimin e njëhsimit në një mënyrë krejtësisht të ndryshme nga ajo me të cilën e komentojnë asketët dhe dijetarët që merren me studimin e botës së padukshme apo të asaj që quhet "*ilmul batin*" - "*dijet e fshehta*".

Autori i këtij libri i vlerëson të dyja mënyrat e komentimit si korrekte dhe të vlefshme, pasi Kur'ani është shërim për sëmundjet e fshehta, të padukshme dhe kuron secilën prej patologjive me mënyrë të veçantë.

Lexojmë ajetet kur'anore, që trajtojnë "teuhidudh'dhat - "Njëhsimin e Qenies", ku Allahu i Madhëruar thotë:

"هو الأول والآخر والظاهر والباطن"

**"Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) dhe i padukshmi (me sy)."**<sup>74</sup>

"الله نور السماوات والأرض"

**"Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës."**<sup>75</sup>

<sup>74</sup> Sure "Hadid", ajeti 3.

"هو الذي في السماء إله وفي الأرض إله"

**"Ai (Allahu) është Zot në qiell dhe Zot në Tokë."**<sup>76</sup>

"وهو معكم"

**"Ai (Allahu) është me ju."**<sup>77</sup>

"أينما تولّوا فثمّ وجه الله"

**"Ngado që të ktheheni është Fytyra (ana) e Allahut."**<sup>78</sup>

Të tilla ajete janë edhe ajetet e fundit të sures "El Hashr". Këto ajete jo vetëm që trajtojnë *"teuhid es-sifat"* - *"njehsimin e cilësive"* si për shembull, ajeti i nderuar në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"وما رميت إذ رميت ولكن الله رمى"

**"Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante."**<sup>79</sup>

"الحمد لله رب العالمين"

**"Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve."**<sup>80</sup>

---

<sup>75</sup> Sure "En Nur", ajeti 35.

<sup>76</sup> Sure "Ez Zukhruf", ajeti 40-84.

<sup>77</sup> Sure "Hadid", ajeti 4.

<sup>78</sup> Sure "El Bekare", ajeti 115.

<sup>79</sup> Sure "El Enfal", ajeti 17.

<sup>80</sup> Sure "El Fatiha", ajeti 1.

"يسبح الله ما في السماوات وما في الأرض"

**"Allahun e përlëvdon gjithçka, që ka në qiej dhe në Tokë."**<sup>81</sup> te të cilat trajtohet (njehsimi i cilësive dhe i aktivitetit hyjnor), që ceket herë në mënyrë të përpiktë e herë në mënyrë më të përpiktë (njohëse).

Kështu, nga një këndvështrim i caktuar, ato janë shërim i plotë për secilën prej palëve të dijetarëve të (së dukshmes – edhe dhahir) dhe të (së padukshmes – el batin).

Edhe pse kategori të caktuara ajetesh, siç janë ajetet e para të sures "Hadid", kanë zbritur për medituesit dhe mendimtarët e thellë të fundit të kohës, ashtu siç e gjejmë të përmendur në hadithin e bekuar në librin "El-Kafi",<sup>82</sup> konstatojmë se një pjesë e madhe e tyre e kuptojnë edhe dijetarët e të dukshmes së prekshme (ehludh dhahir). Kjo është një prej mrekullive që tregon dimensionin gjithëpërfshirës të këtij libri.

Prej synimeve dhe kërkesave që Libri i Allahut sjell për njerëzimin është gjithashtu edukimi i shpirtave dhe

---

<sup>81</sup> Sure "Et Tegabun", ajeti 1.

"El-Kafi Fii Hadith", i njohur me emrin "El Kafi", është një prej katër librave të njohur të myslimanët shi'itë. Autori i tij është Muhamed bin Ja'akub Is'haak El-Kelinii Err-Rrazii (328 ose 329 hk) i njohur edhe me titullin "Thikatul Islam" - "I besueshmi i Islamit". Ai konsiderohet prej dijetarëve të hadithit të myslimanëve shi'itë, sikurse është konsideruar gjithashtu, Shejhul Meshajih apo hoxha i hoxhallarëve, përsa i përket fushës së hadithit. Ka shpenzuar disa vite të jetës për ta shkruar librin e tij, të cilin e ka ndarë në tre pjesë: "El Usul", "El Furuu", "Err Rreudah" (bazat, degët dhe kopshti) të përmbledhura në 34 vëllime, me 326 kapituj dhe me 16000 hadithe.

pastrimi i tyre prej papastërtive, me qëllimin përfundimtar, realizimin dhe përfitim të lumturisë.

Një kërkesë apo synim tjetër i përgjithësuar është mënyra e rrugëtimit të qenies për te Allahu i Madhëruar. Kjo kërkesë është, në vetvete, e klasifikuar në dy kategori apo nëndegë shumë të rëndësishme, të cilat janë:

**E para:** (Et Tekua - Devocioni) frika dhe përkushtimi ndaj Allahut të Madhëruar, me të gjitha format dhe gradët, nëpërmjet të cilave shfaqet ajo, që do të thotë, transferimi i qenies prej gjithçkaje tjetër përveç Allahut të Madhëruar dhe nënshtrimi vetëm ndaj autoritetit të Tij.

**E dyta:** Besimi i plotë i të gjitha pozitave dhe i çështjeve të lidhura me orientimin e qenies kah e Vërteta Hyjnore. Rrugëtimi dhe orientimi i qenies kah falja, kah Qenia e Shenjtëruar e Allahut të Madhëruar, që është njëkohësisht prej synimeve dhe qëllimeve madhore të Librit të Allahut, pasi është thelbi i të gjitha orientimeve kur'anore, qoftë ato që kanë ndërmjetësues, qoftë ato që nuk kanë ndërmjetësim.

Prej qëllimeve të tjera të rëndësishme të kësaj Zbulese Hyjnore është gjithashtu, shpалosja e historive të Profetëve të nderuar, të eulijave dhe të urtëve të njerëzimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*) për t'i treguar pjesës tjetër të njerëzimit se cila është mënyra nëpërmjet të cilës e Vërteta dhe e Drejta Hyjnore i ka edukuar shpirtat e tyre. Ato histori janë shumë të rëndësishme për të dhënat, udhëzimet dhe përmbajtjet e larmishme që kanë. Ato

histori janë të mbushura me udhëzime, këshilla e mësimë hyjnore. Ato histori përfaqësojnë realitete jetësore të mbushura me larmi formash dhe mënyrash të mahnitshme, nëpërmjet të cilave realizohet edukimi hyjnor i shpirtit.

Të gjitha përlëvdimet, falënderimet dhe mirësitë i takojnë Allahut të Madhëruar, që solli për ne dhe për të gjithë njerëzimin, historinë e krijimit të njeriut të parë, Profetin Adem (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), duke na treguar se si u urdhërua Iblisi të bjerë në sexhde për të, se si i mësoi Ademit Emrat. Na mëson ne çështje të panjohura më parë rreth Njeriut të parë, Ademit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) dhe Iblisit, çështje që bartin, në vetvete, një sasi të jashtëzakonshme njohurish, të dhënash, mësimesh, urtësish, për të gjithë ata që Allahu i Madhëruar i cilëson kështu në Kur'an: "لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ" **"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon."**<sup>83</sup>

Vërtet që te ato histori të mrekullueshme gjenden mrekulli të shumta, që të lenë pa mend. Kjo është arsyeja dhe e fshehta, përse përsëriten herë pas here ajetet ku transmetohet historia e Ademit, Musait, Ibrahimit dhe historitë e Profetëve të tjerë (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*).

---

<sup>83</sup> Sure "Kaf", ajeti 37.

Vlen të theksojmë se Kur'ani Famëlartë nuk është një libër tregimesh dhe historish, por është i mbushur plot e përplot me mënyra, rrugë dhe shtigje të pahapura më parë, që të çojnë te Allahu i Madhëruar dhe Kënaqësia e Tij. Ai është Libri i njehsimit, i mësimave të mëdha, i mrekullisë dhe i urtësisë. Arsyeja e përsëritjes së këtyre ajeteve ka për qëllim të ndikojë te zemrat e ngurtësuara, me shpresën se do të zbuten, nëse i dëgjojnë të përsëritura ato këshilla e mësimave.

E thënë më fjalë të tjera, të gjithë ata që marrin përsipër të mësojnë dikë, ta këshillojnë dhe ta nxjerrin atë prej rrugës së gabuar, duhet të përdorin metoda, fjalë, mënyra dhe forma nga më të ndryshmet, me qëllim afrimin dhe zbutjen e tij. Kështu, pra, mënyra më e mirë për t'i bindur llojet e ndryshme të njerëzve dhe të mendësive, herë duke përdorur historinë, herë tregimin, herë këshillën, herë mrekullinë, herë habinë, herë përsëritjen, herë nëpërmjet fjalëve të drejtpërdrejta, herë nëpërmjet epitetit, sarkazmës, ironisë e kështu me radhë. Kjo është mënyra më efektive që mund të ndikojë te larmia e mendjeve, e zemrave dhe e mendësive njerëzore.

Ky është qëllimi përfundimtar i Kur'anit Famëlartë. Të mbështjellë me lumturi, gëzim e shpëtim, të gjitha shtresat e njerëzve dhe të gjithë anëtarët e njerëzimit, pa dallim race, kulture dhe përkatësie gjeografike. Kur'ani është Libri i Allahut, i zbritur për mbarë njerëzimin dhe metodat që ai ka zgjedhur për të përçar mesazhet dhe

mësimet e tij, janë të lidhura me ndryshimin e njerëzve, racave, kulturave, riteve, zakoneve, kohëve, mendësive dhe të gjeografisë. Një mesazh kaq gjithëpërfshirës dhe kaq i shtrirë në kohë dhe në hapësirë nuk mund të ndjekë një stil apo një metodologji të vetme. Ka njerëz dhe mendësi, shpirtra dhe zemra që nuk e marrin mesazhin, nuk janë të gatshme ta pranojnë atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe thjeshtësisht të qartë. Për këtë arsye, kërkohet që me këtë kategori njerëzish, të përdoren metoda të ndryshme, që mund të kenë ndikim më të fortë, duke marrë parasysh gjendjen e tyre mendore, psikologjike, shpirtërore, etj.

Ekzistojnë, gjithashtu, kategori të caktuara njerëzish e mendësish, të cilat nuk mund të ndikohen as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tërthortë, prej historive, por kanë gatishmërinë e plotë të njihen me mesazhin dhe me qëllimet e mesazhit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kështu, këtë kategori nuk mund ta trajtojmë njëlloj me kategorinë e mëparshme.

Kategori të caktuara njerëzish e marrin mesazhin dhe qëllimet e tij nëpërmjet kërcënimit dhe frikës, ndërkohë që kategori të tjera njerëzish e marrin atë nëpërmjet premtimeve dhe sihariqeve të ndryshme. Kjo është edhe arsyeja kryesore, përse në Kur'anin Famëllartë gjejmë mënyra të ndryshme dhe të larmishme të shqiptimit të Mesazhit Hyjnor. Përsëritja është njëkohësisht pjesë e stilit, që ka për qëllim ta përforcojë mesazhin, pasi shfaqja e tekstit, apo e historisë, apo e ngjarjes nëpërmjet formave

dhe aromave të ndryshme letrare, e shton elokuencën e tij dhe, për rrjedhojë, edhe ndikimin në zemra. Përsëritja ka ndikimet e saj të paevitueshme te qenia njerëzore dhe nuk ka për qëllim thjesht përsëritjen apo riprodhimin e ngjarjes historike në mënyrë të ngurtë. Ajo ka për qëllim të përsërisë fuqimisht thelbin e kërkesave dhe të qëllimeve të Mesazhit Hyjnor, me stil të ri, me fuqi të re ndikuese dhe me format krejtësisht ndryshe. Te çdo përsëritje gjejmë të përfshirë origjinën e ftesës dhe të qëllimit. Gjejmë të përsëritur veçori të papërmendura më parë. Gjejmë të tjera aroma letrare dhe logjike të së njëjtës këshillë, të të njëjtit mësim, të së njëjtës normë të moralit e të mirësisë. Këto përsëritje, të cilat i hasim aq shpesh në Kur'anin Famëllartë meritojnë një vëmendje dhe një studim të hollësishëm, që nuk i përket kësaj trajtесе të përgjithshme e sipërfaqësore, por një studimi dhe një hulumtimi më të thellë. Është në mendimet, planet dhe në shpresat e këtij robi të dobët të Allahut (thotë autori për veten), që të shkruajë një libër të veçantë, të lidhur me historitë kur'anore dhe rolit që ato kanë në udhëzimin e njerëzimit, nëpërmjet urtësive që përfaqësojnë, qëllimeve, sekreteve, etj. Kjo është vetëm një dëshirë e vogël e autorit, që gjendet krejtësisht i pafuqishëm për të sjellë për lexuesin një det, madje një oqean kaq të madh sa ky.

E parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, historitë e Profetëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*), me të gjitha ndikimet që ato kanë në formimin e njerëzve, në

këshillimin, zbutjen e zemrave të tyre, në edukimin me formën më të mirë, përfaqësojnë pa diskutim një portë të madhe të dijeve dhe urtësive, madje portën më të madhe të mrekullive dhe të lumturisë, të cilat i ka hapur Allahu i Lartësuar për të gjitha krijesat e Tij. Kështu, pra, prej mesazhit të tij përfitojnë edhe mendimtarët, shkencëtarët, shkollarët e dijetarët, por edhe pjesa tjetër e njerëzve të thjeshtë kanë aksionin e tyre të majmë, gjithashtu.

Le të sjellim një shembull lidhur me këtë. Në ajetin kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"فلما جنّ عليه الليل رأى كوكباً" **"Kur ra nata, ai pa një yll."**<sup>84</sup>

njohësit e mëdhenj (arifinët) lexojnë, ndiejnë, prekin rrugën, mënyrën, strategjinë dhe formën që Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) ka zgjedhur për të rrugëtuar për te Zotit i tij.

Thellë detajeve të asaj historie, ata gjejnë mënyrën e arratisjes dhe të transferimit të qenies, prej errësirave të natës së kësaj bote për te kopshtet e ndriçuara të dritës dhe të përjetësisë. Gjejnë format dhe mënyrat më të mira të transferimit të shpirtit dhe të moralit prej errësirës së shpellave të errëta të kësaj bote, për tek kopshtet e ndriçuara të parajsës. Gjejnë te ajo histori mënyrat dhe format që i nevojiten mendimit, shpirtit dhe frymës, për të hequr dore prej adhurimit të vetvetes e më pas për të mbërritur te pozitat e larta të shenjtërisë. Te ato lartësi të

<sup>84</sup> Sure "El En'Am", ajeti 76.

shenjtërisë dhe të hyjnore, sigurojnë për shpirtin dhe për qenien ushqimin e saj të preferuar. Sigurojnë për të prehjen, sigurinë dhe qetësinë e përjashtme.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"وجهت وجهي للذي فطر السموات والأرض" **"Unë e kthej fytyrën time nga Ai, që i ka krijuar qiejt dhe Tokën."**<sup>85</sup>

Ky ajet i nderuar është një shenjë e qartë dhe e sigurtë që vihet në funksion të së njëjtës logjikë dhe në funksion të së njëjtës arratisje për te Allahu i Madhëruar. Të tjerë njerëz, prej historisë së Profetit Ibrahim, përfitojnë raportet e tij shpirtërore e mendore, horizontale e vertikale, me Krijuesin e Gjithësisë dhe me krijesat e Tij, duke dhënë kështu për mbarë njerëzimin një mësim shumë të madh dhe të vyer.

E njëjta logjikë dhe e njëjta frymë përcillet edhe me historitë e tjera të përmendura në Kur'an. Njëlloj si historia e Ibrahimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) është edhe historia e Ademit, Musait, Jusufit, Isait, marrëdhëniet e Musait me El Khudrin (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*). Kategoritë e ndryshme të njerëzve, të mendësive, të kapaciteteve, të inteligjencës përfitojnë prej tyre, në masa dhe në forma të ndryshme nga njëri-tjetri. Te kjo kategori historish bëjnë pjesë, gjithashtu, mesazhe të ndryshme dhe shumë të rëndësishme, të lidhura drejtpërsëdrejti me synime

---

<sup>85</sup> Sure "El En'Am", ajeti 79.

edukative të vetë Krijuesit të Gjithësisë, drejtuar kategorive të ndryshme të njerëzve.

Nëpërmjet mënyrave speciale që përdor Shenjtëria Hyjnore, për të përcjellë mesazhin, ftesën dhe synimin e Zbulesës, përfitojnë kategori të ndryshme të njerëzve. Një kategori e caktuar merr mësim, kuptime dhe urtësi të mëdha të ajetet e para të sures “Hadid”, të ajetet e fundit të sures “El Hashr” dhe të e gjithë pjesa tjetër e ajeteve.

Ndërsa një pjesë tjetër e njerëzve, për të përfutur e për të përthithur urtësitë, mësimet dhe udhëzimet e hyjnore, kanë nevojë për ajete të një kategorie tjetër. Qëllimi përfundimtar është, që të gjitha shtresat e popullsisë të bëhen pjesë e Mrekullisë Hyjnore dhe të përfshihen në të.

Le të sjellim një tjetër shembull dhe një tjetër ajet kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

“Unë e kthej fytyrën time nga Ai, që i ka krijuar qiejt dhe Tokën.”.<sup>86</sup> Nëpërmjet këtij ajeti të nderuar, njohësit e mëdhenj (arifinët) kanë kuptuar se bëhet fjalë për adhurimet e detyrueshme (farz) dhe ato të pëlqyeshme (nafile).<sup>87</sup> Një pjesë tjetër e njerëzve mendojnë se, nëpërmjet këtij ajeti, nënkuptohet rrugëtimi fizik për në Mekë e Medine. Të tjerë njerëz janë të

<sup>86</sup> Sure “En Nisa”, ajeti 100.

<sup>87</sup> Adhurimet “Nafile” janë të gjitha ato adhurime, kryerja e të cilave nuk është e detyrueshme, por thjesht e pëlqyeshme.

mendimit se aty bëhet ftesë për të edukuar shpirtin dhe për ta pastruar atë, ashtu siç përmendet në një ajet kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"**Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin do të shpëtojë.**"<sup>88</sup>, etj.

Të tjerë njerëz e dijetarë janë të mendimit se aty kemi thjesht një ftesë për të kryer vepra të mira, si dhe ftesë për të hequr dorë prej veprave të këqija. Të lidhura me këtë pjesë janë, gjithashtu, edhe urtësitë e Lukmanit, bashkë me urtësitë, mrekullitë dhe urtësitë e të tjerë njerëzve dhe brezave të ndryshëm të besimtarëve përgjatë historisë, të përmendura në këtë Zbulesë të Shenjtë, siç ishin për shembull (As'habul Kehf) apo banorët e Shpellës. Prej qëllimeve të tjera të kësaj Zbulese të Shenjtë, të zbritur Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), është njohja e njerëzimit me gjendjen e mohuesve të fesë, të kryelartëve, të mendjemëdhenjve, të arrogantëve, të luftës dhe të refuzimit, që ata i kanë shpallur Profetëve të Zotit (*Paqja e Zotit qoftë mbi ta!*), si dhe me fundin e hidhur që Allahu i Madhëruar ka rezervuar për ta. Është prej qëllimeve madhore të atij Libri të Shenjtë, t'i tregojë mbarë njerëzimit se cili është fundi i arrogancës, i mendjemadhësisë, i tiranëve, i diktatorëve dhe i gjakatarëve, siç ishin Faraoni, Karuni, Nemrudi, Shedadi, As'habul Fil (ushtria e

<sup>88</sup> Sure "Esh Shems", ajeti 9.

elefantëve) dhe shumë të tjerë femohues e zullumqarë, që njerëzimi i ka ndeshur përgjatë historisë.

Te secila prej atyre historive, gjendet një sasi e madhe mesimesh, urtësish e njohurish, për të gjitha kategoritë e njerëzve. Te kjo kategori historish kur'anore, përfshihen, gjithashtu, çështje të lidhura me kreun e djajve, Iblisin (*Mallkimet e Zotit qofshin mbi të!*). Te kjo kategori historish gjenden të përfshira, gjithashtu, disa nga betejat më të rëndësishme të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) të mbushura me një pafundësi mesimesh, urtësish dhe kërkesash Hyjnore.

Historitë e atyre betejave të mëdha janë të mbushura me ngjarjet më të rëndësishme, ku shpalosen përpjekjet dhe sakrificat e mëdha të shokëve të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) për të mbrojtur fenë dhe për ta çuar atë në skajet më të largëta të botës. Ato histori janë të mbushura me udhëzime, kuptime e urtësi, që kanë për qëllim të zgjojnë nga gjumi i përhumbe brezat e hutuar të djemve dhe të vajzave myslimane, me qëllim mobilizimin e tyre të plotë, ngritjen lart të Fjalës së Allahut dhe pastrimin e rrugës prej pengesave të së kotës dhe të ligësisë.

Prej qëllimeve kryesore të Kur'anit Famëlartë është, gjithashtu, shpalosja e dispozitave të përgjithshme të sheriatit, të moralit, si dhe gjurmët e Zotit në ekzistencë. Në një pjesë të Librit Hyjnor janë të përfshira dispozitat e përgjithshme adhuruere dhe urtësitë që secila prej tyre

përfaqëson, siç është: namazi, zekati,<sup>89</sup> humsi (një e pesta)<sup>90</sup>, Haxhi, agjërimi, xhihadi, martesë, trashëgimia, kodi penal, tregtia, e kështu me radhë, deri në fund. Te kjo kategori e Zbulesës Hyjnore, përfshihet shkenca sipërfaqësore e Sheriatit, që shfaqet si interes i përgjithshëm për të gjitha shtresat e shoqërisë, në kuptimin e ndërtimit të kësaj bote dhe të Botës Tjetër (Ahiretit). Kësaj pjese të Sheriatit i është dhënë një rëndësi e veçantë në Kur'anin Famëllartë. Pjesa më e madhe e dijetarëve myslimanë e ka kaluar jetën duke shpjeguar këto dije shumë të rëndësishme të adhurimeve dhe duke i ndarë ato sipas rëndësisë dhe radhës së secilës kategori.

Prej qëllimeve kryesore të Zbulesës Hyjnore është, gjithashtu, përshkrimi i situatave të Ditës së Gjykimit dhe

---

<sup>89</sup> Zekati është sistemi islam i taksimit të pasurisë së njerëzve. Është sistemi nëpërmjet të cilit qeveria islame takson nëntë lloje produktesh dhe pasurish, sipas një formule të mirëpërcaktuar. Te pasuritë që taksohen, sipas sistemit islam, bëjnë pjesë tre lloje bagëtish, dy lloje monedhash dhe katër lloje drithërash. 1. Devetë. 2. Delet. 3. Lopët. 4. Argjendi. 5. Floriri. 6. Gruri. 7. Elbi. 8. Hurma. 9. Rrushi i thatë. Ekzistojnë edhe lloje të tjera zekati, sikurse është “Zekatul Fitr”, që është një pagesë e cila kryhet në fund të Muajit të Ramazanit, përpara Fiter Bajramit. Sasia e tij është e barasvlershme me çmimin e tre vakteve normale ushqimi për një njeri.

<sup>90</sup> “Humsi” është një taksë e detyrueshme për çdo mysliman, mbi disa lloje pasurish, siç janë: 1. Plaça e luftës së marrë prej femohuesve dhe atyre që e luftojnë fenë. 2. Metalet. 3. Thesaret. 4. Perlat, koralet dhe xhevahiret e nxjerra prej thellësive të detit. 5. Pasuria hallall, e përzier me pasurinë haram, kur është e pamundur të ndahen prej njëra-tjetrës. 6. Toka që femohuesi e ble prej myslimanit. 7. Çdo pasuri që i tejkalon shpenzimet për nevojat personale të njeriut.

paraqitja e argumenteve që e vërtetojnë atë. Prej qëllimeve kryesore të saj është paraqitja e Xhenetit dhe e Xhehenemit, e shpërblimit dhe e ndëshkimit.

Në këtë pjesë të Kur'anit paraqitet gjendja e njerëzve të dashur dhe të përkushtuar ndaj Zotit, adhuruesve të mëdhenj, durimtarë e sakrifikues të mëdhenj, si dhe oazet e lumturisë së përjetshme, ku Zoti i ka vendosur ata. Aty përshkruhet, gjithashtu, gjendja e tmerrshme dhe e vështirë, në të cilën do të përfshihen femohuesit, mendjemëdhenjtë, hipokritët, gjynahqarët e mëdhenj, kriminelët, mashtruesit, imoralët, egoistët, hileqarët, hajdutët, intrigantët, të poshtrit e maskarenjtë. Bie në sy fakti se çështjet kur'anore, të lidhura me masat e njerëzve, janë të përsëritura herë pas here, ndërsa çështjet e lidhura me kategori të veçanta njerëzish, përmenden më rrallë dhe me një gjuhë përgjithësisht më të kodifikuar.

Një shembull i lidhur me këtë pjesë, është ajeti kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë: "ورضوان من الله أكبر" **"Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh."**<sup>91</sup>

Ka dhe ajete të tjera, të cilat tregojnë takimin e Allahut me ta, ose një kategori tjetër ajetesh, në të cilat bëhet fjalë për atë kategori njerëzish, që do ta kenë të ndaluar takimin më Allahun dhe shikimin e Tij në Ditën e Gjykimit.

---

<sup>91</sup> Sure "Et Teube", ajeti 72.

Allahu i Madhëruar thotë: "كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَحْمَتِ اللَّهِ مُجَوِّبُونَ"

**"Nuk është ashtu! Atë Ditë një vel do t'i pengojë ata të shohin Zotin e tyre."**<sup>92</sup>

Vlen të theksohet se në këtë kategori ajetesh gjendet një sasi e madhe të dhënash, sekreteash e urtësish, të lidhura me ngjarje shumë të rëndësishme të Ditës së Gjykimit, që është edhe dita e kthimit të Allahu i Madhëruar. Informacione, të dhëna e sekrete, të cilat nuk mund të kuptohen përveçse nën dritën e argumenteve apo nën dritën e njohjes së thellë që prodhon devocioni dhe adhurimi.

Prej kërkesave dhe platformave të kësaj Zbulese Hyjnore është njohja me argumentet e ndryshme, të cilat Allahu i Lartësuar i ka përmendur apo i ka sjellë për të vërtetuar apo për të përshkruar çështje të lidhura me Qenien e Tij të Shenjtë, siç janë Njehsimi, Pakrahasueshmëria, Unikiteti, Dituria, Fuqia dhe të tjera cilësi që përshkruajnë Përsosmërinë e Tij. Te kjo kategori ajetesh mund të gjenden argumente të hollësishme, prej të cilave mund të kuptojnë shumë njerëzit e dijes, të njohjes dhe të afrimitetit, siç është për shembull, ajeti kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë: "شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ" **"Allahu dëshmon se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij."**<sup>93</sup>

<sup>92</sup> Sure "El Mutaaffifin", ajeti 15.

<sup>93</sup> Sure "Ali Imran", ajeti 18.

Ka kategori të tjera ajetesh, gjithashtu, prej të cilave mund të përfitojnë njëkohësisht edhe të urtët, edhe dijetarët, edhe komentuesit sipërfaqësorë, edhe pjesa tjetër e njerëzve të thjeshtë, siç është për shembull ajeti kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"لو كان فيهما الهة إلا الله لفسدت" **"Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin."**<sup>94</sup>

Në një ajete tjetër thotë: "إِذَا لَذُحِبَ كُلُّ إِلَهٍ بِمَا خَلَقَ" **"Çdo zot do të merrte atë që ka krijuar"**,<sup>95</sup> apo siç janë për shembull ajetet e para të sures "El Hadid". Të tjera ajete kur'anore vijnë për të argumentuar Ringjalljen, Botën e Përtejme, si dhe rikthimin e shpirtit, si dhe të tjera ajete që vijnë, gjithashtu, për të argumentuar praninë e engjëjve, si dhe të Profetëve të mëdhenj (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*).

Pjesa më e madhe e ajeteve të mësipërme janë të lidhura me kategorinë e argumenteve, të cilat, më së shumti, trajtohen çështjet e lidhura me Qenien Hyjnore dhe me vetë ekzistencën e Zotit. Ndërsa, përsa i përket pjesës tjetër të dijeve dhe të dhënave, apo të dukurive të tjera, të përmendura në të, Allahu i Madhëruar ka sjellë shpesh argumentet e Profetëve, siç ishin për shembull argumentet e Profetit Ibrahim apo të atij që njihet si (Halilur-Rrahman/i dashuri i Mëshiruesit).

<sup>94</sup> Sure "El Enbija", ajeti 22.

<sup>95</sup> Sure "El Mu'minun", ajeti 91.

Këto ajete, të cilat i cekëm më sipër, janë, në përgjithësi, pjesa kryesore e kërkesave apo e synimeve të Kur'anit. Për të cekur e për të trajtuar edhe pjesën tjetër të ajeteve, nevojitet një hapësirë kohore më e gjerë.

## **RRETH MËNYRAVE TË PËRFITIMIT PREJ KUR'ANIT<sup>96</sup>**

Duke qenë se jemi tashmë të mirinformuar për qëllimet dhe synimet përfundimtare të Zbulesës Hyjnore, duhet të orientojmë përqendrimin tonë për të kuptuar mënyrën nëpërmjet të cilës mund të përfitojmë sa më shumë prej kësaj dhurate shumë të rëndësishme Hyjnore.

Është momenti më i përshtatshëm për të hapur dyert e zemrës dhe për ta ndriçuar atë me dritën e dijes dhe të urtësisë së përftuar prej këtij Mesazhi Hyjnor. Është moment i përshtatshëm, që ta shohim atë si burimin më të rëndësishëm dhe më të kulluar të dijes, që na nevojitet sot më shumë se kurrë. Ky është momenti më i përshtatshëm për ta angazhuar qenien, mendjen dhe shpirtin, duke i punësuar ato zyrtarisht në nxënien e dijes dhe në përfitim të urtësisë prej asaj dritareje aq të madhe që na ekspozon kah Dritës Hyjnore. Të mësohesh prej Kur'anit Famëlartë dhe të ndriçohesh, njëkohësisht, prej dritës së tij, nuk do të thotë që të ndalesh te mrekullitë letrare, gjuhësore, gramatike dhe të elokuencës që përfaqëson ai në të gjithë

---

<sup>96</sup> "El Adabul Manevijeh Lis-Salat", "Normat edukative të namazit", f. 332.

shtrirjen dhe sipërfaqen e vet. Nuk do të thotë, gjithashtu, që të ndalesh thjesht, te disa histori të bukura Profetësh, të cilat i sjell aq bukur ai.

Të gjitha këto janë të nevojshme, madje e pasurojnë dhe e zgjerojnë shumë natyrën e përfitimit tonë prej tij, por duhet të jemi të vëmendshëm dhe të kuptojmë se nuk është ky qëllimi më madhor i Zbulesës Hyjnore. Një qasje e tillë, e parë në një dimension kaq të ngushtë, nuk ka të bëjë aspak me qëllimet përfundimtare të Kur'anit. Kjo formë e të parit dhe e të lexuarit të tij, në mos qoftë tërësisht e pavlefshme, është niveli dhe shkalla më e ulët e qasjes dhe e përfitimit ndaj një oqeani dijeje të përmasave të tilla.

Gjendemi përballë dy rrugëve, që nuk kanë të tretë: ta mësojmë Kur'anin për ta lexuar bukur, rrjedhshëm dhe pa gabime. Ta mësojmë atë thjesht, për të përftuar mirësinë dhe shpërblimin që të ofron leximi i tij, ashtu siç ka ndodhur fatkeqësisht me myslimanët gjatë këtyre dekadave të fundit. Lexim i rrjedhshëm dhe me zëra të mahnitshëm, duke shmangur plotësisht kuptimin e qëllimeve të tij. Prej dyzet vjetësh Kur'ani recitohet nëpër ceremoni të ndryshme të myslimanëve, por asnjë lloj përfitimi nuk i ka ardhur atyre prej leximit të tij, përveç pjesës së shpërblimit që Zoti e ka caktuar për leximin e tij. Ndërsa mënyra tjetër dhe e duhura është të depërtojmë nëpërmjet inteligjencës së thellësive të kuptimeve të tij, thellësive të gramatikës, të formës, të gjuhës së përdorur, të mrekullive të shumta dhe të llojeve të ndryshme, të

magjisë që përfaqësojnë historitë e ndryshme të përmendura në të, koha e zbritjes e secilit ajet, e lidhur mrekullisht me arsye dhe shkaqe nga më të larmishmit për zbritjen e secilit prej tyre. Duhet të hyjmë thellësive të veçorive të secilit ajet, nëse është mekas apo medinas, të njihemi me llojet dhe me format e larmishme të këndimeve të Kur'anit. Të hyjmë thellë llojeve të ndryshme të komentimeve që dijetarët e tefsirit kanë bërë për llojet e ndryshme të ajeteve (të veçantat dhe të përgjithshmet) dhe të tjera çështje shumë të rëndësishme, të trajtuara gjerë e gjatë prej dijetarëve.

Duhet t'u hyjmë thellë të gjitha atyre kuptimeve dhe komentimeve kur'anore, të cilat e pamundësojnë çdo lloj justifikimi tonin, të lidhur me paditurinë dhe mungesën e njohjes së dimensioneve të caktuara të tij, që mund të bëhen shkak për moskujtesën e Allahut të Madhëruar dhe shkëputjen e lidhjeve më Të.

Në fakt, pjesa më e madhe e dijetarëve dhe e komentuesve të Kur'anit kanë trajtuar me studimet e tyre një pjesë të caktuar të fushave të sipërpërmendura, ose shumë prej tyre, me aq sa kanë mundur. Shkruesi i këtij libri është i mendimit se askush prej dijetarëve nuk ka mundur deri më sot të shkruajë një komentim gjithëpërfshirës të Kur'anit Famëlartë. Me dëshminë e vetë Allahut të Madhëruar, ky është një Libër i mbushur me dritë, me udhëzim, me dije dhe me këshilla të nevojshme për rrugëtimin e qenies për tek Krijuesi i saj. Nisur nga kjo,

është detyrë e çdo dijetari dhe e çdo komentuesi, që të rrëfejë, të zbërthejë dhe të shpalosë për kërkuesit e dijes, të gjitha dimensionet dhe dritën që përfaqëson secila prej fjalëve dhe historive të Zbulesës Hyjnore, madje secilin prej ajeteve të përmendura në të. Është detyrë e dijetarëve të përmendin natyrën e udhëzimit të njerëzve për në rrugën e lumturisë, të njohjes së tyre me botën e të padukshmes (alemul gajb)<sup>97</sup> dhe me njohjen e rrugës së dijes dhe takimit me njerëzoren.

Po japim një shembull, lidhur me këtë: Kur një komentues Kur'ani sjell dhe shpjegon për ne arsyen dhe shkaqet e zbritjes së ajtit kur'anor, atëherë ai është komentues i shkaktuesit të zbritjes, ashtu siç ndodh nëpër libra të ndryshëm të komentimit. Një tregues për këtë mund të jetë tregimi dhe shpalosja e historisë së Ademit dhe të Havasë (dy krijesat e para të njerëzimit), duke nisur që prej krijimit, për të kaluar te historia e tyre e njohur me Iblisin e deri te zbritja e tyre në Tokë. Kjo është një histori, të cilën Allahu i Madhëruar e ka përmendur shpesh në Kur'anin Famëlartë. Pjesa më e madhe e besimtarëve njihen me sasinë e madhe të urtësive dhe të mësimëve që janë të pranishme te ajo histori. Të gjithë ata që i lexojnë dhe i meditojnë me kujdes detajet e përmendura në Kur'an të kësaj historie, vërejnë se sa e komplikuar është qenia njerëzore, sa e luhatshme është sjellja e saj, në varësi të

---

<sup>97</sup> Është përmendur më sipër. Për më tepër sqarim, kthehu te faqja 12.

rrethanave dhe të ngjarjeve dhe sa herë sjellja e saj vështirësohet me sjellje dhe forma të ngjashme me atë të sjelljes dhe natyrës së Iblisit (*Mallkuar qoftë prej Zotit!*). Të gjitha këto, janë të dhëna e informacione ndaj të cilave nuk jemi gjithmonë të vëmendshëm.

Në të përgjithshmen e tij, Libri i Allahut është një “meny” e larmishme qiellore, e mbushur me dije shumë, urtësi të mëdha, moral dhe një udhërrëfyes i qartë për lumturinë e njeriut dhe përsosmërinë e tij. Kështu, pra, librat e komentimit të Kur’anit Famëljartë duhet të jenë njëkohësisht të ngarkuar me njohuri, me dije, me moral, me vlera dhe me të gjitha shpjegimet, që sjellin për lexuesin dimensionet udhërrëfyese të tekstit kur’anor.

Komentuesit që nuk i përmendin këto çështje, i anashkalojnë, i mënjanojnë, i nënvlerësojnë dhe nuk u japin atyre rëndësinë që meritojnë, duhet ta kenë të qartë se janë duke mënjанuar, duke anashkaluar dhe duke nënvlerësuar qëllimet kryesore të Kur’anit, synimet strategjike të Zbulesës Hyjnore dhe të dërgimit të Profetëve prej Krijuesit të Gjithësisë. Ky është njëri prej gabimeve madhore dhe njëra prej fatkeqësive më të mëdha, të cilat u kanë ndodhur myslimanëve dhe është bërë një pengesë e madhe për udhëzimin e tyre dhe të pjesës tjetër të njerëzve për në rrugën e drejtë. Është shumë e rëndësishme të dihet, gjithashtu, fakti se qëllimet kryesore të Kur’anit dhe synimet strategjike të tij duhet të përthithen dhe duhet të kuptohen prej tekstit dhe kuptimeve të qarta të

përmendura në të dhe, pasi të jetë përfunduar ky proces, i krijohet hapësirë mendjes dhe intelektit njerëzor për të depërtuar për te të tjera hapësira e thellësi të kuptimeve të tij. Në asnjë rast nuk mund të jetë mendja apo interpretimi, apo përfytyrimi ynë tërësisht i pavarur, që përcaktojë qëllimet strategjike të Kur'anit. Kur'ani ka përparësi të plotë të shpjegojë dhe të komentojë qëllimet e vetvetes.

Nëse do t'i referohemi dëshmime të burimit të Kur'anit, do të lexojmë: "ذلك الكتاب لا ريب فيه هدى للمتقين" **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**<sup>98</sup>

Në këtë ajet gjejmë të shkruar qartë se Kur'ani cilësohet si një libër që përfaqëson të vërtetën absolute. Te të tjera ajete kur'anore gjejmë të përsëritur, gjithashtu, një tjetër dëshmi, në të cilën Allahu i Madhëruar thotë:

"ولقد يسرنا القرآن للذكر فهل من مدكر" **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar."**<sup>99</sup>  
Gjithashtu, lexojmë:

"وأنزلنا إليك الذكر لتبين للناس ما نزل إليهم ولعلهم يتفكرون" **"Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve, atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë."**<sup>100</sup>

Në një vend tjetër lexojmë:

<sup>98</sup> Sure "El Bekare", ajeti 2.

<sup>99</sup> Sure "El Kamer", ajeti 17.

<sup>100</sup> Sure "En Nahl", ajeti 44.

"Ky (Kur'an) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (o Muhamed) për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me mendarët."<sup>101</sup>

Ajete të tilla, të ngjashme, janë të shumta, por për të qenë sa më përmbledhës dhe të shkurtuar, mjaftohemi me kaq. Në vija të përgjithshme, kam dëshirë të ritheksoj dhe të them se ajo çka kemi shkruar më sipër, nuk ka për qëllim të kritikojë punën e komentuesve të Kur'anit, pasi ne të gjithë duhet të rezervojmë respekt dhe vlerësim maksimal për lodhjen dhe mundimin e tyre të pamasë, në përpjekje për të plotësuar sa të munden kuptimet e dukshme të Zbulesës Hyjnore.

I lutem Allahut të Plotfuqishëm, që të shpërblejë mundin dhe sakrificat e tyre! Ajo që dua të them është se këto komentime dhe përpjekje duhet të ndihmojnë njerëzimin të kuptojnë synimet dhe qëllimet kryesore të mesazhit kur'anor, pasi është i vetmi libër që i udhëzon njerëzit kah Allahu i Madhëruar dhe i njeh ata me Librin unik.<sup>102</sup> Ai është i vetmi libër që i njeh njerëzit me dispozitat e moralit, me rregullat dhe me normat hyjnore. Te ai Libër gjendet mënyra më e mirë dhe rruga më e shpejtë për të lidhur krijesën me Krijuesin e vet, me hallkën më të fortë që e mban Qiellin të lidhur me Tokën dhe këtë

---

<sup>101</sup> Sure "Sad", ajeti 29.

<sup>102</sup> Është përmendur më sipër. Kthehu atje për shpjegime të mëtejshme.

të fundit me kuptimet më të thella dhe më të fuqishme të Njehsimit.

Le të shkruajnë dijetarët e nderuar dhe komentuesit e Kur'anit në gjuhën perse a në gjuhën arabe dhe nëpërmjet tyre të sqarojnë dhe të shpjegojnë për njerëzit kërkesat dhe synimet morale e edukuese të Kur'anit. Të sqarojnë për ata mënyrën më të drejtë dhe më të shpejtë të lidhjes së njeriut me Krijuesin e vet. T'u shpjegojnë njerëzve si të arratisen me qeniet e tyre prej botës mashtruese të përkohshmërisë, për te bota e vërtetë e përjetësisë. Le t'i bëjnë të gjitha këto sqarime ashtu siç i ka synuar dhe i ka nënkuptuar burimi i këtij Libri të Madh.

Autor i këtij Libri të madh nuk është as Es-Sekaki<sup>103</sup> as Esh-Shejh,<sup>104</sup> që të themi se kemi të bëjmë me fushën e

---

<sup>103</sup> Ai është Ebu Ja'kub Jusuf bin Ebu Bekr bin Muhamed El-Khauarizmij, El-Mu'tezilij, El-Hanefij, i njohur me emrin Seraxhud-diin Es-Sekaki, autori i librit "Miftahul Ulum". Pjesën e tretë të tij e ka shkruar të përmbledhur Khatiib Dimeshkij. Gjithashtu, e ka komentuar shkurtimisht dhe në mënyrë të zgjeruar "Et-Teftazani". Është ndarë nga jeta në vitin 726 h.k.

<sup>104</sup> Esh-Shejh është: Ebu Xha'afer Muhamed Ibnul Hasan ibn Ali Et-Tusij. Ai është shtylla kryesore e shi'itëve, ngritësi lart i flamurit të sheriatit, hoxha shumë i ditur me autoritet fetar absolut, si dhe kreu i padiskutueshëm i medh'hebit, para dijes së të cilit ulen kokat më të mëdha të kohës. Ai ka mundur të shkruajë libra rreth të gjitha dijeve, të lidhura me Islamin dhe ka qenë një shembull i vyer në këtë fushë. Ai ka qenë nxënës i Esh-Shejh El-Mufid, si dhe i Es-Sejid El-Murtedasë. Nxënësit e tij më të mirë kanë qenë prej muxhtehidëve dhe numri i tyre ka qenë përafërsisht 300 dijetarë prej të zakonshmëve dhe prej të veçantëve. Ai ka lindur në Muajin Ramazan, të vitit 385, dy vjet pas vdekjes së Es-Sejid Err-Ridas. Në fillimet e tij ka jetuar në Bagdad dhe

elokuencës, të gramatikës e të drejtshkrimit. Nuk kemi të bëjmë gjithashtu as me Sibeuejhin<sup>105</sup> dhe as me El-Khalil,

më pas është transferuar për në Meshhedin e Prijësit të Besimtarëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) për të shmangur “fitnen” ngatërresat dhe trazirat në Bagdad. Në ato trazira, në të cilat u dogjën librat e tij dhe bashkë me to edhe një karrige mbi të cilën ulej dhe prej nga ku u fliste jo vetëm njerëzve të thjeshtë, por edhe nxënësve të tij të dijes. Ajo karrige konsiderohej si karrigia e pasardhësve. Pozita e tij në Bagdad ka qenë e njëjtë me atë të Esh-Shejhul Mufidit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) për rreth pesë vite dhe me atë të Es-Sejid El-Murtedasë për rreth njëzet e tetë vite. Pas Es-Sejdit ka qëndruar atje për njëzet e katër vite, dymbëdhjetë prej të cilave në Bagdad dhe më pas është transferuar për në Nexhef El Eshref. Ka qëndruar atje deri sa është ndarë prej jetës, mbrëmjen e të hënës, njëzet e dy të muajit Muharrem, të vitit 460(h) në moshën shtatëdhjetë e gjashtë vjeçare. Është varrosur në shtëpinë e tij. Varri i tij është i njohur në xhaminë e quajtur “Xhamia e Tusit”- “Mesxhidut-Tusijj”. Përsa u përket librave të tij të bekuar në shkencat islame, ato janë aq të njohura, sa e bën të panevojshme t’i përmendim sërish. Tefsiri i përmendur prej Imam Khomeinit është “El Bejanul Xhami’i Li Ulumil Kur’an”, i cili konsiderohet një libër madhështor, i jashtëzakonshëm dhe unik në lëmin e komentimeve të Kur’anit. Lidhur me këtë, shejhu (hoxha) ynë Et-Tubrusij shkruan në librin (komentimin/tefsirin e tij) dhe e pranon këtë madhështi dhe unikalitet të padiskutueshëm në hyrje të librit të tij. (*Kënaqësia dhe lumturia e Allahut të Gjithëdijshëm qoftë mbi ta!*).

<sup>105</sup> Es-Sibeuejh është Ebul Hasen, ose Ebu Bishr Amr bin Uthman bin Kamber El-Farisij El-Bejdaui. El-Irakij El-Basrij, gjuhëtari i njohur, autor i librit “Fil Afak”, për të cilin El-Allameh Et-Tabatabaii (*Allahu e mëshiroftë!*) ka shkruar dhe ka thënë se ai është një det i madh dijes. Dijetarët e të shkuarës dhe të tashmes janë të gjithë nxënës përpara këtij kolosi të madh të gjuhësisë. Mësimet e tij i ka marrë prej El-Khalil bin Ahmed En-Nahauj, shumë i njohur në kohën e tij. Atë e ka përmendur Imami në “Metnin” e tij, e ka përmendur gjithashtu edhe Junusi, edhe El-Akhfesh, edhe Isa bin Amër. Të gjitha historitë e tij janë të lidhura me Khalilin. Dijetarët e ndryshëm të shkencës së gramatikës

që të mendojmë se kemi të bëjmë me një libër gjuhësie dhe gramatike. Nuk kemi të bëjmë gjithashtu, as me “El-Mesudin”<sup>106</sup> dhe as me “Khalikan-nin”,<sup>107</sup> që të themi se është një libër i historisë së botës.

arabe kanë folur dhe kanë thënë fjalë të mira për librin e tij “El-Kitab”. Madje ata kanë shkruar edhe libra për të komentuar dhe për t’iu kundërpërgjigjur disa çështjeve që nuk i kanë menduar në të njëjtën mënyrë me të. Historia e vizitës së tij në Bagdad dhe debati i famshëm me El-Kesain është i njohur prej të gjithëve. Thuhet se është ndarë nga jeta në vitin (180 hixhri) dhe varri i tij gjendet në Shiraz. Ebu Shuhneh El-Hanefij te “Reudatul Menadhir” ka thënë: “Ebul Ferexh ibn Xheuzij ka thënë se Sibeuejhi është ndarë nga jeta në vitin 194 (hixhri), në moshën 32 vjeçare, në qytetin Saveh. Lidhur me këtë, Khatib Bagdadi ka transmetuar nga Ibn Durejdi se Sibeuejhi është ndarë nga jeta në Shiraz, në qytetin Saveh, madje edhe varri i tij gjendet pikërisht atje.” (Fund i dëshmisë). Ka qenë një djalosh i ri, i bukur, i pastër, i mbajtur, bardhosh, me një të kuqe të lehtë, që i bënte faqet e tij të dukeshin si dy mollë të kuqe. Kjo është arsyeja përse është quajtur Sibeuejh, pasi në gjuhën perse mollës i thonë “sib”. Disa dijetarë apo bashkëkohës të tjerë thonë se është quajtur Sibeuejh, sepse ka qenë zakon i tij të thithte aromën e mollës dhe këtë e bënte në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa unë jam i mendimit se varianti më i saktë është: Ai është quajtur Sibujeh, ku vihet re zanorja “u” pas bashkëtingëllores “b”, lënia e “vav”-it pa zanore dhe vendosja e zanores “e” pas bashkëtingëllores “j”.

<sup>106</sup> Ai është quajtur “Shejhul Muerikhine ue Imaduhum apo kryehoxha, koka më e madhe e historianëve dhe një prej kolonave të tyre më të rëndësishme. Ai është Ebul-Hasen Ali bin Husejn bin Ali El Mesuudij El Hedhelij. Një dijetar i madh i kohës së tij, që ka shkëlqyer në çdo fushë. Ai është përmendur prej El Al-lameh, i cili ka thënë se ka shkruar rreth “Imames/imamllëkut” dhe shumë libra të tjerë. Ai ka shkruar gjithashtu “Ithbatul uesijeh” për Imam Aliun (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), siç ka shkruar gjithashtu librin “Muruxhudh-Dheheb” (fund). Burime të ndryshme thonë se ai ka lindur në Bagdad dhe më

pas ka lëvizur dhe është transferuar nëpër vende të tjera të ndryshme. Në vitin 309 ka shkuar në Persi dhe Kereman. Më pas kaloi për në Indi, në Meletan dhe më pas në Kenebajeh. Pas ca kohësh kaloi në Sernedib, më pas, nëpërmjet anijes kaloi për në Kinë. U rikthye sërish, duke kaluar Oqeanin Indian për t'u transferuar për në Uman (Omani i sotshëm). Pas vitit 314 udhëtoi sërish për në Azerbajxhan, më pas në Xherxhan (Gjeorgjia e sotshme) dhe sërish u kthye për në Sham (Damasku i sotëm) dhe më pas për në Palestinë. Thuhet se ka jetuar dhe është transferuar shpesh ndërmjet Damaskut (Shamit) dhe Misirit (Egjiptit). Ndërmjet viteve 336-344 tregohet se ka jetuar në Kistat dhe aty ka shkruar një libër, të titulluar "Ahbaruz-Zeman Ue Men Ebadehu El Hadethan", i përbërë prej tridhjetë vëllimesh. Prej atyre tridhjetë vëllimeve ka mundur t'i rezistojë kohës dhe të mbesë vetëm një vëllim. Ai ka shkruar, gjithashtu, librin "Dhekhairul Ulum Ue Ma Kane Fii Salifid-Duhur". Libra të tjerë të tij kanë qenë "Fii Akhabaril Umem Minel Arabi Uel Axhem", "El Mekalat Fii Usulid-Dijanat" dhe "Muruxhudh-Dheheb ue Meadinul Xheuher". Thuhet se ka qëndruar atje deri në vitin 345 (h).

<sup>107</sup> Ibn Khalekan është Ebul Abas Ahmed bin Muhammed bin Ibrahim bin Ebi Bekr bin Khalekan El-Irbilij El-Bermekij Esh-Shafi'ij. Ai është autori i librit të njohur të historisë, të titulluar "Uefijjatul A'ajan Ue Enbau Ebnai Zeman", ku ka trajtuar historitë e shumë "tabi'inëve"- "brezit pas sahabëve" më të njohur. Lidhur me të njëjtën periudhë kohore ka shkruar, gjithashtu, historinë e jetës së 864 jetëve, pa përmendur asnjërin prej sahabëve. Në fund të disa prej vëllimeve të tij (pas tyre), Salahud-Din Es-Safadij ka përmendur disa prej datave të vdekjeve të papërmendura prej tij dhe i ka quajtur "El Uafii Fil Uefijjat". Lidhur me arsyen përse gjyshi i Khalikanit është quajtur Khalikan, tregohet se një ditë prej ditëve ai krenohej në mesin e njerëzve me baballarët dhe gjyshërit e tij prej fisit El Bermek. Ata i thoshin atij: "Lëre babain, lëri gjyshërit dhe lëre familjen e paraardhësit e tu ç'kanë qenë dhe na trego si je dhe kush je ti sot." Lidhur me këtë, poeti thotë: "Njeriu është ai çka vetë është. Nuk është njeriu, çfarë ka qenë babai i tij." Nisur nga kjo, emri i tij është "khal-likan" me një "l" të fortë, e shoqëruar prej zanores "i".

Ky Libër madhështor nuk është si shkopi i Musait dhe as si dora e tij e bardhë, nuk është gjithashtu një histori e lidhur vetëm me mrekullinë e Isait dhe mënyra se si ai e ringjalli të vdekurin. Nuk është i lidhur, gjithashtu, vetëm me disa argumente që shpalosin vërtetësinë e profetësisë së Profetit tonë të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Qëllimi dhe synimi i Kur'anit Famëlartë, i kësaj mrekullie, që përfaqëson denjësisht këshillat dhe udhëzimet e Qiellit, është të ringjallë zemrat e njerëzve dhe t'i mbushë ato me shpresë e besim. T'i mbushë ato me njohuritë, dijet dhe mrekullitë që përfaqësojnë udhëzimet e hyjnore. Kështu, pra, nevojitet medoemos që komentuesit e Kur'anit të jenë njohës të mirë të çështjeve të Zotit dhe të thellësive ku fshihen ato kuptime hyjnore. Komentimi i Kur'anit Famëlartë nuk mund të realizohet me sukses prej çdo njeriu që shpreh dëshirën dhe vullnetin për të filozofuar dhe për të dhënë mendimet e tij lidhur me Zbulesën Hyjnore dhe qëllimet e saj. Komentuesi i Kur'anit, vetëm duke i njohur këto çështje që lidhen me Zotin dhe me qëllimet e hyjnore, mund të realizojë përfitimin e anëtarëve të njerëzimit prej atyre komentimeve, në mënyrën më të plotë të mundshme. Lidhur me këtë aspekt, Allahu i Madhëruar thotë:

"وننزل من القرآن ما هو شفاء ورحمة للمؤمنين ولا يزيد الظالمين إلا خسار"

**"Kemi zbritur në këtë Kur'an, shumë shërim dhe mëshirë për besimtarët, por (fatkeqsisht) ato janë bërë shkak që**

**zullumqarët të zhyten më shumë tek llumrat e humbjes së tyre.”<sup>108</sup>**

A mund të ketë vallë humbje më të madhe se sa të lexojmë Kur'anin Famëlartë për tridhjetë apo dyzet vite rresht dhe të mos kuptojmë asgjë prej qëllimeve të tij madhore. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ"

**“Zoti ynë! Ne i kemi bërë padrejtësi veteve tona. Nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron do të jemi prej të humburve.”<sup>109</sup>**

---

<sup>108</sup> Sure “El Isra”, ajeti 82.

<sup>109</sup> Sure “El A’araf”, ajeti 23.

## **RRETH NGRITJES, LARGIMIT TË PENGESAVE DHE TË PERDEVE NDËRMJET KUR'ANIT DHE PËRFITUESVE PREJ TIJ<sup>110</sup>**

Pasi të jesh njohur me Madhështinë e Librit të Allahut dhe me të gjitha dimensionet e tjera të tij, që e përforcojnë këtë madhësi, pasi të jenë hapur e të jenë zbuluar përpara teje horizontet e kuptimit të qëllimeve të Zbulesës Hyjnore, kërkohet prej përfituesve dhe atyre që mësojnë prej këtij Libri, të ushtrojnë edhe një normë tjetër shumë të rëndësishme, në mënyrë që përfitimi prej tij të kryhet në formën më të mirë dhe më të përsosur të mundshme. Kjo normë quhet “eliminimi i pengesave që pengojnë mësimin dhe përfitimin prej Kur’anit”. Në një formë tjetër, ne i quajmë ato “pengesa që qëndrojnë ndërmjet përfituesit dhe Kur’anit”. Këto perde dhe pengesa që qëndrojnë ndërmjet Kur’anit dhe përfituesve prej tij, shfaqen në mënyra të ndryshme dhe nga më të larmishmet. Le të sjellim për lexuesin disa prej tyre.

---

<sup>110</sup> “Normat Edukative të Namazit”, f. 339.

Njëra prej pengesave më të mëdha është pengesa e ngritur prej egos. Ajo konsiderohet prej pengesave më të mëdha dhe më të rrezikshme. Kjo lloj pengese është e lidhur me shfaqjen e egos dhe të mendjemadhësisë, si shprehje e mungesës së nevojës për këtë Libër, për këtë udhëzim. Ky është njëri prej kurtheve më të rrezikshme, të ngritura prej djallit të mallkuar. Ky lloj kurthi dhe kjo lloj pengese e rrezikshme, konsiston në faktin se njeriu është i vetëkënaqur me dijet dhe mendimet që ka, duke shprehur me fodullëk, mendjemadhësi dhe arrogancë refuzimin e tij të gjithçkaje tjetër që vjen nga jashtë, përfshi këtu edhe mesazhin, edhe thesarin e madh të ardhur prej Zotit të botëve, prej Krijuesit të Gjithësisë.

Një formë tjetër e rrezikshme, nëpërmjet të cilës shfaqet ky lloj kurthi i Iblisit të mallkuar dhe kjo lloj perdeje, është për shembull, refuzimi që disa prej lexuesve dhe recituesve profesionistë të Kur'anit, u bëjnë llojeve të tjera të dijeve dhe të shkencave të ndodhura në komentimin e atyre ajeteve, të cilat ata i recitojnë aq mrekullisht. Shejtani i mallkuar e zbukuron dhe e rrit te sytë e tyre recitimën e bukur që ata bëjnë, deri në ato përmasa, derisa ata nisin të refuzojnë gjithçka tjetër që lidhet me Kur'anin, përveç asaj që dinë të bëjnë vetë. Kjo lloj egoje dhe kjo lloj arrogancë e fshehur bëhet pengesë e madhe dhe një perde e trashë ndërmjet tyre dhe përfitimit të dijeve dhe urtësive të pafundme që gjenden në Kur'an. E njëjta gjë ndodh edhe me një pjesë të madhe të gjuhëtarëve

dhe njerëzve të letrave, të cilët përqendrohen vetëm te dimensionin letrar dhe gjuhësor i Kur'anit, duke ia kufizuar vetes përfitimin prej dijeve të tjera që gjenden në të. Kjo kategori njerëzish, merret, përgjithësisht, me aspektet gjuhësore të Kur'anit dhe përpiqet t'u imponohet pjesës tjetër të dijetarëve dhe të komentuesve me çështje të lidhura ngushtësisht me dimension gjuhësor të ajeteve, me shkaqet e zbritjes së tyre, me numrin e ajeteve, me numrin e shkronjave të atyre ajeteve, apo me të qenit e ajeteve mekase apo medinase (referuar kohës së zbritjes së tyre). etj.

Një pjesë tjetër e dijetarëve trajtojnë dhe studiojnë me fanatizëm të madh vetëm dimensionin artistik të Shpalljes, apo mënyrat nëpërmjet të cilave ajo u imponohet njerëzve si argument i padiskutueshëm. Këta njerëz shkojnë deri aty sa të pretendojnë se filozofët, të urtët dhe njohësit e mëdhenj (arifinët) kanë pengesa në kuptimin e Kur'anit, për mungesë të njohjes së tyre të këtyre detajeve të tjera, të lidhura me anën gjuhësore, artistike dhe historike të tij. Kështu, pra, të gjithë ata njerëz apo besimtarë, të cilët janë të interesuar që të njihen nga afër me të gjitha llojet e dijeve dhe të urtësive të përfshira në Zbulesën Hyjnore, duhet t'i tejkalojnë ato pengesa dhe duhet t'i grisin ato perde që bëhen pengesa për shikimin e tyre dhe njohjen e qenies me të gjitha mrekullitë e pranishme në Kur'an. Kjo është e vetmja mënyrë dhe e vetmja rrugë që ata të mos mbeten mbrapa karvanit të

njohësve të mëdhenj të Allahut dhe të atyre që kanë nisur rrugëtimin e mrekullueshëm për te Ai. Kjo është e vetmja mënyrë që ata të përfitojnë të gjithë dozën e shijes dhe të ëmbëlsisë së fshehur te secili ajetet kur'anor dhe te secila prej sureve të tij. Lidhur me këto kuptime është folur shpesh në të gjitha historitë e përmendura në Kur'anin Famëllartë.

Një shembull i qartë, lidhur me këtë, është Profeti Musa (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Me gjithë pozitën e tij të lartë në dituri dhe në besim, si njeriu që ka zhvilluar një bisedë dhe një komunikim të drejtpërdrejtë me Allahun e Madhërishëm, ai nuk ka nguruar që të përfitojë dhe të marrë prej dijeve të të tjerëve, sapo i është dhënë rasti për ta bërë këtë dhe sapo e ka ndier të nevojshme për ta bërë një gjë të tillë. Kjo duket qartë kur lexojmë dhe shikojmë në Kur'an se me modestinë dhe më përluljen më të lartë njerëzore Profeti Musa (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) ka kërkuar prej Khudrit që ta mësojë atë. Lidhur me këtë aspekt dhe me këtë sjellje të Musait (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëllartë:

"هل أتبعك على أن تُعلمنِ مما علمت رشداً" **"Musai i tha atij: 'A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua dicka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?'"**.<sup>111</sup>

Kështu, pra, Profeti i Zotit, Musai (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), e detyroi veten, që t'i shërbejë Khudrit derisa të

---

<sup>111</sup> Sure "El Kehf", ajeti 66.

mernte prej tij ato dituri, për të cilat kishte nevojë dhe që i duheshin patjetër.

Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) gjithashtu, nuk u josh aspak dhe nuk u ndje i mbivlerësuar prej pozitave të larta të besimit dhe të profetësisë, por tha (sipas dëshmisë kur'anore): "رَبِّ أَرْنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَى" **"Ibrahimi tha: 'O Zoti im!'**

**Tregomë mua si i ngjall të vdekurit."**<sup>112</sup>

Nëpërmjet kësaj thirrjeje dhe lutjeje, Ibrahimi po përpiquej të kalonte nga gjendja e besimit në të padukshmen për te grada dhe shkalla e qetësimit të shpirtit nëpërmjet të dukshmes dhe të prekshmes. Mbi të gjitha këto qëndron ftesa e Allahut të Madhëruar drejtuar Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), që edhe pse ishte i mësuar prej vetë Zotit për kuptimet e fjalëve dhe të ajeteve të Kur'anit, ai i thotë atij: **"Zoti im, më shto mua dituri."**<sup>113</sup>

Të gjitha këto urdhëresa dhe të gjitha këto histori të përmendura në Kur'anin Famëljartë, nuk vijnë pa qëllim, por janë aty për të na zgjuar të gjithëve prej gjumit të paditurië.

Lloje të tjera pengesash dhe perdes, për syrin dhe për zemrën janë gjithashtu mendimet e këqija dhe të pavlera, si dhe rrymat, shkollat dhe medh'hebet e prishura të mendimit. Kjo është një prej dukurive më të përhapura,

<sup>112</sup> Sure "El Bekare", ajeti 260.

<sup>113</sup> Sure "Ta Ha", ajeti 114.

që shkaktohet kryesisht për arsye të xhelozisë, apo për arsye të fanatizmit ekstrem në ndjekjen e një mendimi, të një medh'hebi apo të një sekti të caktuar brenda fesë. Një rast tipik, që mund ta ilustrojë këtë fanatizëm ekstrem dhe të i cili mishërohet më së miri ndjekja e verbër dhe rigoroze e një mendimi apo të një orientimi të caktuar, është për shembull, të qenit fanatik i mendimeve dhe i gjykimeve të trashëguara prej prindërve, qoftë nënës apo babait.

Një rast tjetër është ndjekja me fanatizëm e ndonjë të padituri apo injoranti, që ka zënë një xhami dhe mban ligjërata, duke u mbajtur për dijetar i madh. Ky lloj fanatizmi justifikohet shpesh me ndjekjen dhe të qenit besnik i shehut (hoxhës) dhe mendimeve të tij. Ky lloj orientimi dhe këto lloje fanatizmash janë shumë të dëmshme për besimtarin, pasi bëhen pengesë ndërmjet tij dhe dritës së zbritur prej Allahut të Madhëruar. Në rast se gjenden mijëra ajete dhe histori, të cilat e kundërshtojnë këtë lloj besimi, ose do t'u japim atyre kuptim të ndryshëm nga ai sipërfaqësor, ose të bëjmë sikur nuk i kuptojmë dhe shembujt e lidhur me këtë, përse u përket njohurive dhe akaidit (besimit) janë të shumta, por unë nuk do të ndalem për t'i numëruar. Jam i bindur se kjo perde dhe kjo pengesë e madhe nuk mund të çahet e as të tejkalohet vetëm me fjalë të bukura, të mbushura me moral, por unë do të sjell vetëm një rën prej tyre, pasi ajo është e lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u perceptuar në të përgjithshmen e vet.

Janë të shumta ajetet kur'anore që flasin për njohjen e Allahut dhe kthimin te Ai. Lidhur me këto çështje ekziston një sasi shumë e madhe historish, si dhe një sasi tjetër po aq e madhe shenjash, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, që janë të pranishme fuqimisht te duatë, lutjet dhe përgjërimet e ndryshme të kryera prej imamëve të nderuar (*Paqja e Zotit qoftë mbi ta!*). Kështu, sapo të krijohet për njerëzit e thjeshtë dhe të përhapet ndërmjet tyre ideja dhe besimi se rruga për te njohja e Allahut të Madhëruar është plotësisht e mbyllur, duke e krahasuar njohjen e Allahut dhe shikimin për te Bukuria e Tij, me shikimin e vetë Qenies Hyjnore, që është në thelb i ndaluar, pra, i pamundur, ose kanë për të hequr dorë plotësisht prej atyre transmetimeve dhe prej atyre shenjave të pranishme te lutjet dhe përgjërimet e imamëve të nderuar (*Paqja e Zotit qoftë mbi ta!*), ose nuk kanë për t'u marrë fare me këtë çështje, duke ia larguar vetes mundësinë që t'i marrë ato njohuri aq të rëndësishme, të cilat ishin njëkohësisht drita e syve të Profetëve dhe e njohësve të mëdhenj.

Një dukuri tjetër e papëlqyeshme, që ngacmon thellë qenies keqardhje të madhe, është fakti se njohësit e mëdhenj të Allahut dhe adhuruesit e mëdhenj të Tij, kanë mbyllur për njerëzit e thjeshtë, prej ndjekësve të tyre, një derë shumë të rëndësishme të dijeve, e cila është pa diskutim synimi dhe qëllimi kryesor i dërgesës së Profetëve, si dhe pikësynimi kryesor i eulijave, duke argumentuar se thjesht belbëzimi i tij me gojë është dalje

prej fesë (kufër). Ata kanë larguar, gjithashtu, të gjithë ata injorantë që kanë besuar se njohuritë e Profetëve dhe të eulijave, lidhur me qenien e Allahut të Madhëruar, lidhur me Emrat dhe Cilësitë e Tij, është e barabartë apo e ngjashme me njohuritë që kanë njerëzit e thjeshtë dhe gratë. Kjo kategori njerëzish shkon edhe përtej kësaj që sapo përmendëm, duke bërë pohime akoma më të mëdha lidhur me këtë pjesë. Dikush prej tyre vjen dhe thotë kështu: “Filani ka një formë popullore dhe shumë të thjeshtë të të besuarit. Ah, sikur të kishim edhe ne një formë të tillë të thjeshtë dhe popullore besimi (akaidi).”

E thënë prej tij, ky pohim është i vërtetë, pasi ky, i varfri, ka nxjerrë prej duarve të tij besimet e njerëzve të thjeshtë dhe është i mendimit se besimet (akaidet) e njohësve të Allahut dhe të eulijavë janë të kota, pra, tërësisht të pavlefshme. Kështu, kjo lloj shprese dhe kjo lloj dëshire e shprehur prej tij është plotësisht e ngjashme me shpresën dhe dëshirën e mohuesve të fesë, ashtu siç thuhet për ta në ajetin kur'anor: "ويقول الكافر يا ليتني كنت تراب" **“Në Ditën e Gjykimit, femohuesit do të thonë: ‘Ah, sikur të kishim qenë pluhur.’”**<sup>114</sup>

Përfundimisht, nëse do të sjellim për lexuesin të gjitha ajetet që kanë të bëjnë me takimin e Allahut të Madhëruar dhe detajet e lidhura me këtë, për të hedhur poshtë këtë besim apo besëtytni të kotë, të cytur nga

<sup>114</sup> Sure “En Nebe”, ajeti 40.

shejtani i mallkuar, por edhe nga injoranca e vetë njeriut, do të ishte plotësisht e pamundur, pasi, lidhur me këtë, mund të jetë e nevojshme të shkruhet një libër i plotë dhe do të duhej patjetër të bëhej një trajtesë e veçantë. Një trajtesë e veçantë, do të nevojitej, gjithashtu, edhe për njohuritë e shumta, të mbetura pas perdes së harresës, si një pengesë shumë e madhe që dikton njërin prej gradëve dhe shkallëve të largimit dhe të braktisjes së Kur'anit dhe qëllimeve të tij. Dhimbja e madhe, që shpreh qartë këtë braktisje, është e përmendur edhe në ajetin kur'anor, të cilin Allahu i Madhëruar e thotë nëpërmjet gojës së Profetit Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*):

**“Dhe i Dërguari do të thotë: ‘O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kur'anin, si (diçka) të urryer.’”**<sup>115</sup>

Braktisja e Kur'anit dhe harresa e tij është e shkallëve dhe e gradëve të ndryshme. Mund ta themi me plot gojën se ne jemi të përfshirë prej pjesës më të madhe të atyre shkallëve. Vërtet, besoni se duke e shtypur atë Kur'an në shtypshkronja moderne dhe duke e mbështjellë atë me lëkura të çmuara, apo duke e puthur atë dhe duke e vënë në ballë gjatë kohës kur bëni “istihare”, do të thotë se ne nuk e keni braktisur atë?! A mos vallë mendoni se, duke e shpenzuar të gjithë jetën tonë me studimin e gramatikës

<sup>115</sup> Sure “Lukman”, ajeti 30.

së tij, apo duke përsosur recitimin e tij, apo me konstatimin e formave të ndryshme të mrekullive të shfaqura në të, ne nuk e keni braktisur Kur'anin?! A mos vallë besojnë disa njerëz dhe janë të bindur se, duke mësuar format dhe mënyrat e larmishme të leximit dhe të recitimit të tij, mund të shpëtojnë prej turpits të braktisjes së Kur'anit?! A mos vallë mendojnë dhe besojnë disa njerëz se vetëm duke mësuar e duke shpjeguar format e ndryshme dhe të larmishme të mrekullive, si dhe llojet e ndryshme të artit gjuhësor e matematikor, të shfaqura në të, na shpëtojnë ne prej ankesës së krijesës më të dashur të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*)?! Përgjigjja është jo, kurrësi, jo. Asnjë prej çështjeve të sipërpërmendura nuk është pjesë e qëllimeve dhe e synimeve përfundimtare dhe madhore të Allahut të Madhëruar dhe arsyeja përse e dërgoi këtë Zbulësë Hyjnore. Kur'ani është një Libër Hyjnor dhe mesazhi i tij është gjithashtu Hyjnor. Kur'ani është litari që mban lidhur Krijuesin me krijesën dhe kjo e bën të detyrueshme ekzistencën e një lidhjeje të fortë të krijesës me udhëzimet e ardhura prej Krijuesit dhe Edukuesit. Kërkohej, gjithashtu, që prej këtij Libri të jashtëzakonshëm të përftohen të gjitha dijet Hyjnore dhe dijet “el-ledunijeh”.<sup>116</sup>

---

<sup>116</sup> Dija “El-ledunijeh” është ajo dije që vjen drejtpërdrejtë nga Allahu i Madhëruar, pa pasur nevojën e një ndërmjetësimi. Këtë e gjejmë të pranishme në një ajet kur'anor, ku Allahu i Madhëruar thotë: “**Ne i kemi dhënë atij prej dijes sonë.**”

Në një transmetim, të ardhur prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), të përmendur në librin “El-Kafi”, lexojmë: “Dija është e ndarë në tre lloje: ‘Ajeti i qartë, obligim i drejtë dhe traditë (profetike) e ushtruar.’” Prej këtu, kuptojmë qartë se këto lloje dijesh të klasifikuara si më sipër, janë të pranishme në Kur’anin Famëllartë dhe, nëse do t’i mësojmë ato prej Kur’anit, konsiderohemi që nuk e kemi braktisur atë. Kështu, nëse i përgjigjemi ftesës së Kur’anit dhe, nëse do të vëmë në jetë porositë që na vijnë prej historisë së Profetëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*), që janë të mbushura plot me dije, udhëzime e urtësi, nëse i zbatojmë porositë e Allahut të Madhërishëm dhe marrim mësimet e duhura prej këshillave që na dërgon Ai dhe Profetët e Tij, atëherë sigurisht që nuk konsiderohemi prej atyre që e kanë braktisur Kur’anin. Përndryshe, të gjitha format dhe mënyrat e leximit sipërfaqësor të Kur’anit janë të padobishme, të rrezikshme dhe duhet t’i kërkojmë ndihmë Allahut të Madhëruar që të na ndriçojë mendjen dhe zemrat që të mos biem në këtë bata.

Një prej perdeve dhe pengesave të mëdha, të cilat shfaqen herë pas here, te njerëz të ndryshëm dhe në kohë të ndryshme, është mendimi dhe gjykimi se ky Kur’an nuk mund të kuptohet përveçse nëpërmjet mënyrës që e kanë kuptuar dhe e kanë interpretuar atë komentuesit e tij. Pra, askush nuk ka të drejtë të kuptojë prej një ajeti diçka më shumë se kanë kuptuar komentuesit e tij. Disa njerëz

shkuan deri aty sa menduan se vetë mësimi, studimi dhe meditimi të fjalët e përmendura në Kur'an është pjesë e komentimit të ndaluar për njerëzit e thjeshtë. Nëpërmjet kësaj ideje dhe nëpërmjet kësaj forme plotësisht të gabuar të besimit, e zhveshën Kur'anin prej të gjitha formave dhe mënyrave të përfitimit prej tij, duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në braktisjen tërësore të tij. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se të përfitosh prej Kur'anit normat më të thjeshta të moralit dhe të sjelljes, të mësosh prej tij kodet elementare të besimit dhe të njohjes së Zotit, nuk ka asgjë të përbashkët me dhënien e gjykimeve kompetente rreth tij apo me vetë komentimin. Për shembull, çfarë mund të themi lidhur me komentimin e tekstit kur'anor nëpërmjet kuptimit të thjeshtë dhe sipërfaqësor të mendjes. Për ta qartësuar edhe më shumë këtë pjesë, themi: Ku qëndron problemi që dikush (jo domosdoshmërisht "mufesir" - "komentues") të përfitojë prej mënyrës se si Musai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) mësoi prej Khudrit (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)?! Ku qëndron problemi që dikush të përfitojë prej natyrës së qëndrimit të Musait me Khudrin (Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy)?! Ku qëndron problemi që dikush të mësojë dhe të përfitojë prej faktit se si Musai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), me gjithë gradën e lartë shpirtërore, të diturisë dhe të profetësisë që përfaqësonte, e mori rrugën dhe me modestinë dhe përluljen më të madhe shkoi për të mësuar prej Khudrit (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) atë pjesë të dijeve që ai e kishte dhe Musai nuk e kishte?! Ku qëndron

problemi, që një lexues i thjeshtë i Kur'anit të përfitojë urtësi të caktuara te mënyra se si ia ka shtruar Musai nevojën e tij Khudrit (*Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy!*), ashtu siç përmendet edhe në ajetin kur'anor:

"هل أتبعك على أن تعلمني مما علمت رشداً" **"Musai i tha atij: 'A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?'"**<sup>117</sup>

Ku qëndron problemi, që një lexues i thjeshtë të mësojë prej urtësive të shpalosura te mënyra se si i është përgjigjur Khudri Musait (*Paqja e Zotit qoftë mbi të dy ata!*) dhe te mënyra se si Musai (me gjithë pozitën e tij të lartë) ka kërkuar falje dhe ndjesë prej tij (prej Khudrit), ashtu siç duhet të sillet çdo njeri me mësuesin e tij?!

Ç'lidhje mund të ketë ndërmjet përfitimit të këtyre kuptimeve sipërfaqësore dhe ndërmjet komentimit të vërtetë dhe të thellë të dijetarëve të tefsirit, kur dihet se ajetet prej të cilave mund të përfitohet shumë dhe lehtësisht qoftë dhe prej njerëzve më të thjeshtë, janë të shumta në Kur'an?! Cili problem mund të shfaqet, nëse lexuesi i thjeshtë përfiton prej urtësive dhe mësimëve të shpalosura te kjo histori e bukur ndërmjet Musait dhe Khudrit (*Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy!*), kur dihet se numri i urtësive dhe i mësimëve të gjendura në këtë histori i kalon dyzet urtësitë?! Cila mund të jetë problematika, që mund të shfaqet, nëse një lexues i thjeshtë i Kur'anit

<sup>117</sup> Sure "El Kehf", ajeti 66.

përpiqet të kuptojë vetë diçka prej ajetit të dytë të sures “El Fatiha”, në të cilin Allahu i Madhëruar shprehet qartë dhe thotë: "الحمد لله رب العالمين" **“Çdo lavdërim, i përket Allahut Zotit të botëve.”**<sup>118</sup>

Ky është një ajet nëpërmjet të cilit Allahu i Madhëruar tregon qartë monopolizimin dhe kufizimin e të gjitha llojeve të përlëvdimeve vetëm me Qenien e Tij unike dhe të Shenjtë. Cili mund të jetë problemi, që një lexues i thjeshtë i këtij ajeti kur'anor të mbërrijë në përfundimin se e gjithë përsosmëria dhe bukuria, krenaria dhe madhështia e gjendur në ekzistencë dhe e dëshmuar me syrin e lirë i dedikohet Krijuesit të Gjithësisë, prej zemrës që zgjedh këtë mënyrë për t'i shprehur dashurinë Atij?! Çfarë ka këtu për të filozofuar dhe për të kërkuar për lidhje ndërmjet dhënies së opinionit të lirë rreth kuptimeve sipërfaqësore të ajetit dhe ndërmjet komentimit profesionist të tij?! Ajete të tilla të ngjashme janë të shumta në Kur'anin Famëllartë dhe secili prej njerëzve të thjeshtë mund të kuptojë prej tyre atë që e detyron kuptimi sipërfaqësor gjuhësor i fjalës apo i fjalisë së përmendur në ajet dhe kjo nuk ka asnjë lidhje me komentimin (tefsirin) profesionist të tij, që e bëjnë zakonisht dijetarët e mëdhenj të fushës. Mund të themi gjithashtu se komentimi sipërfaqësor i Kur'anit nuk është domosdoshmërisht i lidhur me ajetet e dijeve dhe të shkencave të ndryshme, ku nevojiten procese të

---

<sup>118</sup> Sure “El Fatiha”, ajeti 2.

ndërlikuara të mendimit e të shqyrtimit për të ruajtur ekuilibrat e argumentit kur'anor. Ai nuk është i lidhur as me ajetet e moralit dhe të dispozitave të ndryshme ndaj dhe mendimi i thellë nuk ka ndonjë rol vendimtar aty. Komentime të tilla sipërfaqësore, që vijnë si rezultat i mendimeve sipërfaqësore, nuk përbëjnë asnjë problem, pasi ato përputhen plotësisht me normat dhe rregullat elementare të mendimit dhe të kuptimit.

Nga ana tjetër, duhet të pohojmë, gjithashtu, se në rast se kuptimi sipërfaqësor i fjalës apo i ajetit kur'anor bie ndesh me kuptimin e vërtetë të saj/tij, atëherë jemi të detyruar të tejkalojmë sipërfaqësoren për t'u mbështetur te nënkuptimi (që në këtë rast është i vetmi kuptim i vërtetë). Një shembull, lidhur me këtë, është ajeti kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë "وجاء ربك" **"Kur të vijë Zoti yt"** apo ajeti tjetër në të cilin Allahu i Madhëruar thotë: "الرحمن على العرش استوى" **"I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit si i takon Madhërisë së Tij."**<sup>119</sup> Kuptimi sipërfaqësor i këtyre ajeteve bie ndesh me kuptimin dhe komentimin e tyre të vërtetë, por kjo nuk duhet gjykuar lehtësisht si e ndaluar, sepse nuk konsiderohet komentim nëpërmjet mendimit, por thjesht një interpretim sipërfaqësor i kuptimeve të tij. Ky lloj komentimi, (komentimi nëpërmjet mendimit) ka shumë mundësi dhe gjasa të nënkuptojë dhe

---

<sup>119</sup> Sure "Ta Ha", ajeti 5.

të jetë i lidhur me ajetet e dispozitave, kuptimi dhe komentimi i të cilave nuk mund të lihet në dorë të mendimit sipërfaqësor të lexuesit të thjeshtë. Ky lloj leximi dhe interpretimi duhet parë, thjesht, si përpjekje modeste për të adhuruar Zotin, nëpërmjet interpretimit të atypëratyshëm sipërfaqësor. Ajo duhet parë si një përpjekje e shpejtë për të depërtuar te depot e pafundme të Zbulesës Hyjnore. Duhet të dimë, gjithashtu, se pjesa më e madhe e këtyre transmetimeve (e këtyre ngjarjeve) është e lidhur me dijetarë të masave, të cilët kanë bërë përpjekjet e tyre modeste për të komentuar ajete të caktuara kur'anore, si dhe janë munduar të kuptojnë fenë brenda mundësive, pavarësisht fuqive të tyre të mendimit dhe të zbërthimit. Transmetime të tjera dëshmojnë, njëkohësisht, se asgjë në ekzistencë nuk është më larg kuptimit të vërtetë të ajeteve kur'anore se sa komentimet sipërfaqësore, bazuar thjesht mbi kuptimet gjuhësore. Në mbështetje të këtyre kuptimeve, vjen për ne edhe një transmetim tjetër i bekuar, në të cilin thuhet: "إن دين الله لا يصاب بالعقول" **"Vërtet, që**

**kuptimi i plotë i kësaj feje nuk mund të rreket vetëm me mend."** Ky transmetim nënkupton dispozitat dytësore dhe të padukshme të fesë, të fshehura në Zbulesën Hyjnore.

Përndryshe, përsa i përket vërtetimit të ekzistencës së Zotit, Njehsimit të Tij, Shenjtërisë së Tij, vërtetimit të Ditës së Gjykimit dhe të Profetësisë, nuk ka diskutim që është detyrë kryesore e mendjes dhe e trurit. Është

tërësisht e papranueshme ideja dhe mendimi i disa dijetarëve apo komentuesve se vërtetësia e ekzistencës së Zotit dhe e pjesës tjetër të shtyllave të besimit, nuk ndodh nëpërmjet mendjes, por nëpërmjet tekstit të shenjtë. Kjo është një prej çudirave dhe njëkohësisht prej fatkeqësive të mëdha, prej të cilave duhet t'i kërkojmë Zotit mbrojtje. Dëshmi të kësaj natyre, nuk është e nevojshme as t'i dënojmë as t'i përgënjeshtrojmë. I Ankohemi Allahut, Ai na mjafton!

Një tjetër pengesë dhe një tjetër perde e trashë, që e ndalon krijesën të përfitojë dhe të mësojë prej Zbulesës Hyjnore, janë padyshim edhe gjynahet. Aktiviteti gjynahqar dhe mëkatar i qenies, i ushtruar te hapësirat e jetës, si hapësira të shenjta të vëna në dispozicion prej Krijuesit të botëve, është shkaktari kryesor i formësimit të këtyre pengesave dhe perdeve. Këto të fundit e pengojnë zemrën, shpirtin dhe mendjen të përqendrohet te Mesazhi i Krijuesit të tyre, duke mos e bërë të mundur, përfundimisht, përfitimin prej atyre mesazheve.

Është mëse e nevojshme të dihet, gjithashtu, se shëmbëlltyra e secilës prej veprave të mira dhe të këqija, që lundron në mbretërinë e qiellit (Alemul Melekut)<sup>120</sup>, një kopje e të njëjtës shëmbëlltyrë lundron në mbretërinë e shpirtit. Nëpërmjet kësaj shëmbëlltyrë, që noton thellësive të shpirtit dhe të qenies, ndodh njëra prej dy dukurive, ose

---

<sup>120</sup> Është përmendur më sipër. Për më shumë shpjegim kthehu te faqja 5.

mbushja e qenies dhe e shpirtit me dritë, duke u shndërruar menjëherë në vend të pastër e të ndriçuar, pra, në një vend të përshtatshëm (për nga pastërtia dhe ndriçimi) për të qenë vendbanimi i fshehtësive, i të vërtetave dhe i mrekullive me të cilat është e ngarkuar Zbulesa Hyjnore, ose mbushja e saj (e qenies) me papastërti dhe errësirë, çka e pamundëson të qenit e qenies dhe të shpirtit një vend i përshtatshëm për të depozituar të vërtetat hyjnore, fshehtësitë, mrekullitë dhe urtësitë që na vijnë prej Zotit nëpërmjet zbulesës Hyjnore. Duke qenë se gjatë kohës së kryerjes së gjynaheve, shpirti, zemra dhe qenia, në tërësinë e tyre, janë plotësisht nën komandën dhe nën urdhrat e Iblisit të mallkuar, domosdoshmërisht edhe shikimi, dëgjimi dhe të menduarit vihen nën komandën e tij dhe e kanë të pamundur të perceptojnë apo të thithin valët e Mesazhit Hyjnor. Kështu, dëgjimi i njeriut qëndron tërësisht jashtë ndikimit të mësimëve, të udhëzimit dhe të Urtësisë Hyjnore. Shikimi i tij goditet prej verbërisë dhe bëhet i paaftë për të prekur dhe për të parë argumentet e shumta që i ka dhënë Allahu i Madhëruar dhe që mund të shihen me sy të lirë. Kjo është gjendja më e rëndë dhe më fatkeqe, me të cilën mund të përballet qenia. Në këtë rast, ajo është plotësisht e privuar për t'u njohur dhe për t'u ekspozuar kah drita e Mesazhit Hyjnor, kah udhëzimi, këshillat, të vërtetat dhe mësimet e Kur'anit Famëlartë. Kjo është një gjendje ku njeriu e ka të pamundur që t'i mësojë vetes të vërtetat e mëdha të ekzistencës dhe të fesë. Është

një gjendje, në të cilën është e pamundur të meditohet rreth krijesave të Allahut, rreth emrave<sup>121</sup> dhe cilësive<sup>122</sup> të Tij absolute. Lidhur me këtë kategori njerëzish, Allahu i Madhëruar thotë kështu:

"لهم قلوب لا يفقهون بها ولهم أعين لا يبصرون بها ولهم أذان لا يسمعون بها أولئك

كالأنعام بل هم أضل"

**"Ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi (më keq)."**<sup>123</sup>

Ajeti tregon qartë se shikimi i kësaj kategorie të njerëzve për botën është i ngjashëm me shikimin e bagëtive dhe të kafshëve, të cilat nuk kanë asnjë lloj qasje logjike karshi realitetit. Zemrat e tyre janë të ngjashme me zemrat e bagëtive. Brenda tyre nuk ka mendim, përjetim e meditim lidhur me të vërtetat e mëdha të ekzistencës. Kjo gjendje bëhet shkaktare që ata të shfaqin mohim, arrogancë dhe mendjemadhësi, të cilat vijnë vazhdimisht duke u shtuar. Kjo e bën nivelin e tyre më të ulët edhe se niveli i bagëtive.

Një tjetër pengesë dhe një tjetër perde e trashë, e cila formësohet me kalimin e kohës dhe qëndron ndërmjet zemrave tona dhe Mesazhit Hyjnor, është gjithashtu

---

<sup>121</sup> Është përmendur më sipër. Për më shumë shpjegim kthehu te faqja 5.

<sup>122</sup> "Es-Sifat" - "cilësitë", nëpërmjet tyre nënkuptohet vetë Qenia Hyjnore, jo dukuritë e tjera të shtuara mbi Qenien.

<sup>123</sup> Sure "El A'araf", ajeti 173.

dashuria dhe lidhja e fortë e shpirtit dhe e zemrës pas qejfeve të kësaj bote dhe lumturive të saj të përkohshme. Një zemër e lidhur fort me kënaqësitë dhe lumturitë e kësaj bote të përkohshme, e ka të vështirë, madje thuhet të pamundur, të njihet me Krijuesin e saj. Një zemër e hedhur plotësisht në prehrin e kësaj bote, e ka të pamundur të kujtojë Zotin dhe të meditojë rreth ekzistencës së Tij. Duhet të vetëdijesohemi, gjithashtu se, sa më shumë të lidhet zemra me këtë botë, aq më e trashë dhe aq më e fortë bëhet pengesa dhe perdja që qëndron ndërmjet shpirtit dhe Krijuesit të tij. Lidhja e zemrës së njeriut me këtë botë të rreme përbën një rrezik të përmasave të frikshme, pasi njeriu, i kapur fort pas dynjasë dhe pas bukurive të saj, është i privuar prej kënaqësisë që të ofron njohja e Allahut të Madhëruar. Ai nis dhe e gjen lumturinë të pasuria, fama, pushteti, njohja, miqësitë dhe menjëherë pas kësaj, nis ajo ftohja e madhe me Zotin, fiket njëherë e përgjithmonë drita e mirësisë, duke mbyllur njëkohësisht të gjitha dyert e zemrës për lumturinë e vërtetë. Këtë tablo (mbylljen e dyerve të zemrës) e gjejmë të pasqyruar qartë edhe në Kur'anin Famëlartë, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:

"أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَىٰ قُلُوبٍ أَقْفَالُهُ" **"Vallë, a nuk përsiatin ata për**

**Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?"**<sup>124</sup> Komentues të ndryshëm të Kur'anit janë të mendimit se "kyçet", e përmendura në ajetin e mësipërm, nënkuptojnë pikërisht

---

<sup>124</sup> Sure "Muhammed", ajeti 24.

kyçet dhe prangat që e mbajnë njeriun të lidhur me kënaqësitë e kësaj bote. Nga gjithçka u përmend më sipër, kuptojmë se të gjithë ata njerëz që kanë dëshirë të njihen me dijet, mësimet, mrekullitë, të fshehtat dhe urtësitë e gjendura në Kur'an, duhet të pastrojnë zemrat e tyre prej të gjitha atyre papastërtive dhe t'i çlirojnë ato prej atyre prangave. Për të ndriçuar zemrat me dritën e udhëzimit, duhet të pastrohen zemrat prej çdo lloj forme papastërtie, sepse një vend i papastër nuk mund të jetë vendi, ku depërton një dritë si ajo.

Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar ka thënë në Kur'anin Famëlartë: "إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ فِي كِتَابٍ مَكْنُونٍ لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ"

**“Ky është vërtet një Kur'an i nderuar, në Librin e ruajtur. Atë (Kur'anin) e prekin vetëm të pastrit.”.**<sup>125</sup>

Në këto ajete të nderuara kemi tregues të qartë që thonë se, ashtu sikurse papastërtia sipërfaqësore e lëkurës (e trupit të njeriut), e cila është e ndaluar prej prekjes dhe sipërfaqësorës së Librit të Shenjtë, dispozitë e sanksionuar qartë në Librin e Zotit, ashtu edhe subjektivja (zemra dhe shpirti) e ka të pamundur të kuptojë mësimet, të fshehtat, dituritë, urtësitë dhe mrekullitë e tij, nëse nuk është e pastruar prej papastërtive të kësaj bote.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

<sup>125</sup> Sure “El Uakiah”, ajetet 77-79.

"ذلك الكتاب لا ريب فيه هدى للمتقين" **"Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**<sup>126</sup> e deri në fund të ajetit. Në këtë ajet tregohet qartë se të gjithë ata njerëz që nuk e kanë përkushtimin të plotë (referuar normave të përkushtimit të masave) dhe ata që nuk e kanë besimin (imanin) të plotë (referuar normave të besimit të masave) nuk mund të përfitojnë prej dritës që përcjellin mësimet dhe urtësitë e Kur'anit.

Ndërsa përsa i përket jobesimtarit dhe femohuesit, referuar të gjitha shkallëve dhe gradëve të përkushtimit, që janë përkushtimi i veçantë, përkushtimi i të veçantës së veçuar dhe përkushtimi i më të veçantës së të veçantave, atij i janë mohuar të gjitha llojet dhe format, nëpërmjet të cilave shfaqet përkushtimi.

Shqyrtimi dhe trajtesa e të gjitha formave dhe gradëve, nëpërmjet të cilave shfaqet përkushtimi i ajeteve që shqyrtojnë këtë çështje, është një punë që zgjat dhe nuk do të ndalemi aty. Do të mjaftohemi në trajtesën tonë, duke përmendur një ajet kur'anor, që i ndihmon shumë të zgjuarit ndër njerëzit, me kushtin e vetëm të meditimit dhe të përsiatjes ndaj tyre. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëljartë:

---

<sup>126</sup> Sure "El Bekare", ajeti 2.

"قد جاءكم من الله نور وكتاب مبين يهدي به الله من اتبع رضوانه سبل السلام ويخرجهم من الظلمات إلى النور بإذنه ويهديهم إلى صراط مستقيم"

**"Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i Udhëzon ata që e ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë."**<sup>127</sup>

Veçoritë e këtij ajeti janë të shumta dhe trajtesa e tyre meriton një punë kërkimore dhe shkencore të veçantë, por ne nuk do të ndalemi aty.

---

<sup>127</sup> Sure "El Maide", pjesërisht ajeti 15 dhe ajeti 16.

## **RRETH MEDITIMIT<sup>128</sup>**

Prej normave të mirësjelljes me Kur'anin është prania e mendjes dhe e zemrës gjatë këndimit apo recitimit të tij. Këtë e kemi përmendur, kur kemi folur rreth normave absolute të sjelljes në adhurime dhe e kemi përfshirë në studim. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme të ndalemi sërish. Prej normave të edukatës me Kur'anin Famëllartë është përqendrimi i vëmendjes dhe përsiatja rreth tij. Nëpërmjet mendimit dhe meditimit nënkuptohet përpjekja e tërësisë së proceseve të të menduarit, për të sjellë për shpirtin dhe zemrën kuptimet, urtësitë dhe mrekullitë e ngarkuara thellësive të atyre ajeteve. Duke qenë se Kur'ani Famëllartë (sipas dëshmisë që vjen prej vetë atij) është një libër që ka për qëllim udhëzimin e njerëzve për në rrugën e drejtë të besimit dhe të paqes shpirtërore, duke qenë se ajo Zbulesë e ndritur ka për qëllim të nxjerrë shpirtrat dhe zemrat e njerëzve prej shtresave të ndryshme dhe të shumta të errësirës për te parajsa e dritës dhe t'i udhëzojë ata për në rrugën e drejtë të Zotit, nuk ka dyshim se nëpërmjet këtij meditimi njeriu do të mund të arrijë pozitën e paqes dhe të shpëtimit. Kjo nis me pozitën dhe

---

<sup>128</sup> "Normat morale të namazit".

shkallën më të ulët të paqes dhe të shpëtimit, burimi i forcës së të cilës është bota e poshtme e ulët (melekuti), duke mbërritur deri përtej fundit të saj. Ajo është forma e përsosur dhe e vërteta e zemrës së pastër. Këto kuptime i gjejmë të pranishme edhe te komentimet (tefsiret) e Ehli Bejtit, të cilët thonë se mendimi apo meditimi është tërësia e proceseve të të menduarit, nëpërmjet të cilave kërkohet dhe mbërrihet e vërteta. Synimi i secilit lexues të Kur'anit duhet të jetë gjetja e paqes që buron nga fuqitë e Mbretërisë së Tokës (alemul mulk)<sup>129</sup> dhe të Qiellit (el melekut).<sup>130</sup> Ato janë të pranishme në këtë Libër Qiellor dhe mund të përftohen e të nxirren që aty, nëpërmjet mendimit dhe meditimit. Kështu, pra, në rast se fuqia njerëzore shkëputet prej ndikimeve të së keqes së djallit dhe prej kontrollit të tij, përfitohen llojet e ndryshme të paqes dhe të qetësisë, aq të nevojshme për mbarëvajtjen e jetës së shoqërisë njerëzore. Ato shoqëri, që e realizojnë me sukses këtë proces, arrijnë të shkëputen prej errësirës dhe të transferohen për te Drita e pashtershme Hyjnore, e cila shfaqet e fuqishme dhe autoritare. Sapo njeriu të fillojë të shkëputet prej llojeve të errësirave që gjenden në tokë, që fillojnë me errësirën natyrale të çështjeve të tokës dhe që përfundojnë te errësitat “e të shumtës” – “el kethreh”,<sup>131</sup>

<sup>129</sup> Është përmendur më sipër. Kthehu te faqja 5.

<sup>130</sup> Është përmendur më sipër. Kthehu tek faqja 5.

<sup>131</sup> “El-Kethreh Fil Uahdeh” - “e shumta në njëshmëri”, sipas mendimit të disa filozofëve, ky term do të thotë: Edhe pse ekzistenca është një e

menjëherë pas këtij procesi ndodh udhëzimi i qenies, i zemrës dhe i shpirtit dhe ndriçimi absolut i tyre. Menjëherë pas kësaj ndodh udhëzimi për te udha e drejtë e njerëzores, që është në vetvete edhe udha e drejtë e Zotit. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëllartë:

"إن ربي على صراط مستقيم" **"Zoti im është në rrugë të drejtë."**<sup>132</sup>

Lidhur me domosdoshmërinë e meditimit, të mendimit, të përsiatjes dhe të përlëvdimit të tij është folur shpesh në Kur'anin Famëllartë. Allahu i Madhëruar thotë:

"وأنزلنا إليك الذكر لتبين للناس ما نزل إليهم ولعلهم يتفكرون"

**"Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë."**<sup>133</sup>

Në këtë ajet të nderuar gjendet një lëvdatë e madhe për mendimin dhe meditimin, sepse qëllimi i këtij Libri Madhështor, i zbritur për njerëzimin, është: Duke qenë se i jep një rëndësi kaq të madhe meditimit, edhe në rast se meditimi shfaqet thjesht si mundësi dhe jo në formën e faktit të kryer, ai e bën të detyrueshëm ndodhjen e mrekullisë dhe përfitimin prej dritës së tij.

---

vetme, ajo është në vetvete bashkimi i tërësisë së të shumtave të përsosura te një njësi e vetme. Ata mendojnë, gjithashtu se, megjithëse përbërësit e ekzistencës janë të shumtë, ato përfundojnë te një e vërtete e vetme, e cila është hija e një ekzistence të thjeshtë dhe të vetme, që është edhe e vetmja e vërtetë.

<sup>132</sup> Sure "Hud", ajeti 56.

<sup>133</sup> Sure "En Nahl", ajeti 44.

Në një ajet tjetër kur'anor, Allahu i Madhëruar thotë:

"فأقص القصص لعلمهم يتفكرون"

**"Tregojua atyre ato ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë."**<sup>134</sup>

Ajetet dhe transmetimet që trajtojnë këtë çështje, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose në mënyrë të tërthortë, janë të shumta. Transmetohet se Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), kur ka zbritur ajeti "إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاجْتِلاَفِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لآيَاتٍ"

**"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, ka shenja për mendarët."**<sup>135</sup> është shprehur: "Mjerë ata që e lexojnë Kur'anin dhe nuk meditojnë në të.". Ajo që kuptojmë prej kësaj pjese është se njeriu duhet të mendojë dhe të kuptojë se ç'është meditimi pozitiv dhe si ndodh ai. Dihet prej të gjithëve, që të meditosh dhe të mendosh rreth tij, është diçka pozitive. Thënia më interesante, lidhur me këtë pjesë, është e Abdullah El Ensarij: "Jam i vetëdijshëm se përsiatja është në vetvete përpjekje e syrit të zemrës për të prekur nevojën e saj të madhe, që do të thotë se tërësia e proceseve të mendimit dhe të përsiatjes rreth kuptimeve të tekstit hyjnor, është në thelb kërkesë dhe nevojë e syve të shpirtit dhe të zemrës, për të mbërritur te nevoja dhe synimi i saj i madh. Nevoja e saj e madhe është realizimi i lumturisë

<sup>134</sup> Sure "El A'raf", ajeti 176.

<sup>135</sup> Sure "Ali Imran", ajeti 190.

absolute, që arrihet vetëm nëpërmjet dijes absolute, që buron prej procesit të mendimit dhe të përsiatjes rreth tekstit hyjnor. Kjo është detyra e çdo njeriu dhe ky është thelbi i ftesës hyjnore. Çdo njeri duhet ta kërkojë nevojën e tij për lumturinë dhe qetësinë absolute, për dituri, dritë dhe urtësi, te ato tekste të shenjta, te ato histori të sjella aq bukur brenda atyre teksteve. Lumturia absolute nuk është gjë tjetër përveçse prekja e dritës së udhëzimit, që buron prej tekstit të shenjtë, është gjetja e rrugës së drejtë. Çdo njeri duhet të vihet në kërkim të asaj qetësie, paqeje e lumturie absolute të gjendur në brendësi të atyre ajeteve kur'anore. Kërkohet prej tyre të gjejnë te ato ajete dritën e dijes dhe rrugën e vetme për te lumturia e vërtetë, ashtu siç është përmendur më sipër. Në rast se lexuesi i Kur'anit dhe medituesi i tij nis dhe e prek dritën, dijen dhe urtësitë në kërkim të së cilave ishte vënë, atij do t'i hapen dyert e një përftimi shumë të madh prej Zbulesës Hyjnore dhe bashkë me to, dyert e mëshirës së vërtetë të Krijuesit të Gjithësisë. Në momentin që ndodhin të gjitha këto, njeriu bëhet i vetëdijshëm se nuk duhet ta shpenzojë kohën e shtrenjtë të jetës së tij duke kërkuar lloje kënaqësie, paqeje e lumturie të ndryshme nga ato të përcaktuara prej Profetit të Zotit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) apo të pranishmet te synimet e thirrjes së tij. Pasi njeriu të kuptojë çfarë i duhet, ka për të hequr dorë menjëherë prej fjalëve të tepërta dhe prej qëllimeve të kota të papërfshira në rrethin e synimeve të tekstit hyjnor dhe të

thirrjes profetike. Sapo njeriu të ndiejë dhe të prekë, se sytë e zemrës dhe të shpirtit të tij janë orientuar kah synimet dhe qëllimet strategjike të Zbulesës Hyjnore; sapo ai të ndiejë se shikimi i syve të zemrës dhe të shpirtit është forcuar dhe se përsiatja rreth ajeteve kur'anore është kthyer në një normë sjelljeje të zakonit të qenies; sapo të ndiejë dhe të prekë se kanë filluar t'i hapen dyert e shumta (të mbyllura më parë) të përfitimit prej dijeve, sekreteve, mirësive dhe urtësive të Kur'anit; kur njeriu të fillojë të ndiejë se ka nisur të përfitojë prej tij gjëra që nuk ka mundur t'i përfitojë më parë, vetëm atëherë do të mund të kuptojë se çfarë do të thotë, që Kur'ani Famëljartë është shërim për sëmundjet e zemrës dhe të shpirtit. Vetëm atëherë do të mundë të kuptojë plotësisht kuptimet madhështore të pranishme në ajetin kur'anor:

"وننزل من القرآن ما هو شفاء ورحمة للمؤمنين ولا يزيد الظالمين إلا خسار"

**"Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje."**<sup>136</sup>

Vetëm atëherë njeriu do të mund të kuptojë fjalën e Prijësit të Besimtarëve: *"Mësojeni Kur'anin, pasi ai është pranverë për zemrat tuaja. Shërojeni veten me të, sepse ai është shërim për kraharorët tuaj."* Kjo do të thotë se nuk i qasemi Kur'anit vetëm kur duam të kurojmë e të shërojmë sëmundjet e ndryshme të trupit, por, më e rëndësishmja,

<sup>136</sup> Sure "El Isra", ajeti 82.

është të shërojmë nëpërmjet tij sëmundjet e fshehta dhe të padukshme të shpirtit dhe të zemrës, pasi ky është qëllimi më i madh i Kur'anit. Në fakt, Kur'ani nuk është dërguar për të shëruar sëmundjet e ndryshme të trupit të njeriut, paçka se mund t'i shërojë ato. Edhe Profetët e Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!*) nuk janë dërguar për të shëruar sëmundjet trupore të njerëzve (edhe pse mund ta bëjnë këtë), por janë dërguar me një tjetër qëllim dhe mision: Ata janë dërguar si mjekë të qenies humane dhe shërim për zemrën me gjithë shpirt.

## **RRETH ZBATIMIT (PRAKTIKIMIT) TË KUR'ANIT<sup>137</sup>**

Prej normave shumë të rëndësishme të leximit të Kur'anit dhe të përfitimit prej tij është vënia në praktikë dhe zbatimi i mësimave të tij. Kjo do të thotë se njeriu duhet të jetë i gatshëm të zbatojë dhe të verë në jetë mësimet e përfituara prej atyre ajeteve të bekuara, menjëherë pasi t'i ketë konstatuar ato. Nëpërmjet reflektimit të menjëhershëm dhe praktikimit të mësimave të mesazhit të Krijuesit, njeriu nis procesin e shërimit prej sëmundjeve të ndryshme të shpirtit e të zemrës, sikurse nis në të njëjtën kohë procesin e çlirimit prej dobësive dhe mangësive të tij të shumta. Për të ilustruar këtë, na vjen në ndihmë historia e Ademit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Na shfaqet menjëherë mënyra se si shejtani i mallkuar u përjashtua prej Xhenetit, edhe pse ishte prej adhuruesve të mëdhenj dhe prej atyre që i ishin përgjyur Allahut në sexhde për një kohë të gjatë. Si mund të ndodhë kjo?! Po, mund të ndodhë sigurisht. Prej kësaj historie kuptojmë qartë se të gjithë besimtarët duhet të pastrojnë mirë zemrat dhe shpirtrat e tyre, pasi Allahu i Madhëruar, hapësirat e

---

<sup>137</sup> "Normat morale të namazit", f. 353.

shenjta dhe të bekuara të afrimitetit të Tij, i ka bërë të ndaluara për të gjithë ata që i kanë ciflosur mendjet dhe zemrat e tyre me sjellje djallëzore. Prej kësaj historie të bekuar kuptojmë dhe mësojmë se cilat janë pasojat e mendjemadhësisë dhe të arrogancës, të cilat e shtynë Iblisin e mallkuar të mos i bindej urdhrit të Krijuesit për t'i bërë sexhde Ademit. Në këtë histori duket qartë çfarë do të thotë dhe çfarë ndodh nëse e kundërshton urdhrin e Krijuesit. Çfarë do të thotë të refuzosh direktivat e Allahut të Madhëruar me justifikime të kota dhe boshe. Prej kësaj historie mësojmë se çfarë ndodh kur Iblisi i Mallkuar i përgjigjet urdhrit të Krijuesit me refuzim dhe mendjemadhësi, duke thënë: “Unë jam më i mirë se Ademi. Më ke krijuar mua prej zjarrit dhe e ke krijuar atë prej dheut. Për këtë arsye nuk mund të bie në sexhde për nder të tij.”

Kjo mendjemadhësi e Iblisit dhe kjo arrogancë e fodullëk, adresuar Krijuesit të botëve, u bë shkak që ai të pëlqejë veten dhe të bjerë në këtë kurth të madh e të rrezikshëm. Këto sjellje të ulëta djallëzore, u bënë shkak që ai të përjashtohet përjetësisht prej Mëshirës së Allahut të Madhëruar dhe të mos lejohet më kurrë të hyjë te hapësirat dhe sipërfaqet e shenjta të Afrimitetit të Tij. Secili prej nesh, prej ditës që ka lindur dhe ka ardhur në jetë e mallkon Iblisin, por çuditërisht një pjesë e madhe e jona ka sjellje të ulëta dhe të poshtra, të ngjashme me ato të të mallkuarit. Ajo që secili prej nesh duhet ta mendojë dhe ta meditojë

me urgjencë, sapo të përballlet me këtë histori të mrekullueshme, është fakti se përjashtimi prej Xhenetit dhe prej hapësirave të shenjta të Afrimitetit, nuk është një vendim apo një ferman i posaçëm, i lidhur vetëm me Iblisin e mallkuar. Duhet të vetëdijesohemi dhe të kuptojmë se secili prej nesh, bëhet pjesë e ushtrisë së Iblisit dhe e pasuesve të tij, sapo të nisë të ushtrojë të njëjtat sjellje me të. Jemi pjesë e të njëjtit kontingjent, nëse kemi të njëjtat sjellje me të. Jemi të përjashtuar prej Mëshirës së Zotit dhe prej hapësirave të shenjta të Afrimitetit, nëse do të ushtrojmë ndaj jetës të njëjtat skema e djallëzi që ushtron ai. Duhet ta kemi të qartë të gjithë, se gjithçka e ndaloi Iblisin të përjashtohet mund të na përjashtojë edhe ne, madje frika ime shkon edhe më tej, sa herë druaj se për shkak të sjelljeve tona, të jemi edhe ne pjesë e të njëjtit mallkim që ia adresojmë atij.

Leximi i kësaj historie të nderuar është një arsye më shumë për të medituar thellësisht dhe për menduar rreth arsyeve që e bëjnë Ademin më të rëndësishëm dhe më të mirë se vetë engjëjt. Njohja më nga afër e kësaj historie na shtyn të besojmë se secili prej nesh, sipas mundësive që ka, mund të ketë këto cilësi të larta, arsyeja e të cilave, sipas dëshmisë së Kur'anit, është fakti që Allahu i Madhëruar ia mësoi Ademit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) emrat.<sup>138</sup> Allahu i

---

<sup>138</sup> Është shpjeguar më sipër. Kthehuni në faqen 5, për sqarime më të zgjeruara.

Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "وعلم آدم الأسماء كلها"

**"Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje."**<sup>139</sup>

Grada më e lartë e mësimi të emrave është vërtetimi i pozitës së emrave të Allahut. Prej gradëve të larta të mësimi të atyre emrave është edhe numërimi i atyre emrave, ashtu siç është përmendur edhe në transmetimin e ardhur prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) në të cilin thotë: *"Vërtet, Allahu i Madhëruar ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Të gjithë ata që i numërojnë, adhurojnë Zotin nëpërmjet përsëritjes së tyre, do të hyjnë në Xhenet."* Numërimi dhe përsëritja e atyre emrave në vazhdimësi është shkak që njeriu të bëhet pjesë e parajsës, që kuptimet e tyre përfaqësojnë.

Nëpërmjet ushtrimeve të singerta të gjimnastikës shpirtërore, njeriu mund t'i shprehë dhe t'ia paraqesë ato ekzistencës. Nëpërmjet këtyre ushtrimeve të gojës dhe të shpirtit, njeriu e transferon qenien për te hapësirat e Afrimitetit dhe mrekullia e atyre emrave ndërhyjnë fuqishëm në jetën e tij, për të marrë nën komandë të gjitha sjelljet e tjera të njeriut. Kjo gjendje e krijuar bën që të gjitha punët, veprat angazhimet dhe lëvizjet e njeriut të jenë të veshura me ngjyrat e bukura dhe me aromat e këndshme të Urtësisë Hyjnore.

<sup>139</sup> Sure "El Bekare", ajeti 31.

Një tjetër hadith, me kuptime të përafërta, vjen prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) i cili ka thënë: *“Shpirti i besimtarit është më fort i lidhur me Allahun e Lartësuar, nga ç’është, rrezja e diellit me vetë shpirtin dhe me dritën e tij.”*

Në një tjetër hadith (kudsi) të vërtetë (sahih), të transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) prej Allahut të Lartësuar, lexojmë: *“Robi im do të vazhdojë përpjekjet e tij për t’u afruar te Unë, nëpërmjet kryerjes së adhurimeve (nafile/të pëlqyeshme) të padetyrueshme, deri sa të arrijë të bëhet objekt i Dashurisë Sime dhe, kur Unë ta dua, do të bëhem veshi i tij, me të cilin dëgjon, syri i tij, me të cilin shikon, gjuha e tij, me të cilën flet dhe dora e tij, me të cilën merr e jep.”*

Në një hadith tjetër thuhet: *“Ne jemi Emrat e Tij të bukur.”*. Argumentet logjike, të lidhura me këtë çështje, janë të shumta.

Në vija të përgjithshme mund të themi se të gjithë ata që synojnë dhe dëshirojnë të jenë fatlumët, që përfitojnë dhe marrin prej Kur’anit Famëlartë pjesën më të madhe të mundshme të mësimave dhe të urtësive të tij, duhet të venë në jetë dhe duhet të zbatojnë me përpikëri këshillat, udhëzimet dhe mësimet e tij, menjëherë pasi të jenë njohur me to. Kjo është rruga dhe mënyra e vetme për të pasur prej tij një përfitim sa më të plotë. Në suren “El Enfal”, Allahu i Madhëruar thotë:

"إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذَكَرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تَلَيَّتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رُءُوسِهِمْ يُتَوَكَّلُونَ"

**"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë, dhe kur u lexohen Shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten."**<sup>140</sup>

Referuar ajetit të mësipërm kur'anor, të gjithë ata që synojnë të rrugëtojnë për te Zoti i tyre, duhet të shohin veten dhe t'i kenë cilësitë e përmendura në ajetin e mësipërm si njësi matëse për besimin dhe devocionin e tyre. Le ta pyesim veten herë pas here: Vallë, zemrat tona fërgëllojnë?! Vallë, dridhen ato zemra prej drojës dhe frikës, sa herë që përmendet Allahu?! Vallë, mbushen zemrat dhe shpirtrat e tyre me dritë, sa herë dëgjojnë të lexohen ajetet e Kur'anit?! Vallë, mbështetet njeriu vazhdimisht te Allahu i Madhëruar, sa herë që përballet me vështirësitë e kësaj bote?! A e ndien vallë, njeriu, sa herë që lexohen këto ajete, se është i papërfshirë nga këto gjendje paqeje dhe nga ky afsh lumturie, që ngacmon thellë qenies përmendja e tyre?! Nëse njeriu dëshiron vërtet të kuptojë, nëse e ka frikë Zotin apo jo, le të hedhë një vështrim të shpejtë mbi punët dhe veprat e tij. Njeriu nuk duhet kurrsesi të ushtrojë arrogancë dhe mendjemadhësi hapësirave të shenjtërisë së Allahut dhe nuk duhet kurrsesi të shkelë e të tejkalojë kufijtë e vendosur prej Allahut të

<sup>140</sup> Sure "El Enfal", ajeti 2.

Madhëruar, në prani të Tij. Ai është i pranishmi i përhershëm. Ai duhet të kuptojë se, nëse besimi i tij pëson rritje gjatë këndimit të ajeteve të shenjta të Zotit, nuk ka dyshim se Drita Hyjnore ka për të pushtuar të gjitha hapësirat e prekshme dhe të dukshme të qenies së tij, pasi është prej gjinisë së të pamundurës që zemra e një njeriu të jetë e mbushur me Dritën Hyjnore dhe të mos ndodhë e njëjta gjë, me shikimin e tij, me dëgjimin, me sytë, me veshët dhe me gjuhën. Është e pamundur të mos ndodhë e njëjta gjë, me të gjitha gjymtyrët e tij. Një qenie e ndriçuar është tërësia e fuqive të ndriçuara të dukshme (el-melekijeh)<sup>141</sup> dhe të padukshme (el-meleikutijeh)<sup>142</sup> të vetë asaj.

Ndriçimi i qenies, udhëzimi i saj, transferimi për te lumturia e përvetshme dhe për te rruga e drejtë, e shndërron atë në një shtëllungë të madhe drite që mund të ndriçojë bashkë me veten edhe shpirtrat dhe zemrat e pjesës tjetër të njerëzimit. Ndriçimi i saj, mund ta nxisë pjesën tjetër të njerëzve të nisin rrugëtimin e tyre kah të bukurës dhe njerëzores. Një qenie e dorëzuar plotësisht ndaj Allahut të Lartësuar dhe e dorëzuar plotësisht ndaj Caktimit të Tij, një qenie që e shkëput tërësisht vëmendjen prej asaj çfarë gjendet në duart e njerëzve dhe përqendrohet vetëm te ajo çfarë Allahu i Madhëruar e ka caktuar për të, ata që i dorëzojnë nevojat, dhimbjet,

<sup>141</sup> Është përmendur në faqen 1. Për më shumë sqarim kthehu atje.

<sup>142</sup> Është përmendur në faqen 1. Për më shumë sqarim kthehu atje.

pafuqinë dhe varfërinë e tyre te dyert e Caktimit të Allahut dhe te hambarët e pasurisë së Tij absolute, ata që nuk i kërkojnë zgjidhjet e vështirësive dhe përmbushjen e nevojave të tyre te njerëzit e tjerë, Allahu do t'u mjaftojë dhe ka për të qenë pranë tyre me ndihmën dhe me përkrahjen e Tij të madhe.

Kështu, pra, detyra e një besimtari të mirë, i cili e ka nisur rrugëtimin e tij për te Hapësirat e shenjta të Afrimitet dhe përkushtimi ndaj Allahut të Madhëruar, është t'ia paraqesë veprat e tij Kur'anit Famëlartë dhe t'i kolaudojë ato nëpërmjet kontrollit të pandërprerë tek ajetet fisnike. Ashtu si hadithet e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), kur duam të testojmë vërtetësinë e tyre ia paraqesim Kur'anit, të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe me veprat tona të përditshme, duhet t'ia paraqesim ato udhëzimeve të Kur'anit për të parë nëse janë vepra të dëshiruara prej Allahut apo jo.

Të njëjtat standarde dhe e njëjta njësi matëse përdoret edhe për rrugën e drejtë dhe të shtrembrën, për lumturinë apo trishtimin, për të kuptuar, nëse vazhdon të jetë ende i udhëzuar në rrugën e drejtë apo ka nisur të devijojë. Ashtu si Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), morali i të cilit përputhej plotësisht me udhëzimet dhe me frymën e dispozitave të Kur'anit, ashtu edhe besimtari i thjeshtë, i cili synon dhe shpreson afrimitetin me Allahun e

Madhëruar, duhet të vihet në kërkim të një morali të ngjashëm, që përputhet, ose të paktën i përafrohet atyre normave dhe dispozitave të moralit kur'anor. Çdo formë sjelljeje që nuk është sipas normave dhe rregullave të përcaktuara nga Kur'ani Famëllartë, është e refuzuar dhe plotësisht e pavlerë.

E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me gjendjen e brendshme dhe të padukshme të qenies. Besimtari duhet t'ia paraqesë për krahasim normave dhe rregullave të vendosura nga Kur'ani Famëllartë aktivitetin e brendshëm dhe të padukshëm të shpirtit, të zemrës, të mendjes, të ndjenjës dhe të tërësisë së të padukshmes njerëzore. Kjo është e vetmja mënyrë për të kuptuar, nëse tërësia e aktiviteteve të fshehura të qenies, janë apo nuk janë sipas rregullave dhe dispozitave të përcaktuara qartë prej Kur'anit Famëllartë.

Ti, pra, je vetë libri dhe sjelljet e tua janë shkronjat e tij. Këto janë vetëm një pjesë e vogël e atyre normave të sjelljes kur'anore. Të tjera norma dhe dispozita i kemi përmendur në fillim të këtij mesazhi, kur kemi folur për normat e edukatës, të lidhura në mënyrë absolute me të gjitha llojet e adhurimeve. Një pjesë e tyre janë të përfshira aty.

Duke qenë se trajtimi i kësaj çështjeje mund të zgjatet pafund, po mjaftohemi me kaq. Allahu e di më së miri.

## RRETH MIRËSISË SË KËNDIMIT TË KUR'ANIT<sup>143</sup>

Prej këshillave më të rëndësishme të Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) është leximi i vazhdueshëm i Kur'anit, madje transmetohet që, lidhur me këtë pjesë, ai të ketë thënë: *"Cilado qoftë gjendja jote, lexoje vazhdimisht dhe pandërprerë Kur'anin."* E vërteta është se mendja jonë, me kapacitete perceptuese shumë të kufizuara, e ka të pamundur të kuptojë realitetin e mirësive që vijnë prej leximit dhe prej këndimit të Kur'anit. Mendja e njeriut është shumë e vogël për të kuptuar rëndësinë që ka mësimi i Kur'anit, këndimi, ndjekja e udhëzimeve të tij, përsiatja rreth fshehtësive të tij. Të bindur se ky Libër dhe kjo përpjekje modeste e ka tërësisht të pamundur për të përfshirë në të dhe për t'i përcjellë lexuesit të nderuar të gjithë sasinë e transmetimeve të të pagabueshmëve të Ehli Bejt (anëtarët e familjes profetike), po kufizohemi dhe po sjellim për lexuesin tonë vetëm një pjesë të atyre transmetimeve.

Libri "El-Kafi": Sipas një transmetimi, të cilin libri ia referon Ebu Abdilahit, thuhet kështu: *"Kur'ani është*

---

<sup>143</sup> "Normat morale të namazit", f. 532.

*premtimi i Allahut, marrë prej robërve të Tij. Myslimani duhet t'i qëndrojë korrekt premtimit të dhënë Allahut, duke lexuar prej tij pesëdhjetë ajete çdo ditë.”.<sup>144</sup>*

Në një tjetër transmetim, të ardhur prej Ez-Zuhrij, thuhet: “Kam dëgjuar Aliun, të birin e Hysejnit (Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy!) duke thënë: ‘Ajetet e Kur’anit janë depo të mëdha, ndaj sa herë që hapet njëra prej atyre depove, myslimani duhet të shohë patjetër në të.”.<sup>145</sup>

Prej dy haditheve të mësipërme mund të kuptojmë se të gjitha ajetet kur’anore janë plotësisht të meritueshme për vëmendjen, meditimin dhe analizën tonë. Të gjitha format e meditimit, të studimit, të analizës dhe të përfitimit prej këtyre ajeteve (njehsimi, këshillat, të fshehtat dhe urtësitë) janë të lëvduara dhe nuk bëjnë pjesë te ajo kategori e komentimit sipërfaqësor (sipas mendjes) që është i ndaluar. Këto forma të studimit, të përfitimit dhe të meditimit nuk bëjnë pjesë te format e ulëta të komentimit, të praktikuar shpesh prej njerëzve të shthurur e të pamoralshëm, të cilët përpiqen vazhdimisht ta interpretojnë Kur’anin, duke ia përshtatur kuptimet e tij, interesave të ngushta të tyre.

Këta bëjnë pjesë te ajo kategori njerëzish, që nuk i përfillin dhe nuk i referohen transmetimeve të ardhura prej

---

<sup>144</sup> “Usulul Kafi”, vëll. 2, K. “Verat e namazit dhe format e këndimit të tij”, hadithi 1-2.

<sup>145</sup> “Usulul Kafi”, vëll. 2, K. “Vlerat e namazit dhe format e këndimit të tij”, hadithi 1-2.

Ehli Bejt (anëtarëve të familjes profetike) të Zbulesës Hyjnore, të cilët janë të drejtpërdrejtë objekt i asaj Zbulese, fakt ky, i pakontestueshëm prej askujt. Kam bindjen e plotë se nuk është më e nevojshme të zgjatemi lidhur me këtë pjesë, pasi është mjaft e qartë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëllartë:

"أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَفْقَالَه"

**"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin, apo i kanë zemrat të kyçura?!"**.<sup>146</sup>

Hadithet që i ftojnë njerëzit të thellohen në meditimin e Kur'anit dhe në mendimin thellë kuptimeve të tij, janë të panumërta. Në një transmetim tjetër, të ardhur prej Prijësit të Besimtarëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) lexojmë: *"Ju (o besimtarë) duhet ta dini mirë, se asnjë mirësi nuk ka prej ajeteve të Kur'anit, të cilat këndohen (recitohen, lexohen) pa u medituuar rreth tyre."*<sup>147</sup>

Në një transmetim tjetër, të ardhur prej Ebi Xha'aferit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) lexojmë: *"Ka thënë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!): "Ai njeri që lexon çdo natë dhjetë ajete nga Kur'ani, nuk do të regjistrohet te Allahu prej njerëzve të pavëmendshëm. Ai që lexon çdo natë pesëdhjetë ajete, do të regjistrohet te Allahu prej njerëzve që e kujtojnë Atë. Ai që lexon çdo natë dyqind ajete, do të regjistrohet prej njerëzve të*

<sup>146</sup> Sure "Muhamed", ajeti 24.

<sup>147</sup> "Biharul Enuar", vëll. 92, f. 211.

devotshëm. Ai që lexon çdo natë treqind ajete, do të regjistrohet te Allahu prej fituesve dhe triumfuesve. Ai që lexon çdo natë pesëqind ajete, do të regjistrohet prej “muxhtehidinëve/gradë shumë e lartë në dituri. Ai që lexon çdo natë njëmijë ajete, Allahu do të regjistrojë në llogarinë e tij të veprave të mira një masë sa një “kintar” - “grumbull i madh”, me të mira, shpërblime. Një “kintar” është i barasvlershëm me pesëmbëdhjetë mijë njësi floriri. Një njësi e vetme është e barasvlershme me njëzet e katër karatë. Më i vogli i karatëve është sa Mali i Uhudit, ndërsa më i madhi i tyre është sa hapësira ndërmjet Qiellit dhe Tokës.”.<sup>148</sup>

Të shumta janë gjithashtu hadithet dhe transmetimet që tregojnë se leximi i Kur'anit shfaqet me një formë të mrekullueshme Ditën e Gjykimit dhe vjen aty për të ndërmjetësuar (shefa'at/ndërmjetësimi për falje) atë që e ka lexuar vazhdimisht atë.

Në një tjetër hadith nga Ebu Abdilahi (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) transmetohet: “Ata që e kanë lexuar Kur'anin gjatë ditëve të rinisë së tyre, ai (Kur'ani) do të bashkohet me mishin dhe me gjakun e tyre, Allahu i Madhëruar do t'u japë të njëjtat pozita me engjëjt më të lartësuar të Tij. (Kiramin Berereh). Kur'ani do të kërkojë për ta një vend shumë të rëndësishëm në Ditën e Gjykimit. Ai do të dalë dhe do t'i thotë Allahut të Madhëruar: ‘O Allahu im! Të gjithë njerëzit kanë marrë shpërblimet e tyre sipas punëve që kanë bërë, përveç robit

<sup>148</sup> “Usulul-Kafi”, vëll. 2, Libri “Rreth vlerave të Kur'anit”, K. “Shpërblimi i leximit të Kur'anit”, hadithi 5.

tënd. Ai nuk është shpërblyer ende, që më ka lexuar mua, ndaj të lutem, o Allah, të zbrazësh mbi të, më të mirin e shpërblimit Tënd'. Thotë: 'Pas kësaj lutjeje Allahu i Madhëruar e vesh lexuesin e Kur'anit me dy gjerdanë prej gjerdanëve të Xhenetit dhe mbi kokën e tij vendoset kurora e bujarisë'. Më pas do të pyetet: 'A je i kënaqur me këtë që kemi rezervuar për ty'?!'.  
Përgjigjet në vend të tij Kur'ani dhe thotë: "O Allahu im! Do të doja për robin tënd një shpërblim akoma më të madh se ky që ke rezervuar për të."

Pas kësaj, Allahu do të vendosë sigurinë në dorën e tij të djathtë, përjetësinë në dorën e tij të majtë dhe, pasi të futet në Xhenet, do t'i thuhet: "Lexo dhe lartësohu edhe me një tjetër shkallë."

Më pas do t'i thuhet: "A je tashmë i kënaqur?!"

Ai do të thotë: "Po, i kënaqur jam!"<sup>149</sup>

Lidhur me të njëjtin hadith, transmetohet që imam Sadiku (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), të ketë thënë: "Ai që e lexon Kur'anin në mënyrë të shpeshtë dhe të pandërprerë dhe ndien vështirësi në leximin e tij, Allahu i Madhëruar do ta shpërblejë dyfish."<sup>150</sup>

Prej këtij hadithi të nderuar kuptojmë se prej këndimit të Kur'anit kërkohet që ai të ndikojë fuqimisht

<sup>149</sup> "Usulul-Kafii", vëll. 2, Libri "Mirësia e Kur'anit", K. "Mirësia e bartësve të Kur'anit", hadithi 4, f. 603.

<sup>150</sup> "Usulul-Kafii", vëll. 2, Libri "Mirësia e Kur'anit", K. "Mirësia e bartësve të Kur'anit", hadithi 4, f. 603.

thellë zemrave dhe shpirttrave të njerëzve, pasi ato ajete janë përfaqësueset e formave të fjalëve të lartësuara të Allahut të Madhërishëm. Ajo që kërkohet prej leximit të Kur'anit Famëlartë, është transferimi i kuptimeve të atyre fjalëve madhështore dhe i udhëzimit që përfaqësojnë, prej thellësive të zemrave, për te praktika dhe vënia e tyre në jetë, ashtu siç u citua edhe në hadithin e sipërpërmendur: *“Ata që e kanë lexuar Kur'anin gjatë ditëve të rinisë së tyre, ai (Kur'ani) do të bashkohet me mishin dhe me gjakun e tyre”*, që do të thotë se prania e Kur'anit thellësive të zemrës dhe të shpirtit të lexuesit të tij, e ngjyros dhe e transformon thellësinë e padukshme të qenies me ngjyrat dhe me frymën e Zbulesës Hyjnore, të përfaqësuar me ajetet e bekuara kur'anore. E transformon thellësinë e padukshme të qenies në një Kur'an më vete, në një Kur'an të vërtetë.

Ajo që ndodh me bartësit e Kur'anit është transformimi i brendshëm tërësor, duke marrë prej ngjyrave dhe aromës së udhëzimeve të tij. Ai shndërrohet në një qenie gjithëpërfshirëse e udhëzimeve dhe e rregullave kur'anore, në një qenie që bën dallimin ndërmjet të keqes dhe të mirës, duke qenë e prerë dhe e vendosur në këtë drejtim.

Një shembull i qartë, lidhur me këtë pjesë është Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) dhe pasardhësit e tij të pastër dhe të pagabueshëm (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*). Prania e tyre në mesin e njerëzve nuk është gjë tjetër përveçse reflektimi më i

drejtpërdrejtë dhe më i sqartë i ajeteve të Kur'anit dhe i argumenteve më të mëdha të Tij në Tokë. Prania e tyre nuk është gjë tjetër përveçse një Kur'an që ecën mbi tokë.

Në fakt, kjo dukuri dhe ky shndërrim i brendshëm i qenies dhe i shpirtit duhet të ndodhë edhe gjatë praktikimeve të adhurimeve të tjera. Pra, të gjitha ato adhurime duhet të pasqyrojnë thellë qenies, mirësi dhe pozitivitet. Ky është në thelb edhe qëllimi prej përsëritjes në mënyrë të vazhdueshme të adhurimeve, shndërrimi i plotë i qenies së adhuruesit dhe shndërrimi i tij në një ritual njerëzor mirësie, paqeje dhe pozitiviteti.

Në një hadith të transmetuar prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) lexojmë: “Aliu është namazi i myslimanëve dhe agjërimi i tyre.”<sup>151</sup>

---

<sup>151</sup> Ky hadith është i ngjashëm me hadithin e përmendur në vëllimin 24 të “Biharul Enuar”, hadithi 14, faqe 303. Transmetohet nga Daud Ibn Kethiri: “I thashë Ebu Abdilahir (Paqja e Zotit qoftë mbi të!): ‘Në librin e Allahut të Madhëruar ju jeni namazi, ju jeni zekati, ju jeni Haxhi’. Ai tha: ‘O Daud! Në Librin e Allahut të Madhëruar ne jemi namazi, jemi zekati, jemi agjërimi’.”

## **RRETH NDIKIMIT TË ADHURIMEVE TE TË RINJTË<sup>152</sup>**

Ndikimet e Kur'anit dhe të udhëzimeve të tij në transformimin e brendshëm të qenies, janë më të mëdha gjatë moshës së rinisë. Kjo ndodh, sepse zemra dhe shpirti i një të riu apo i një të reje është e pastër, e sinqertë dhe e papërlyer me pislleqet e kësaj bote. Kjo ndodh, gjithashtu, sepse te mendjet e të rinjve nuk ka filluar ende të ndodhë përplasja e madhe e mendimeve dhe e ideologjive. Kjo bën që ata të jenë përgjithësisht të pastër, të sinqertë, lehtësisht të ndikueshëm dhe rebelë.

Nisur nga sa u përmend më sipër, të rinjtë dhe të rejat, që i kanë zemrat e tyre të ndriçuara me dritën e besimit, duhet të jenë të kujdesshëm se si ndërveprojnë me mjedisin shoqëror, pjesë e të cilit janë dhe në mënyrën se si sillen me pjesën tjetër të njerëzve. Ata duhet të jenë vazhdimisht të kujdesshëm dhe të shmangin shoqërimin apo miqësimin me elemente negative, shkatërruese, të cilat mund të ndikojnë në shthurjen dhe në prishjen e moralit të tyre. Miqësia, bashkëjetesa dhe shoqërimi me personazhet dhe elementet negative dëmton të gjithë pjesën tjetër të

---

<sup>152</sup> "El Erbaunë hadithen", f. 534.

shoqërisë, cilado qoftë shtresa të cilës ata i përkasin. Duhet të bëhet e qartë për të gjithë të rinjtë dhe të rejtat tona, se të qenit e tyre besimtarë dhe të nënshtruar ndaj Udhëzimeve Hyjnore, nuk i vesh ata me imunitet absolut karshi të keqes. Shoqërimi i vazhdueshëm me njerëzit e këqij mund të ndikojë negativisht dhe padyshim edhe në devijimin e njerëzve të mirë.

Këto udhëzime shfaqen shumë të qarta në një pjesë të konsiderueshme të haditheve të transmetuara prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), në të cilat ka ftesa të drejtpërdrejta dhe sinjale të qarta për domosdoshmërinë e largimit nga gjynahqarët dhe shoqërimi i tyre.

## **RRETH NORMAVE MORALE TË LEXIMIT TË KUR'ANIT<sup>153</sup>**

Për të qenë sa më përmbledhës dhe për të mos u zgjatur shumë, na duhet të përsërisim dhe të themi se synimi dhe qëllimi përfundimtar i leximit të Kur'anit është skicimi i një tabloje kur'anore thellësive të qenies së besimtarit. Qëllimi i leximit të Kur'anit është ngulitja e urdhëresave dhe e ndalesave kur'anore kujtesës dhe sjelljes së besimtarit. Që këto qëllime të larta dhe të pastra të realizohen me sukses, duhet të kihen parasysh disa norma të përgjithshme të moralit dhe të edukatës gjatë leximit të tij. Nëpërmjet këtyre normave të sjelljes dhe të edukatës me Kur'anin Famëlartë, nuk nënkuptojmë thjesht, kujdesin e treguar për të zbatuar në mënyrë të saktë rregullat e leximit dhe të texhudit siç është për shembull përpjekja për ta kënduar atë me zë sa më të bukur e melodioz, apo përpjekja për t'u përkujdesur rreth vendnxjerrjes së shkronjave dhe përcjelljes së tyre në mënyrë sa më të plotë. Nga ana tjetër, përkujdesja dhe përqendrimi i plotë te kuptimet dhe përmbajtja e ajeteve, duke lënë pas dore rregullat e prera të leximit të tij, është një qasje difektoze,

---

<sup>153</sup> "El Erbaune hadithen", f. 535.

pasi defektet e ndryshme gjatë leximit të Kur'anit dhe mungesa e përqendrimit të rregullat e texhudit mund të prodhojë jo vetëm mangësi formale, por problematika të mëdha, të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me kuptimet e atyre fjalëve. Pakujdesi të kësaj natyre mund ta deformojnë fjalën dhe mund ta largojnë kuptimin e saj tërësisht prej boshtit kuptimor, të synuar prej Allahut të Madhëruar.

Të përqendrohesh vetëm te leximi i bukur i Kur'anit dhe të shpenzosh të gjitha energjitë e qenies në funksion të realizimit të këtij misioni, mund të jetë në vetvete një cytje prej Iblisit të mallkuar, e cila ka për qëllim t'i largojë energjitë e besimtarit prej thelbësore në sipërfaqësore. Kjo është një qasje, që ka për qëllim largimin e besimtarit prej njohjes së urdhëresave dhe të ndalesave, prej njohjes së mësimave dhe udhëzimeve të tij madhore, prej njohjes së moralit të lartë njerëzor.

Përfundimisht, mund të themi se synimi dhe qëllimi i përkujdesjes për këto norma gjatë leximit të Kur'anit, është i lidhur me të dyja anët e medaljes. Përkujdesja për bukurinë e leximit, si përkujdesje për formën, duhet të jetë bashkudhëtare e përkujdesjes për atë që është edhe qëllimi më i madh i Sheriatit, që është meditimi i thellë rreth kuptimeve, përmbajtjes dhe qëllimit të zbritjes së ajeteve kur'anore.

Në librin "El-Kafi" transmetohet, që imam Sadiku (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) të ketë thënë: "Tek ky Kur'an

*gjenden fanarë ndriçues dhe pishtarë të gjithësisë, andaj hapini mirë sytë tuaj dhe kthejeni shikimin nga ai. Nuk ka dyshim se meditimi është jetë për zemrën e besimtarit, ashtu siç është drita për ata që kërkojnë të ndriçohen në errësirë.”.<sup>154</sup>*

Në një transmetim tjetër, vjen për lexuesin përshkrimi që Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), i bën në mënyrë të zgjeruar cilësive të njerëzve të përkushtuar dhe të devotshëm. Ai thotë: *“Sa herë përballeshin me ajete që transmetonin kërcënim apo frikë, ata vinin në dispozicion të këtyre ajeteve sytë e shpirtrave dhe të zemrave të tyre. Lëkura e tyre rrëqetëj prej drojës ndaj Zotit. Zemrat e tyre dridheshin prej frikës ndaj Tij. Fërshëllimat dhe zërat e frikshëm të zjarrit të Xhehenemit dukej sikur i kishin pranë veshëve të tyre. Ndërsa kur përballeshin me ajetet, ku shpalosej premtimi dhe shpërblimi i Allahut, lëshoheshin të dorëzuar prej dëshirës, për ta prekur atë sa më shpejt, duke e trajtuar premtimin e Allahut si dritën e syve.”.<sup>155</sup>*

Është mëse e qartë se të gjithë ata që përpiqen të meditojnë thellë kuptimeve të Kur'anit, zemrat e tyre fillojnë dalëngadalë të ndikohen, derisa të mbërrijnë përfundimisht gradën e përkushtimit. Nëse arrin të ketë sukses dhe e gjen mbështetjen e Allahut në këtë rrugëtim të tij, njeriu do ta tejkalojë edhe këtë fazë, për të bërë një kapërcim të madh dhe cilësor në raport me Allahun e

<sup>154</sup> “Usulul-Kafi”, vëll. 2, K. “Mirësia e Kur'anit”, hadithi 5.

<sup>155</sup> “Uesailush-Shiah”, vëll. 4, K. 3, “Rreth leximit të Kur'anit”, hadithi 6.

Madhëruar. Menjëherë pas kësaj, organet e tij dhe çdo vepër apo fuqi e ushtruar prej tij, kthehet në një argument prej argumenteve të Allahut. Të gjitha këto forca tërheqëse, që ndërveprojnë ndërmjet qenies së robit të nënshtruar dhe Allahut të Plotfuqishëm, e shtyjnë njeriun të mbërrijë një tjetër gradë shpirtërore shumë të lartë, e cila shpaloset në mënyrë të qartë në shprehjen *“Lexo dhe lartësohu!”*.<sup>156</sup>

Nëpërmjet këtij lartësimi, qenia shndërrohet plotësisht në një gjendje pozitiviteti të atillë, që e ka të pamundur ta kuptojë pjesa më e madhe e njerëzve.

---

<sup>156</sup> “Usulul-Kafi”, vëll. 2, kreu “Rreth vlerave të Kur’anit”, hadithi 4.

## **SINQERITETI GJATË LEXIMIT<sup>157</sup>**

Prej normave të rëndësishme të leximit të Kur'anit, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e zemrës dhe në ndriçimin e saj, është edhe sinqeriteti gjatë leximit. Në mungesë të sinqeritetit, asnjë vepër dhe asnjë punë, sado e madhe qoftë, nuk ka asnjë vlerë te Allahu i Madhëruar, madje haset e përballet vazhdimisht edhe prej refuzimit të njerëzve. Çdo vepër e zhveshur prej sinqeritetit shkakton mërzinë e Allahut, bashkë me ndëshkimin e Tij.

Sinqeriteti është shtylla kryesore dhe kolona vertebrale e çdo lloj përpjekjeje dhe angazhimi të besimtarit për Ahiretin (Botën e Përtejme) e tij. Shumë prej dijetarëve kanë thënë se sinqeriteti është kapitali më i rëndësishëm, të cilin mund ta investojë besimtari dhe adhuruesi për Ahiretin e tij.

Lidhur me këtë tematikë, kanë ardhur transmetime të shumta prej anëtarëve të pagabueshëm të familjes së nderuar profetike. Prej këtyre transmetimeve është transmetimi që ka folur Esh-Shejh El-Kelini (*Kënaqësia e Allahut qoftë mbi të!*). Në një transmetim të adresuar Ebi Xhaferit (*Paqja e Zoti qoftë mbi të!*), ky i fundit ka thënë

---

<sup>157</sup> "El Erbaune hadithen", f. 536.

*“Kur’ani lexohet sipas tre formave. Kategoria e parë janë ata njerëz që e mësojnë Kur’anin, duke e konsideruar atë si një mall (të ngjashëm me pjesën tjetër të mallrave), nëpërmjet të cilit përpiqen të fitojnë kënaqësinë e pushtetarëve, apo ta keqpërdorin përdorimin e tij për të shtypur për të nënshtruar pjesën tjetër të njerëzve.”.*

Kategoria e dytë është: *“Ai që i memorizon mirë të gjitha shkronjat e tij (duke e mësuar atë përmendësh), por që e zbaton keq, ose nuk i zbaton fare dispozitat e tij. Lusim Allahun që të mos e shtojë këtë kategori të mbartësve të Kur’anit.”.*

Kategoria e tretë është: *“Një njeri që e lexon Kur’anin dhe e merr ilaçin e tij për të shëruar me të sëmundjet e zemrës. Një njeri që e kalon natën me leximin e Kur’anit, e mbush ditën me ëmbëlshinë e tij, e lexon atë nëpër xhamitë e ndryshme, ngrihet prej shtratit të tij, duke e kujtuar dhe duke e lexuar atë. Kjo është ajo kategori njerëzish, për shkak të të cilëve Allahu i Madhëruar nuk e nis ndëshkimin e Tij dhe bashkë me të fatkeqësitë. Këta janë njerëzit, prania e të cilëve ju mbron ju prej armiqve tuaj. Këta janë njerëzit për hatër të të cilëve Allahu i Madhëruar e zbret ujin e pastër dhe të kulluar prej qiellit. Betohem në Allahun, se në mesin e lexuesve të Kur’anit, këta njerëz janë si baruti i kuq.”.*<sup>158</sup>

Përsa u përket transmetimeve të lidhura me ndëshkimin, na vjen një i tillë, i adresuar Ebu Abdilahit (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), i cili transmeton prej babait të tij

<sup>158</sup> “Usulul-Kafi”, vëll. 2, f. 604, “Rreth Mirësisë së Kur’anit”, kreu “En-Neuadir”, hadithi 1, f. 627.

*(Paqja e Zotit qoftë mbi të!), i cili transmeton prej baballarëve të tij (Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!): “Ai që e përdor leximin e Kur’anit për qëllime përfitimi, fytyra e tij, në Ditën e Gjykimit, do të jetë vetëm kocka, tërësisht të zhveshura prej mishit.”.*<sup>159</sup>

Në një tjetër transmetim, adresuar Profetit të nderuar *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* lexojmë: “Ai që e mëson Kur’anin dhe nuk vepron sipas udhëzimeve të tij, pasi të jetë ndikuar prej bukurive joshëse të kësaj bote, e fton mërzinë e Allahut dhe ndëshkimin e Tij, madje i bën ato të detyrueshme për veten. Nëpërmjet kësaj sjelljeje, ai ka të njëjtën gradë dhe pozitë te Allahu si hebrejtë dhe të krishterët, të cilët e kanë hedhur Librin e Allahut me vetëdije të plotë, pas shpinave të tyre.”.

Ai që nëpërmjet leximit të Kur’anit, është vënë në kërkim të famës dhe të përfitimeve të kësaj bote, në Ditën e Gjykimit, do të dalë përpara Allahut të Madhëruar dhe fytyra e tij do të jetë kocka, tërësisht të zhveshura prej mishit. Kur’ani, vetë ai, do ta shtyjë për në zjarrin e Xhehenemit, deri sa të bjerë aty, bashkë me synimet dhe qëllimet e tij të liga.

Ai që e lexon Kur’anin, por nuk vepron sipas rregullave dhe dispozitave të tij, do të dalë përpara Allahut

---

<sup>159</sup>“Uesailush-Shiah”, vëll. 4, f. 837.

të Madhëruar i verbër në Ditën e Gjykimit dhe do të thotë: *“O Allahu im! Përse më ke bërë mua të verbër?!”. Allahu do t’i përgjigjet: “Edhe ty të erdhën ajetet, argumentet, udhëzimet dhe këshillat Tona, por i harrove shpejt. Kjo është arsyeja përse edhe ti sot, je prej të harruarve.”.*

Më pas vjen udhëzimi i prerë, që ky njeri të hidhet në zjarrin e Xhehenemit.

Ndërsa ai që e mëson Kur’anin për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar dhe për të ndriçuar shpirtin me mësimet e fesë, do të ketë shpërblim të barabartë me shpërblimin e të gjithë engjëjve, profetëve dhe të dërguarve të Allahut, të mbledhura bashkë.

Ndërsa ai që e mëson Kur’anin për t’u dukur në sytë njerëzve, për të fituar famë dhe për t’u hedhur atyre hi syve, për t’i tallur njerëzit e pavlerë dhe për të shitur mend në mesin e dijetarëve, si dhe për përfitime të ulëta të kësaj bote, Allahu do t’ia shkërmoqë kockat Ditën e Gjykimit dhe nuk do të ketë në zjarrin e Xhehenemit ndëshkim më të madh për të. Kjo zemëratë e madhe e Allahut, prej qëllimeve të tyre të ulëta, do të bëhet shkak që ata të prekin dhe të vuajnë mbi lëkurat e tyre të brishta llojet e tmerrshme dhe të padurueshme të ndëshkimit në zjarrin e Xhehenemit.

Ndërsa ai që e mëson Kur'anin me modesti e përulje, ia mëson atë rob.ve të tjerë të Allahut dhe nuk ka në zemrën e tij asnjë qëllim tjetër përveç kënaqësisë së Allahut dhe ç'të gjendet prej shpërblimit të tij, do të ketë një përfundim të atillë, që askush prej banorëve të Xhenetit nuk do të jetë më vepërmirë se ai, nuk do të ketë një shpërblim më të madh se ai. Nuk do të ketë në Xhenet një pozitë më të lartë se pozita e tij. Të gjitha pozitat e larta, shpërblimet marramendëse dhe mirësitë e Xhenetit do të vihen në shërbim të tij dhe atij do t'i jepet prej secilit prej shpërblimeve, ajka dhe pjesa më e madhe. (Fundi i hadithit)<sup>160</sup>

---

<sup>160</sup> "Uesailush-Shiah", vëll. 4, K. 9, (Rreth tekbirul Ihram), hadithi 7/11, f. 727.

## RRETH KUPTIMIT TË (TERTILIT) RRJEDHSHMËRISË<sup>161</sup>

Prej normave të leximit të Kur'anit, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë te zemrat e njerëzve dhe që lexuesi duhet ta marrë vazhdimisht në konsideratë, është leximi i rrjedhshëm i Kur'anit. Sipas haditheve të ndryshme, të lidhura me këtë aspekt, lexim i rrjedhshëm konsiderohet forma e mesme dhe e ndërmjetme e shpejtësisë në lexim. Pra, një formë leximi, e cila kuptohet qartë prej dëgjuesit. Një shpejtësi mesatare, e cila as nuk i ha një pjesë të shkronjave, por as nuk i zgjat pafundësisht ato.

Prej Muhamed Bin Jakubit, transmetohet se Abdullah ibn Sulejmani ka thënë: *"E kam pyetur Ebi Abdilahun (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) rreth kuptimit të ajetit kur'anor, në të cilin Allahu i Madhëruar thotë:*

*"وَرَتَّلَ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا"* **"Lexoje Kur'anin rrjedhshëm (o Muhamed)!"**, dhe ai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) më ka dhënë këtë përgjigje: *"Priësi i Besimtarëve (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) ka thënë: 'Paraqite, lexoje atë në mënyrën më të qartë të mundshme. Leximi nuk duhet të jetë i ngjashëm me recitimin e poezisë (qoftë në ritëm, qoftë në intonacion) dhe as nuk duhet të*

---

<sup>161</sup> "El Erbaune hadithen", f. 538.

*shpërndahet, ashtu siç shpërndahet rëra. Ajo që duhet të bëni, është të zbrazni zemrat tuaja të ngurtësuar dhe të largoni mendjen prej fundit të sures.'''<sup>162</sup> (Kjo do të thotë se qëllimi i lexuesit nuk duhet të jetë përfundimi i leximit të Kur'anit brenda një numri të caktuar ditësh. Rëndësi ka që të lexohet me qetësi dhe me ritmin që i shkon përshtat madhështisë së tij.)*

Ai njeri që ka për qëllim të lexojë Kur'anin dhe nëpërmjet tij të shërojë zemrën e tij të ngurtësuar; ai njeri që ka për qëllim të shërojë sëmundjet e brendshme të qenies së tij, nëpërmjet fjalës së plotë dhe të përsosur të Allahut të Madhëruar; ai njeri që ka për qëllim të ndriçojë qenien e tij me dritën e të fshehtave hyjnore; ai njeri që ka për synim të frymëzojë shpirtin me këtë dritë qiellore; ai njeri që ka për qëllim të mbërrijë pozitën më të lartë të shpirtit, të Ahiretit dhe të përsosmërisë, duhet të plotësojnë kriteret e dukshme dhe të padukshme, duhet të plotësojnë normat e shprehura dhe të pashprehura të edukatës dhe të mirësjelljes me leximin e Mesazhit Hyjnor.

Ndërsa ne, pjesa tjetër e njerëzve, edhe kur e lexojmë ndonjëherë Kur'anin, shumë prej kuptimeve të fshehura në të nuk jemi në gjendje t'i perceptojmë e t'i kuptojmë. Jo vetëm që nuk arrijmë të kuptojmë shpesh, shumë prej urdhëresave e ndalesave, shumë prej qëllimeve e synimeve, shumë prej këshillave dhe kërcënimeve, por,

<sup>162</sup> "Usulul-Kafi", vëll. 2, f. 614.

edhe kur na ndodh të përballemi dhe të lexojmë rreth mrekullive të Xhenetit apo fatkeqësive të Xhehenemit, bëjmë sikur nuk kanë lidhje fare me ne. Ndonjëherë na ndodh që (Zoti na ruajt dhe na faltë!) ta lexojmë Kur'anin sikur të ishte ndonjë libër i mbushur me histori të bukura dhe tërheqëse, duke nguruar të jemi të kujdesshëm në recitimin rrjedhshëm, sipas normave dhe me edukatë të ajeteve të nderuara.

Në hadithe të ndryshme, të transmetuara, gjejmë udhëzime të qarta rreth mënyrave se si duhet të lexohet Kur'ani. Në disa prej atyre haditheve këshillohet që leximi të bëhet me zë melodioz dhe njëkohësisht me nuanca të theksuara trishtimi. Transmetohet prej Ebi Hasanit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*): *"I tregova atij zërin tim dhe më tha: 'Kur Ali ibn Hysejmi (Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy!) këndonte Kur'anin, thuhet se aty pranë ka qenë duke kaluar dikush, i cili, sapo e ka dëgjuar atë, ka kaluar në gjendje të fikti prej bukurisë së madhe të zërit dhe të leximit të tij'. Ai tha, gjithashtu, se Imami e ka pasur zërin aq të bukur, sa një pjesë e njerëzve mahniteshin dhe nuk ishin në gjendje ta dëgjonin gjatë."*<sup>163</sup>

Ajo që ndodh rëndom, është se ne ia nisim të këndojmë dhe ta recitojmë bukur Kur'anin ose ezanin, sa herë duam t'u tregojmë njerëzve që e kemi zërin të bukur, por, fatkeqësisht, neglizhojmë shumë prej rregullave të leximit e të texhuidit, si dhe pa mundur të tregojmë ndonjë

---

<sup>163</sup> "Usulul-Kafi", vëll. 2, K. "Këndimi i Kur'anit", hadithi 4.

përkushtim e devotshmëri të ngjashme, kur vjen puna te zbatimi i udhëzimeve dhe i mësimave të tij.

Gjithsesi, duhet të jemi të vetëdijshëm se kurthet që i ngre vazhdimisht shejtani i mallkuar dhe në bashkëpunim të plotë me të edhe egoja (nefsi) që udhëzon në të keqe, janë të shumta dhe nga më të ndryshmet, saqë, shpesh, e kota dhe e vërteta shfaqen të ngjashme dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën. E mira më të keqen, gjithashtu. Nisur prej këtij fakti, duhet të kërkojmë mbrojtje prej Allahut të Madhëruar prej këtyre kurtheve dhe devijimeve.

## **KËSHILLA PËR NJË KËNDIM TË QETË (TË PAQTË) TË KUR'ANIT DHE REALIZIMI NËPËRMJET KËSAJ I PËRKUFIZIMIT TË QARTË TË SYNIMEVE DHE TË DIMENSIONEVE TË TIJ TË NDRYSHME**

U kujtojmë vizitorëve të nderuar të Mekës dhe të Medines, që të mos jenë të pavëmendshëm ndaj këtij detaji shumë të rëndësishëm, që është realizimi i paqes shpirtërore, nëpërmjet një këndimi të vazhdueshëm të Kur'anit Famëlartë gjatë udhëtimit dhe transferimit të tyre nga njëri vend në tjetrin. Ta kërkojnë qetësinë e shpirtit nëpërmjet leximit të kësaj platforme prej drite dhe të këtij udhërrëfyesi Hyjnor. Ata dhe të gjithë myslimanët e botës duhet ta kenë të qartë se gjithçka kanë pasur myslimanët, gjithçka kanë sot dhe gjithçka do të kenë në të ardhmen prej arritjeve e suksesit, e kanë vetëm prej bereqetit dhe mirësisë që përfaqëson ky Libër i Shenjtë.

Gjej rastin këtu, që t'u drejtohem të gjithë dijetarëve të nderuar të ymetit (popujt myslimanë), bijtë e këtij shekulli dhe bashkë me ta të gjithë mendimtarët e mëdhenj dhe të zotë të kohës sonë, të mos heqin dorë kurrë prej Kur'anit Famëlartë dhe të tregohen vazhdimisht të kujdesshëm, që ta zbatojnë atë, pasi ai është tregues dhe

sqarues i gjithçkaje që ndodh në ekzistencë. Ai është i vetmi udhërrëfyes që buron prej lartësive të Hyjnores dhe e mbush zemrën e njeriut dhe shpirtin e tij plot e përplot me dritë e shpëtim.<sup>164</sup>

Ky Libër Hyjnor, i cili përfaqëson një tablo të qartë, të parë dhe të shkruar, është një Libër ku përfshihet tërësia e Emrave dhe e Cilësive të Allahut, tërësia e dispozitave dhe e udhëzimeve të Tij. Ky Libër është i jashtëzakonshëm, fshehtësitë e të cilit duart dhe mendjet tona nuk mund t'i mbërrijnë. Kjo mrekulli e madhe, të cilën mund ta kuptojë dhe ta perceptojë, në tërësinë e saj, vetëm qenia e shenjtë e Profetit (atij të cilit iu drejtua Zbulesa Hyjnore) dhe nëpërmjet tij (me bereqetin e tij) e kuptojnë edhe (eulijatë) njerëzit e afërt dhe të dashur të Allahut, në varësi të gatishmërisë së qenieve të tyre për ta pranuar atë dhe në varësi të gradëve dhe pozitave shpirtërore të secilit, që vijnë si rezultat i ushtrimeve dhe i gjimnastikës shpirtërore.

Sot, jemi në gjendje të kuptojmë diçka më shumë, pasi e kemi atë në duart tona, në formën e tij të shkruar. Në formën e Zbulesës Hyjnore, që nuk ka asnjë mangësi të vetme, asnjë defekt të vetëm, qoftë dhe me një shkronjë të vetme.

Mos e dhëntë Zoti, që të braktisemi prej Kur'anit, edhe pse pjesa më e madhe e kuptimeve të thella dhe e

---

<sup>164</sup> Është përmendur më sipër. Për sqarime të mëtejshme kthehu te faqja 13.

pozitive të fshehta, të përfaqësuar në të, është larg duarve të njerëzve të thjeshtë. Por, janë njerëzit e veçantë, të dashurit e Zotit dhe eulijatë ata që, me kërkimet dhe zbulimet e tyre, me metoda nga më të ndryshmet dhe në gjuhë të ndryshme, sjellin për njerëzimin kuptimet madhështore të tij, si dhe dritën e pashtershme që buron prej të fshehtave të mahnitshme, që kanë fillim, por nuk e kanë një fund. Ato të fshehta dhe mrekulli burojnë prej (bahrul-keshf, deti i valëzuar i zbulesës muhamedane),<sup>165</sup> të cilat i transmetohen pjesës tjetër të njerëzimit, në varësi të mundësive të tyre, në varësi të aftësisë dhe të gatishmërisë që kanë për ta realizuar këtë.

Filozofët e mëdhenj dhe mendimtarët e shquar duhet të vihen në kërkim të kuptimeve të mëdha të fshehura në Kur'an dhe t'i zbërthejnë ato për njerëzit, në varësi të kapaciteteve të tyre. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve ata i shërbejnë njerëzimit, duke sjellë për të zbërthimin e kuptimeve të kodifikuara të Zbulesës Hyjnore, si dhe argumentet filozofike që vihen në shërbim të së vërtetës.

Nuk ka dyshim se ky Libër Hyjnor, është përfaqësuesi i tërësisë së mbledhur të Emrave dhe të Cilësive, të argumenteve dhe të njohurive. Aftësitë tona dhe të njerëzve të thjeshtë janë shumë të kufizuara, ndaj dhe është e pamundur që mendjet tona të depërtojnë thellësive të atyre sekreteve.

---

<sup>165</sup> Është përmendur më sipër. Për sqarime të mëtejshme kthehu te faqja 9.

Nisur nga kjo, është detyrë e njerëzve të mëdhenj, me aftësi dhe fuqi depërtuese, të hyjnë thellë atyre kuptimeve, duke ia ofruar ato njerëzimit në formën e një dhurate, të cilën e përfituan thellësive të botëve të fshehta, pasi të kenë mbërritur gradë shpirtërore të ngjashme me atë që thotë Profeti i nderuar: *“Më ka mësuar Zoti im dhe më ka edukuar Ai.”*.

Është detyra e këtyre njerëzve të etur për ujin e Keutherit, të përmalluar për takimin me Allahun e Madhëruar, që, sa të jetë e mundur, t’i mësojnë pjesës tjetër të njerëzve, ato norma të mrekullueshme të sjelljes, të edukatës dhe të adhurimit. Është detyrë e atyre zemrave të etura për udhëzimin e njerëzimit, që t’u përcjellin njerëzve prej dritës së përkushtimit, që buron prej zemrës së Kur’anit Famëlartë, për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: **“Ai (Kur’ani) është udhërrëfyes për të devotshmit.”**

Është detyrë e atyre zemrave të dashuruara me udhëzimin e Krijuesit të tyre, që t’ia përcjellin atë pjesës tjetër të njerëzve.

Përfundimisht, mund të themi se është detyrë e mendimtarëve dhe e dijetarëve të nderuar myslimanë, të ndahen në grupe të ndryshme dhe secili grup të merret me studimin dhe hulumtimin e aspekteve dhe të dimensioneve të ndryshme të Zbulesës Hyjnore. Është detyra e këtyre dijetarëve të nderuar të mprehin majat e penave të tyre dhe të realizojnë për të dashëruarit pas Kur’anit, synimin dhe ëndrrën e tyre të madhe, për të

kuptuar sa më shumë prej mësimëve, këshillave, urtësive, të fshehtave dhe dimensioneve të ndryshme shoqërore, politike, kulturore, ekonomike e ushtarake, të paqes dhe të luftës, të gjendura në Kur'anin Famëllartë.

Duhet të jetë e qartë për të gjithë njerëzimin se ky Libër i Shenjtë, është burimi i padiskutueshëm i të gjitha dijeve dhe i të gjitha mirësive. Ai Libër është i mbushur me (irfan/njohuri të fshehta, dije askete), me logjikë e filozofi, madje edhe me forma të caktuara të letërsisë e politikës. Prania e këtyre dijeve e mbyll përfundimisht rrugën, përballë të dashuruarve me injorancën dhe paditurinë, se dituritë askete (të fshehta/irfani) dhe filozofia janë produkte të mendjes njerëzore dhe të imagjinatës së shthurur të saj. Ai është një Libër i mbushur me dije askete, prej të cilave frymëzohen shumë prej gjimnastikave shpirtërore që kryejnë asketët dhe dervishët. Ai është një Libër i mahnitshëm, që mbyll përfundimisht dyert në fytyrë të të gjithë atyre që deklarojnë dhe thonë se Kur'ani dhe dijet e përfshira në të, nuk kanë lidhje me punët e shtetit dhe të qeverisë. I mbyll dyert një herë e përgjithmonë përballë atyre që pretendojnë dhe thonë se Kur'ani nuk duhet të ndërhyjë në çështjet e pushtetit, të qeverisë. I mbyll dyert përfundimisht për të gjithë ata që pretendojnë dhe thonë se Islami është fe e paqes dhe nuk zhvillon luftë, qoftë dhe ndaj atyre që i shpallin luftë atij. Kjo kategori myslimanësh është e ngjashme me ata të krishterë të paditur e injorantë, që përjashtuan

Krishterimin dhe udhëzimet e mrekullueshme të Isait, Mesisë (Paqja e Zotit qoftë mbi të!).

Thirrja ime e fortë, që buron prej thellësive të dhimbjes, u drejtohet të gjitha institucioneve shkencore të hauzeve të nderuara dhe të gjitha universiteteve islame në të gjithë botën: “O ju myslimanë të ndershëm! Ngrihuni të gjithë në këmbë të shpëtojmë Librin e Shenjtë, Kur’anin Famëllartë dhe mësimet e tij të bekuara. T’i shpëtojmë ato mësimet prej kthetrave të dijetarëve të paditur, që e kanë braktisur Kur’anin dhe udhëzimet e tij të qarta me vetëdije të plotë.

Deklaroj sot me zë të lartë se ndiej një dhimbje të pamasë dhe të papërshkrueshme për ditët e jetës sime, të çuara dëm. Për ditët e shpenzuara larg Kur’anit dhe udhëzimeve të tij. Është detyrë e madhe sot, për të gjithë trimat e ymetit, që të drejtojnë thirrjet e tyre për hauzet e nderuara dhe për universitetet e myslimanëve, që të kthehen fuqimisht te dimensionet e ndryshme, të përfshira në udhëzimet dhe në mësimet e Kur’anit Famëllartë.

Le të jetë mësimi dhe studimi i Kur’anit në të gjitha aspektet e tij qëllimi juaj më i lartë. Kjo thirrje e sinqertë buron prej dëshirës sime të madhe, që të mos pendoheni edhe ju në fund të jetës suaj, pasi t’ju kenë kaluar ditët e jetës dhe të përballeni me pamundësinë dhe pafuqinë e pleqërisë. Të pendoheni për të gjitha ditët e jetës suaj, që i keni kaluar, larg mësimet dhe udhëzimeve të tij. Të pendoheni për ditët tuaja të rinisë, ashtu siç është penduar edhe shkruesi i këtij libri.”

## **BURIMET**

- “Metodika e Revolucionit Islamik”, (Menhexhijetuth-Theuretil-Islamijeh), *Imam Khomeini* (Zoti qoftë i kënaqur me të!)
- “Dyzet Hadithet” (El Erbaune hadithen), *Imam Khomeini* (Zoti qoftë i kënaqur me të!)
- “Normat morale të Islamit” (El Adabul Ma’anauijeh Lis-Salat), *Imam Khomeini* (Zoti qoftë i kënaqur me të!)
- “Kur’ani, dera e njohjes së Allahut” (El-Kur’an Babu Ma’arifetil-Lah) *Imam Khomeini* (Zoti qoftë i kënaqur me të!)

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                                         |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Parathënie.....                                                                                         | 5   |
| Libri i Allahut përgjatë historisë.....                                                                 | 18  |
| Madhështia e Kur'anit.....                                                                              | 34  |
| Kur'ani si fjalë gjithëpërfshirëse.....                                                                 | 42  |
| Kushtet për kuptimin e Kur'anit.....                                                                    | 46  |
| Gostia e madhe kur'anore.....                                                                           | 49  |
| Komentimi i Kur'anit.....                                                                               | 55  |
| Vështirësia në kuptimin e Kur'anit të “nëndheshëm” apo<br>“të padukshëm” .....                          | 61  |
| Dimensioni i veçantë i përfitimeve prej Kur'anit.....                                                   | 67  |
| Sqarim rreth qëllimeve, synimeve dhe kërkesave të Librit<br>Hyjnor, në përgjithësi dhe në veçanti.....  | 71  |
| Rreth mënyrave të përfitimit prej Kur'anit.....                                                         | 91  |
| Rreth ngritjes, largimit të pengesave dhe të perdeve<br>ndërmjet Kur'anit dhe përfituesve prej tij..... | 104 |
| Rreth meditimit.....                                                                                    | 127 |

|                                                                                                                                                                      |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Rreth zbatimit (praktikimit) të tij.....                                                                                                                             | 134 |
| Rreth mirësisë së këndimit të Kur'anit.....                                                                                                                          | 143 |
| Rreth ndikimit të adhurimeve të rinjtë.....                                                                                                                          | 150 |
| Rreth normave morale të leximit të Kur'anit.....                                                                                                                     | 152 |
| Sinqeriteti gjatë leximit.....                                                                                                                                       | 156 |
| Rreth kuptimit (tertilit) dhe rrjedhshmërisë.....                                                                                                                    | 161 |
| Këshilla për një këndim të qetë (të paqtë) të Kur'anit dhe realizimi nëpërmjet kësaj i përkufizimit të qartë të synimeve dhe të dimensioneve të tij të ndryshme..... | 165 |
| Burimet.....                                                                                                                                                         | 171 |

اسم الكتاب: القرآن الكريم في فكر الامام خميني

المترجم: الحاج ولنت مريا

التدقيق: صبريه فزا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا